

# ETIKA

**“ZOTI YT KA URDHËRUAR,  
QË TË MOS ADHURONI ASKËND TJETËR PËRVEÇ ATIJ DHE,  
QË TË SILLENI MIRË ME PRINDËRIT. NËSE NJËRI PREJ TYRE  
OSE TË DY ARRIJNË PLEQËRINË TE TI,**

**MOS U THUAJ ATYRE  
AS “UH!”,**

**MOS I KUNDËRSHTO, POR DREJTOJU ATYRE  
ME FJALË RESPEKTI.” (ISRA, 23)**



# Editorial

Një herë e një kohë, ekzistonte familja e madhe, në të cilën jetonin së bashku prindërit, fëmijët madje edhe nipërit.

Për këtë arsy, fëmijëria, rinia dhe pleqëria bashkë-jetonin me njëra-tjetrën. Gjyshërit, nipërit, nuset, ndonjëherë edhe dhëndurët ndanin mes tyre unitetin e familjes së madhe.

Pastaj thuhet se së bashku me revolucionin industrial, erdhi edhe periudha e familjes bërthamë, në të cilën bëhet fjalë për jetën në familje mes babait, nënës dhe fëmijëve, deri sa të martoreshin.

Thuhet se tani po vjen ose mbasë ka ardhur edhe vala e tretë, në të cilën familja bërthamë është shpërbërë dhe është formuar një strukturë shoqërore, ku thuaçse nuk ka vend familja. Veçanërisht për shoqëritë evropiane, sociologët kanë lëshuar alarmin e shpërbërjes në fjalë.

Të gjithë këto procese kanë nxjerrë në pah një model jete.

Familja bërthamë lindi problemi e qëndrimit vetëm të prindërve të moshuar...

Pas familjes bërthamë, vala e tretë, që është shpërbërja totale e familjes, solli në diskutim atë dukuri që quhet kultura e vëtmisë, të cilën e përjeton çdo individ.

Sot, kur kjo strukturë është trashur kaq shumë, në shoqërinë evropiane, veçanërisht në periudhat e pleqërisë del në pah drama e "njerëzve të vëtmuar".

Çfarë pret prej nesh në këtë pikë që kemi ardhur, vullneti hyjnor, që ka përcaktuar madje edhe detyrat e fëmijës ndaj prindërve, si dhe të prindërve ndaj fëmijëve?

Kjo është ajo situatë, kur urdhri hyjnor fiton rëndësi jetike për jetën e njeriut, ashtu si nevoja që ka toka e tharë për ujin. Prandaj shekulli ynë, me një etje të tillë, vë përpara nesh nevojën e leximit të këtyre ajeteve të sures Isra:

*"Zoti yt ka urdhëruar që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as "uf!", mos i kundërshto, por drejtoju atyre me fjalë respekti. Lësho para tyre krahët e përuljes prej mëshirës dhe thuaj: "O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogël!"*

(Isra, 23-24.)

Këto ajete na mësojnë se:

- Allahu i Lartësuar, së pari na kujton cilësinë e Tij si Rabb, pra që Ai ushqen dhe rrit njerëzit dhe se fuqia e edukimit është në duart e Tij. Me këtë rast, na urdhëron që të adhurojmë vetëm Atë. Kjo është umbeja më themelore e akides islamë.

- Menjëherë pas kësaj umbeje themelore, fjalë hyjnore na përkujton mirësinë ndaj prindërve.

- Pastaj kërkon prej nesh që, në rast se të dy prindërit ose njëri prej tyre do të jetojë, aq sa të bëhet i moshuar pranë nesh, atij mos t'i themi madje as "uf".

- Kërkon që të mos i qortosh ata.

- Për më tepër, atyre thuaju fjalë të mira.


- Zgjatu atyre krahun e ndihmës me dhembshuri dhe mëshirë.

- Lutu për ta.

Njeriu duhet ta marrë parasysh edhe llogarinë që ka për të dhënë. Do të vijë një ditë, kur do të japë llogari para Zotit, nëse u ka hyrë në hak prindërve të tij.

Do të vijë një ditë, kur do të japë llogari: "Pse u the "uf!" prindërve, pse i qortove ata, pse nuk i mbajte në krahët e tu me dhembshuri, pse e harrove kujdesin që kanë treguar ata ndaj teje, kur ishe i vogël, pse nuk u lute për ta?..."

# Do të lexoni:



**Ahmet Tashgetiren /**  
As "Uf"! mos u thuaj!



4

**Ahmet Tashgetiren / 4**

**Zejneb Ozdil / 7**

**Ma. Muhidin Ahmeti / 8**

**Përshtati: E. Kaduku / 12**

**Ma. Gilman Kazazi / 16**

**Atilla Jargëxhë / 18**

**Salih Zeki Meric / 21**

**Edison Çeraj / 22**

**Prof. dr. I. L. Çakan / 24**

**Nuredin Nazarko / 27**

**Ali Riza Temel / 28**

**Anderson Marku / 31**

**Doç. dr. Sulejman Derin / 32**

As "Uf"! mos u thuaj!

Edhe unë jam këtu

Drita e besimit dhe e Mevludit -2-

Zemra dhe misteret e saj

Zbritja e Kuranit pjesë-pjesë

Modeli i njeriut  
me vatër dashurinë -1-

Çfarë presin të mos huarit  
nga të rinjtë

Nëna dhe liria

Dy bazat e identitetit të myslimanit

Paracaktimi dhe liria

Borxhi i besnikërisë

Besimi në Zot,  
çelësi i kurimit të sëmundjeve

Ekuilibri ndërmjet fesë dhe botës

**Atilla Jargëxhë /**  
Modeli i njeriut me vatër dashurinë -1-



18

**Ali Riza Temel /**  
Borxhi i besnikërisë



28

# Mars 2012

**40**

**Osman Nuri Topbash /**

Të zgjedhesh botën tjeter në vend të kësaj bote



**46**

**Qani Nesimi /**

Qasje religjioni te shqiptarët  
në procesin e globalizimit



**61**

**Ma. Artur Tagani /**

Ndikimi i letërsisë islamë në letërsinë perëndimore



Fotoja e Muajit

Një ajet - Një hadith

Të zgjedhesh botën tjeter  
në vend të kësaj bote

Qasje religjioni te shqiptarët  
në procesin e globalizimit

Hyrja në Paqe

Dy fjalë të fshehta  
që sjellin të gjitha mirësitë

Rëndësia e përkujtimit të ditëlindjes  
së Muhamedit (a.s.)

Rreth studimeve historike

Kalvari i shkatërrimit të objekteve  
osmane në Shqipëri

Ndikimi i letërsisë islamë në  
letërsinë perëndimore

Therja e kurbanit  
për lindjen e fëmijës

Vdekja

Muhamedi (a.s.),  
shembull për njerëzimin

Turpi është çelësi i besimit

**34 /**

**38 -39/**

**40 / Osman Nuri Topbash**

**46 / Qani Nesimi**

**52 / M. Sami Ramazanogllu**

**53 / A. Jasin Demirxhi**

**54 / Bashkim Bajraktari**

**56 / Zani i s'kaluemes**

**58 / Ma. Ermal Nurja**

**61 / Ma. Artur Tagani**

**64 / Ma. sci. Flamur Sofiu**

**68 / Enciklopedi Islamë**

**70 / Imam Naim Drijaj**

**71 / Familja**

# Asuf! mos u thuaj!



Ahmet Tashgetiren

Ka periudha kohe, kur urdhri hyjnor fiton vlerë për njerezimin, si të ishte uji, për të cilin ka aq shumë nevojë toka e tharë.

Ajetet 23 dhe 24 të sures Isra, përfshijnë paralajmërimë hyjnore me aq vlerë jetike për njerëzimin e ditëve tonë. Madje, këto ajete mund të cilësohen shumë mirë edhe si "thirrja e Krijuesit për besnikëri".

Së pari, do të përpinqem të tregoj se për cilën situatë të njérëzimit e kam fjalën, kur përdor shprehjen njerëzimi i sotëm.

Një herë e një kohë, ekzistonte familja e madhe, në të cilën jetonin së bashku prindërit, fëmijët madje edhe nipërit.

Për këtë arsy, fëmijëria, rinia dhe pleqëria bashkëjetonin me njëra-tjetrën. Gjyshërit, nipërit, nuset, ndonjëherë edhe dhëndurët ndanin mes tyre unitetin e familjes së madhe.

Pastaj thuhet se së bashku me revolucionin industrial, erdhë edhe periudha e familjes bërthamë, në të cilën bëhet fjalë për jetën në familje mes babait, nënës dhe fëmijëve, deri sa të martoheshin.

Thuhet se tani po vjen ose mbapse ka ardhur edhe vala e tretë, në të cilën familja bërthamë është shpërbërë dhe është formuar një strukturë shoqërore, ku thaujse nuk ka vend familja. Veçanërisht për shoqëritë evropiane, socio-logët kanë lëshuar alarmin e shpërbërjes në fjalë.

Të gjithë këto procese kanë nxjerrë në pah një model jete.

Familja bërthamë lindi problemin e qëndrimit vetëm të prindërve të moshuar...

Pas familjes bërthamë, vala e tretë, që është shpërbërja totale e familjes, solli në diskutim atë dukuri që quhet kultura e vetmisë, të cilën e përjeton çdo individ.

Sot, kur kjo strukturë është trashur aq shumë, në shoqërinë evropiane, veçanërisht në periudhat e pleqërisë del në pah drama e "njerëzve të vetmuar".

Këtë që po ju rrëfej, ma ka treguar një mjeshtër çelësash, turk, që punonte në Evropë.

- Policët më thërrasin shpesh që të hap dryna të kyçur të dyerve të shtëpive, nga të cilat përhapet një erë e rëndë. Kur i kemi hapur, të shumtën e rasteve kemi gjetur kufoma të dekompozuara të njerëzve që jetonin vetëm. Madje njëherë, hymë brenda dhe televizioni që i ndezur, ndërsa përpara tij gjetëm kufomën e një të moshuari mbi një kolktuk, përballë me televizorin. Fqinjët e njoftojnë policinë vetëm atëherë, kur kufomat fillojnë të dekompozozen dhe të lëshojnë erë të rëndë.

Kjo nuk është një situatë që vlen vetëm për shoqëritë evropiane.

Përtej shpërbërjes së familjes, tashmë edhe marrëdhëni e thjeshta mes fqinjëve janë shkatërruar.

Shyqyr Zotit që shoqëritë myslimane nuk kanë ardhur

ende në këtë pikë shpërbërjeje.

Po në çfarë gjendjeje janë problemet që nxjerr në pah familja bërthamë?

Gati në të gjitha shoqëritë myslimanë familja e madhe është kthyer në raste shumë të rralla.

Numri i familjeve, në të cilat jetojnë bashkë gjyshërit, gjyhet së bashku me fëmijët e tyre të martuar, nuset e djemve dhe nipërit është i kufizuar. Dhe në rastet e jetës bashkë në familje, marrëdhëniet brenda familjes nuk e kalojnë dimensionin e mysafrit.

Ndoshta mund t  mos i kushtojm  shum  r nd esi probleme q  nxjerr n  pah kjo situat , si d  transmetimit t  vlerave mes prezav  apo edukimit t  f mij ve q  ndikohen prej saj. F mij t e vegj l – nuset, g jyshi n  familje – ndonj her  mund t  mos e v rejn  munges n e g jyshes, ndonj her  mund t  mendojn  se kjo mang si  sht  mby-llur n  nj far  m nyre, nganj her  mund t  bindin veten e tyre, duke menduar: “ C far  t  b ejm , k shtu kan  ardhur koh t.”

Vetëm se kjo ndarje, shkëputje, shpër-ndarje sa andej-këndej, nxjerr në pah përgjegjësi të mëdha, veçanërisht nga aspekti i prindërve të mos-huar.

Vjetërsia, në të njëjtën kohë do të thotë edhe humbje fuqie, dobësi trupore ose humbje të funksioneve të organeve. E thënë me fjalë të tjera, do të thotë shtim i sëmundjeve, si fizike, ashtu edhe shpirtërore dhe mendore. Kjo nxjerr në pah problemin që të mos mundësh t'i kryesh vetë punët tuaja. Që do të thotë nevojë për interesim, ndihmë, përkrahje dhe shërbim.

E vërteta është se:

Sa më shumë zhvillohen shërbimet shëndetësore, aq më shumë zgjatet edhe jetëgjatësia e njeriut. Sa më shumë shtohet jetëgjatësia, aq më shumë shtohet edhe periudha e pleqërisë dhe, në varësi të saj edhe periudha kur njeriu nuk mund t'i bëjë vetë punët e tij dhe ka nevojë për shërbimin e të tjerëve.

Atëherë, si do të kompensohet kjo nevojë?

Kjo është njëra nga problemet më të mëdha të shekullit tonë.

Në Evropë ekzistojnë qendrat e sigurisë sociale dhe shtepitë e pleqve, të cilat u ofrojnë shërbim shëndetësor aq sa kanë mundësi të moshuarve, u mundësojnë edhe një rrëth të caktuar shoqëror, por nuk u falin qetësinë shpirt-ëreore që u dhuron një familje e vërtetë. Evropa nuk mund të ofrojë më shumë se sa kaq...

Një situatë e tillë, ndonëse në një masë të kufizuar ende, ka filluar të shfaqet edhe në shoqëritë myslimane.

Sot, ka shumë fshatra në të cilat prindërit e moshuar jetojnë vetëm, sepse të rinjtë kanë shkuar në qytete dhe shtete të tjera për të punuar.

Nëpër qytete, fëmijët martohen dhe jetojnë në shtëpi të ndara në atë apo qytete të tjera, duke i lënë prindërit emoshuar vetëm në shtëpi.

Problemi fokusohet në këtë pyetje:

Kush do t'u shërbëjë këtyre prindërve të moshuar, kur të kenë nevojë për ndihmë, pasi ata të sëmuren dhe të jenë të dobët për të kryer punët e tyre?

A mund ta përbushin këtë nevojë shtëpitë e pleqve, çfarë gjendjeje shpirtërore krijon tek prindërit e moshuar vendosja në një shtëpi pleqsh, çfarë ndjesie do të krijojë tek fëmija dhe tek nipërit dërgimi i prindërve në një shtëpi pleqsh?

Çfarë pret prej nesh në këtë pikë që kemi ardhur, vullneti hyjnor, që ka përcaktuar madje edhe detyrat e fëmijës ndaj prindërve, si dhe të prindërve ndaj fëmijëve?

Ja pra, ajo që thamë në krye. Kjo  
është ajo situatë, kur urdhri hyjnор  
fiton rëndësi jetike për jetën e nje-  
riut, ashtu si nevoja që ka toka e  
tharë për ujin. Prandaj shekulli  
ynë, me një etje të tillë, vë përpala-  
ra nesh nevojën e leximit të këtyre  
ajeteve të sures Isra:

*“Zoti yt ka urdhëuar që të mos adhuroni askënd tjetër përvëç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë ple-qërinë te ti, mos u thuaj atyre as “uf!”, mos i kundërshto, por drejtoju atyre me fjalë respekti. Lësho para tyre krahët e përuljes prej mëshirës dhe thuaj: “O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogël!”* (Isra. 23-24)

Këto ajete përcjellin në të njëjtën kohë edhe një bukuritë rrallë, në lidhje me imtësitetë e ndjeshme që fjalë hyjnore na prezanton mbi psikologjinënierëzore.

## Këto ajete na mësojnë se:

- Allahu i Lartësuar, së pari na kujton cilësinë e Tij si Rabb, pra që Ai ushqen dhe rrit njerëzit dhe se fuqia e edukimit është në duart e Tij. Me këtë rast, na urdhëron që të adhurojmë vetëm Atë. Kjo është umbeja më themelore e akides islamë.

- Menjëherë pas kësaj umbeje themelore, fjala hyjnore na përkuiton mirësinë ndaj prindëryve.

- Pastaj kérkon prej nesh që, në rast se të dy prindërit

ose njëri prej tyre do të jetojë, aq sa të bëhet i moshuar pranë nesh, atij mos t'i themi madje as "uf".

- Kërkon që të mos i qortosh ata.

Kjo pjesë e fjalës hyjnore shpreh mundësinë që fëmijët mund edhe t'u thonë "uf" prindërve të tyre të moshuar, për shkak të vështirësive që burojnë nga pleqëria, madje edhe mund të shkojnë deri aty sa edhe t'i qortojnë ata. Ky është një konstatim i rëndësishëm psikologjik. A mund të ndodhë kjo gjë? Fjala hyjnore na rrëfen se njeriu mund të pérjetojë "një moment humbeje durimi, një shenjë indifference apo mungese përgjegjësie." Ajo e fton njeriun drejt klimës së edukimit hyjnor, që do të thotë: "Allahu të ka falur jetën, të ka falur këtë botë, të ka dhënë çdo gjë që dëshiron, por edhe të ka rrëthuar me mëshirën e Tij. Kur t'u shërbesh prindërve edhe ti mëso nga Rububijeti i Krijuesit."

- Për më tepër, atyre thuaju fjalë të mira.

Mos bëj kurrë gjëra të tillë, si t'u thuash "uf" apo t'i qortosh ata, por thuaju vetëm fjalë të mira. Krijo një lidhje positive me ta. Merri me të mirë. Le të gëzohen. Zemra dhe fytyra jote të janë të qeshura, në mënyrë që të arrish t'u thuash atyre fjalë të mira.

- Zgjatu atyre krahun e ndihmës me dhembshuri dhe mëshirë.

Dhembshuria dhe mëshira duhen bërë vlerat themelore të personalitetit, në marrëdhëniet e tua me prindërit. Mos u trego i vrazhdë dhe i ashpër. Zemra jote le të jetë e mbushur me dhembshuri dhe mëshirë. Këto dy ndjenja duhet të depërtojnë tek të gjitha sjelljet tuaja, në mënyrë që ata ta ndjejnë se janë në krahët e sigurtë të fëmijëve të tyre.

- Lutu për ta.

Kur lutesh për ta, kujto vogëlinë tënde, kur ata kujdeshin për ty, se si nëna jote të mbajti në bark nëntë muaj me radhë, se si të ushqeu me qumështin e gjirit, se si përpiquej netëve që të vinte në gjumë dhe se si të pastronte pa përtesë, sa herë që ndyheshe. Kujto se si babai yt punoi ditë e natë, në mënyrë që ti të rritesh i shëndetshëm. Kujto se si i luteshin me gjithë shpirt Allahut që ti të ishe sa më mirë.

Kujtoji dhe, duke pëshpëritur "O Zot", mbështetu edhe ti në portën e Zotit tënd. Lutu me gjithë shpirt "O Zot, mëshiroji prindërit e mil!", "Mëshiroji ata", pra vepro me atributet e Tua, Rrahman dhe Rrahim, ndaj tyre. O Zot, bëj që të mos u themi atyre as "uf!", bëj që të mos i qortojmë kurrë, bëj të lehta për ne vështirësitë që lindin prej dobësive të tyre

fizike dhe mendore, bëj që të mos i hidhërojmë ata, bëj që ata të mbeten të kënaqur me ne...

Thuhet se dashuria vjen nga lart, poshtë.

Dashuria është vendosur në zemrat e prindërve, që para krijimit (hilkat).

Për këtë arsy, nuk është e nevojshme që t'u bëhet prindërve sugjerim i veçantë për dashurinë që duhet të kenë përfshirë e tyre.

Ndërsa dashuria e fëmijës nga poshtë lart, kërkon një përpjekje të veçantë, një edukatë dhe vullnet të madh. Fëmija mund të mos jetë i vetëdijshëm për ditët e dobësisë së prindërve të tij, për shkak të preokupimeve të tij të përditshme ekonomike apo shqetësimëve që ka në lidhje me fëmijët e tij. Ai mund të ketë harruar të mirat që i kanë bërë atij prindërit, kur ka qenë vetë fëmijë.

Por është Krijuesi, ai që na tërheq vëmendjen në lidhje me këtë fakt.

Krijuesi që kërkon prej nesh të shlyej-më detyrimin tonë të "besnikërisë".

Krijuesi që na edukon.

Ky përkujtim hyjnor, që i thërrët fëmijët të sillen me mëshirë dhe dhembshuri në shekullin tonë, kur prindërit janë të detyruar të jetojnë në vetmi, është po aq i vlefshëm, sa edhe ajri dhe uji për njeriun.

Njeriu nuk duhet ta harrojë se këtë thirrje hyjnore e ka nga Krijuesi, që i ka dhuruar çdo gjë, përfshirë edhe jetën, që i ka falur fuqinë, shëndetin e mirë, të mirat, forcën e rinisë, që ka të drejtë, por edhe të marrë atë që dhuron dhe që, kur merr mbrapsht diçka që ka dhënë më parë, nuk merr parasysh moshën apo ndonjë gjë tjeter.


Nuk ka dyshim që, nëse paralajmërimi hyjnor qëndron në një kërkesë, atë e ndjek pas edhe llogaria.

Njeriu duhet ta marrë parasysh edhe llogarinë që ka për të dhënë. Do të vijë një ditë, kur do të japë llogari para Zotit, nëse u ka hyrë në hak prindërve të tij.

Do të vijë një ditë, kur do të japë llogari: "Pse u the "uf!" prindërve, pse i qortove ata, pse nuk i mbajte në krahët e tu me dhembshuri, pse e harrove kujdesin që kanë treguar ata ndaj teje, kur ishe i vogël, pse nuk u lute për ta?..."

Atë ditë duhet të dalim të pastër nga ajo llogari...

Kjo ka vetëm një rrugë. Të përgjigjemi në kohë ndaj thirrjes hyjnore.



# Edhe unë jam këtu

Zejneb Ozdil



A më dëgjoni? A më ndjeni mua? Pse të mos kem edhe unë vlerë në këtë jetë? Pse të mos kujtohen për mua? Pse të mos më përfillin...?

Të përpinqesh të gjesh mëshirë në krahët e dikujt!... Larg nënës dhe babait!...

Po ju thërras ju njerëz që besoni, me zërin që del nga shpirti që dëshiron të gjejë nënë!

A pati thënë edhe Pejgamberi: "Nuk është prej nesh ai që fle i ngopur, kur komshiu i tij është i uritur!..?"

Tani unë jam i uritur për dashuri dhe dhembshuri dhe po ulërij.

Ju, që në çdo rast thoni se jeni besimtarë, nuk më dëgjoni? Njerëz të mirë... Përherë kam kërkuar që të më kuptoni e herë pas here më kanë dalë përpara disa njerëz që doja t'i quaja "nënë" apo "babë", por nuk i meritonin këto fjalë... Çdo herë më përbuznin, i ngrinin ndjenjat e mia, si t'i vishnin me një mur.

Nuk më kuptonte askush. Natën, kur shtrihesha në shtrat, s'kisha pranë ndonjë vëlla, por shokët e braktisur të rrugës. Grindesha me ta, nuk isha i qetë, shumë netë më zinte gjumi me sy të përlotur.

Një zë që oshëtinte se kishte ardhur koha e "zgjimit", na thërriste për të ngrënë mëngjesin. Larg ndjenjave të ngrohta, me shpirti të ngurtësuar...Çdo mëngjes, përsëritej e njëjtë skenë, por përsëri ajo ngrohtësi më mungonte. Nuk e di sa herë hapja sytë në mëngjes dhe ngrihesha me shpresën se do të ishte aty pranë meje nëna apo babai dhe prapë i myllja me dëshirën që të mos i hapja sërisht.

Rritej ky shpirti i vogël me etjen për dashuri...

Vinin ndonjëherë disa gra të më qëndronin afër dhe të m'i plotësonin ndjenjat e nënës dhe, sapo mendoja me vete: "...në rregull, e gjeta, tashmë kjo nuk më lë", ajo më harronte sikurse nëna dhe babai. Njerëzit që mendoja se do të më merrnin dhe do të më çonin në vendin ku unë ëndërrroja, më jepnën dhurata që të mos qaja. Nga brenda më vinte t'u përplasja në fytyrë, për t'u treguar se ishte diçka tjetër ajo që doja.

Ja pra, me këto gjëra jam rritur unë. Tashmë nuk mjafton të ha thonjtë nga mërzitjet, dikur isha bërë të haja lëkurën e duarve.

Një ditë, një grua u mërzit shumë nga gjendja ime, por as ajo nuk arriti të më kuptonte dhe nuk më ndihmoi. Ndoshta

s'kishte mundësi të më ndihmonte.

Më pas vura re se të tjera ndjesi filluan të më mbushnin shpirtin... S'mjaftonin tashmë tabletat e daldisjes që merrja. Kjo nënkupte se duhesin më shumë të Holla. Kjo mund të realizohej me hajdutëri, me vjedhje ose me lypje.

Nga njëra anë, njerëzit që i kisha dashur si prindër, zunë të diskutonin për bukurinë time... A mendonin ndonjë gjë për mua, pa më pyetur? Pikërisht, a s'ishte kjo që do të bëhej? Pas moshës 18 vjeçare ose do të martohesha me një të panjohur, ose do të qëndroja aty ku isha dhe do pajtohesha me të gjitha shëmtitë e jetës.

Dhe ndërkokë që mendoja kështu, isha mu në mes të udhëkryqit. Ishin vuajtje dhe ndjesi të papërballueshme. Megjithatë, më dukej se prisja që diçka të më mbushte atë boshillëk në shpirtin tim...

E dija se Ai, "I mëshirshmi", nuk do më linte, si njerëzit përreth... Thua kisha jetuar përherë me këtë shpresë?! A mund të dilja nga kjo gjendje shkretëtire? Më dukej sikur po prisja një brez tjetër, të ushqyer nga burime të tjera.

Isha hedhur fluturimthi, duke thënë: - E dija se do të vintel... Për herë të parë, besoja të mos ndahesha më. Drita e ardhur, ishte dritë besimi. Ajo ishte pranë meje, për mua, dhe jo si njerëzit e tjerë, për vete.

Fjalët që rridhnin nga goja, ushqenin shpirtit tim të mekur, gati sikur po ndiznin zjarrin që ishte në të shuar... Ndërkaq, po shndriste tashmë besimi që i nevojitej kujtdo! Sapo merrte të largohej, kishte mbërritur ndihma e Zotit. Prej vitesh një shpirti i djegur për dashurinë ndaj Allahut dhe të Dërguarit që zgjatej drejt duarve të mia për të më shpëtuar.

Ju, o njerëz të mirë, që e ndjeni veten myslimanë!.. Ju që jeni në atë gjumin tuaj të ëmbël, në vendet e qeta të punës, në shtëpitë tuaja të ngrohta, mos harroni të dëgjoni zërat e atyre që hakërrehan sikurse unë dikur, për të thënë "jam edhe unë këtu".

Jepni edhe ju ndihmën tuaj!...



# Drita e besimit dbe e Mevludit

Ma. Muhidin Ahmeti

## Ç'ESHTË BIDATI/RISIA

Kuptimi gjuhësor (filologjik) i fjalës bidat na tregon për çdo formë të risisë ose për çdo gjë që është e re dhe interesante. Kuptimi i saj në shariat ka të bëjë me instalimin e çfarëdo risie në fe, pavarësisht në është pozitive apo negative. Kur është fjalë për qëndrimin e ulema-së së shariatit ndaj bidatit, këtu ekzistonjë mendime të ndara, mbi bazën e të cilave janë profilizuar dy qëndrime plotësish të ndryshme. Grupi i parë i ulemasë së shariatit janë ata të cilët çdo lloj të bidatit (qoftë pozitiv apo negativ) e konsiderojnë, në mënyrë të përgjithshme, negativ dhe të ndaluar. Në këtë grup bëjnë pjesë: Ibn Tejmie<sup>1</sup>, Ibn Rexhep El-Hanbeli dhe imam Zerkashi. Mendimin dhe qëndrimin e tyre, ata e mbështesin kryesisht në argumentet vijuese: Në ajetin e tretë të sures El-Maide, Allahu (xh.sh.), thotë: **"Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha islamin fe për ju."** Në këtë kuptim, ky grup ulemash shfrytëzon edhe disa hadithe të Pejgamberit (a.s.), sikurse janë: "Kush sjell diçka të re në çështjen (fenë) tonë, që nuk i përket asaj, ajo është redd (refuzohet)" (Buhariu dhe muslimi). "Kush vepron diçka që nuk ka bazë në fe edhe ajo është redd (e refuzuar)." Çdo bidat është lajthitje dhe çdo lajthitje përfundon në zjarr." Kësaj ata i shtojnë edhe fjalimin e Ibni Mes'udit, në të cilin thuhet: "Vetëm ndiqni e mos sillni risi, meqë feja është e mjaftueshme." Gjithashtu, transmetohet nga Ibni Abbasi: "Çdo vit që kalon, njerëzit ringjallin gjithnjë e më shumë bidaate shkatërrojnë gjithnjë e më shumë sunete,

1. Mirépo, për sa i përket mevludit, Ibni tejmeje, nuk e konsideron atë si bidat, përkundrazi, e konsideron vepër të mirë që shpërblet.

Në Librin "Iktidaa Es-Sirat El-Mustekijm", nga ibn Tejmije, i cili vdiq në vitin 728 hixhrij, libri u botua nga: "Dar El-Fikr - Bejrut Liban", në vitin 1421 hixhrij, në faqen 269 shkruan, si vijon:

"Mevludi që respektohet dhe konsiderohet festë, që disa njerëz janë duke e bërë, kjo vepër ka shpërbllim shumë të madh, për qëllimin e mirë të tyre, që e bëjnë, për të nderuar dhe respektuar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të)".

gjithnjë, derisa të gjallërojë plotësishit bidati, e të zhduket suneti." Ky grup shfrytëzon edhe disa hadithe të tjera si argumente, por, për shkak të vëllimit të tekstit, nuk kemi nevojë për përmendjen e tyre. Në pjesën e mëparshme të tekstit, me siguri janë përmendur argumentet më të rëndësishme me të cilat paraqitet ky grup ulemash. Në çdo rast, ata mendojnë, duke komentuar ajetin e përmendur nga sureja El-Maide: "Sot përsosa për ju fenë tuaj...", që futja e çfarëdo risie në fe do të ishte e panevojshme dhe e padëshiruar. Në pajtim me këtë, ata besojnë që bidatet në fe (besim), vetëm se mund ta shkatërrojnë sunetin e Pejgamberit (a.s.) dhe ta shtrembërojnë besimin.

Grupi i dytë i ulemasë së shariatit, në të cilin bëjnë pjesë: Imam Shafiu<sup>2</sup>, Ibni Hazmi, Ibn El-Xhevzi, Ibn El-Esir, Imam Gazaliu, Imam Neveviu, Imam Sujuti, Ibn Haxher El-Askalani, El-Iz ibn Abde-s-Selam, Ibn Abidin El-Zerkani dhe El-Karafi, si dhe shumë dijetarë të tjerë të njohur nga të katër medh'hebët, kanë pikëpamje krejtësisht të ndryshme lidhur me çështjen e bidatit (risisë në fe). Ky grup, jo vetëm që pohon se ka bidat të mirë, por se ekziston edhe bidati, futja e të cilin në fe paraqet farz të rreptë. Ata konsiderojnë se të gjitha këto nuk janë në kundërshtim me ajetin e përmendur të sures El-Maide, meqë kanë vendosur një kusht të rreptë që bidati i cili futet, duhet patjetër të jetë i bazuar në shariat dhe të mos jetë në kundërshtim me dispozitat ekzistuese islame. Këta dijetarë argumentojnë se të gjitha hadithet, të cilët i sjell grupi i parë, në të vërtetë, kanë të bëjnë vetëm me ato bidate të cilat janë në kundërshtim me dispozitat ekzistuese islame. Për më tepër, ata konsiderojnë që disa prej këtyre haditave, të

2. Imam Shafiu (r.a.), në një thënë të tij rrëth ndarjes së bidatit, thotë: "Ka dy lloje të bidateve: Të qortuara edhe të lavdëruara. I lëvduar është ai bidat që është në pajtim me sunetin, i qortuar është ai që është në kundërshtim me sunetin". Neveviu, po ashtu thotë: "Bidati në shariat, është një shpikje që s'ka qenë në kohën e Pejgamberit (a.s.) e ai mund të jetë i mirë ose i keq!"

cilat grupi i parë i ulemasë i ka sjellë si argumente, bëjnë të kundërtën, d.m.th. tregojnë për mundësinë e futjes së bidateve (të dobishme) në fe, sikurse është hadithi: "Kush bën diçka që nuk ka bazë në fe, ajo është redd (refuzohet)." Nëse vështrojmë me kujdes këtë hadith, do të kuptojmë që Pejgamberi (a.s.), ka thënë që do të refuzohet ai bidat, i cili nuk ka bazë në fe. Për këtë, përgjigjen do të na e japë Pejgamberi (a.s.), në hadithin që transmeton Imam Muslimi: "Kush sjell në islam ndonjë gjë të mirë, ai ka shpërblim për të edhe shpërbimin e atij që e praktikon atë pas tij, e që atyre (d.m.th. atyre të cilët e praktikojnë atë) asgjë nuk u pakësohet nga shpërblimi i tyre. E kush sjell në islam ndonjë gjë të keqe, ai ka dënim për të, por edhe dënimin e atyre që do ta praktikojnë atë e që asgjë nuk u pakësohet nga dënim i tyre."

Ka edhe shumë hadithe që flasin për të njëjtën temë, sikurse është hadithi të cilin e transmeton Ebu Hurejre (r.a.), në koleksionin e Muslimit, i cili është i ngjashëm me hadithin e mëparshëm. Që bidati është i lejuar dhe i preferuar në fe, e shohim në praktikën e sahabëve të Pejgamberit (a.s.). Që kur ishte gjallë Pejgamberi (a.s.), ishte një sahab, ndaj të cilit u ankuau sahabët e tjerë, për shkak se në çdo rekat e këndonte suren El-Ihlas. Kur Pejgamberi (a.s.) e pyeti, se për ç'arsye e praktikonte këtë, ai u përgjigj se e donte atë sure, në çka Pejgamberi (a.s.), buzëqeshi dhe i tha: "Edhe Allahu të do ty për këtë veprim tëndin." Pejgamberi (a.s.), i dha përkrahje këtij sahabi dhe nuk e qortoi, për shkak të futjes së bidatit. Në një hadith tjetër, thuhet se Pejgamberi (a.s.), e pyeti hz. Bilalin: "O Bilal, i kam dëgjuar hapat tuaj në xhenet, çfarë ke bërë ti kështu?" Hz. Bilali iu përgjigj: "Unë vetëm e kam bërë praktikë që pas çdo marrjeje abdesti të fal dy rekate namaz. Pejgamberi (a.s.), buzëqeshi dhe nuk tha gjë se ajo është bidat, për të cilin nuk ka argument në Kuran apo në sunet. Imam Buhariu na transmeton një hadith, në të cilin thuhet se në një rast, në kohën e namazit, ndërsa Pejgamberi (a.s.), ngríhej nga rukuja këndoi: "SemiAllahu limen hamideh", njëri nga sahabët prej xhematit, ia shtoi: rabbena leke-l-hamden kethiren tajjiben mubareken fihi." Pas përfundimit të namazit, Pejgamberi (a.s.), pyeti se kush e kishte thënë atë dua. Kur sahabi përkatës u përgjigj, Pejgamberi (a.s.), tha: "I kam parë tridhjetë melaqe, të cilat nxitonin kush ta shkruante e para atë." Nga kjo, shohim se Pejgamberi (a.s.), nuk e kritikoi këtë sahab, për shkak të këndimit të këtij dhikri të ri, veçse e lavdëroi dhe e paraqiti si një bidat të mirë. Imam ibn Haxher El-Askalani ka thënë se ky hadith konsiderohet argument për të lejuar futjen e ndonjë dhikri të ri, i cili nuk bie ndesh me dhikrin tradicional. Në praktikën e sahabëve të Pejgamberit (a.s.), pas vdekjes së tij, ka qenë e njohur futja e bidateve, të cilat nuk kanë qenë të njohura sa ka qenë në jetë Pejgamberi (a.s.). Kështu, dimë se hz. Ebu Bekri (r.a.), e ka tubuar Kuranin në një libër, edhe pse Pejgamberi (a.s.), nuk e ka bërë këtë. Po ashtu, hz. Omeri (r.a.), bëri faljen kolektive (me xhemat) të namazit të teravisë dhe atë prej 20 rekatesh, ndërsa Pejgamberi (a.s.), falte tetë rekate dhe atë në shtëpinë e tij. Kur e bëri këtë, tha: "Sa risi e mirë është kjo!" Gjithashtu, është i njohur rasti i hz. Osmanit (r.a.), i cili bëri këndimin e dy ezanëve për namazin e xhumasë e më pas, i shtoi edhe

një dhe bëri tre ezane, për shkak të përhapjes së bashkësisë myslimanë, ndërsa gjatë kohës kur ishte gjallë Pejgamberi, ishte vetëm një ezan për namazin e xhumasë. Gjatë jetës së Pejgamberit (a.s.), namazi i Bajramit falej në një vend, por hz. Alia (r.a.), solli vendimin që të falet në më shumë vende. Edhe Abdullah bin Omeri (r.a.), bëri që në teshehud të këndohet ve berekatuhu, që është një shtesë në fjalin es-selamu alejeke ejjuhen-nebijju ve rahametullahi ve berekatuhu dhe po ashtu edhe vahdehu la sherike lehu – në fjalinë eshhedu en la ilahe il'IAllah.

Në  
bazë  
të asaj  
që u  
përmend  
më lart, sho-  
him që sahabët  
kanë sjellë bi-  
date, të cilat kanë  
qenë shumë të  
lavdëruara. Disa  
janë futur gja-  
të jetës së  
Pejgambe-  
(a.s.), e disa të tjera pas vdekjes  
së tij.

## NË VEND TË PËRMBYLLJES

Myslimanët e gjithë botës nuk e festojnë, nuk e kretnojnë, veçse e shënojnë mevludin e kjo do të thotë që nga ajo ngjarje marrin mësim dhe me të frymëzohen. E çfarë janë mësimet nga fjalët e Eminës: "Kur e linda atë, linda një dritë të madhe, nga e cila u shndritën pallatet e Shamit (Damaskut)". Ose fjalët e Eminës, të shprehura nga goja e përpiluesit të mevludit:

"Tha Eminja, pashë at'natë  
çudi një dritë

Sikur dielli për dritare kur rr-  
zitë

Si vetimë shpejt duel prej shpie  
çudë u bë

Gjithë dynjaja me këtë nur që dritë u  
bë"

A e sheh njeriu i sotëm  
atë dritë? Drita të cilën du-  
het ta shohim quhet – Kur'an,  
ndërsa rruga e ndriçuar, nga e cila duhet  
të shkojmë, e ka emrin Islam. Dritë në jetë është  
besimi, dritë është dituria, dritë është familja kompakte,



fëmija ynë në mektesë shëtë dritë, dritë shëtë oborri ynë i rregulluar dhe rruga e pastër, dritë shëtë puna, rendi dhe përgjegjësia në shoqëri... A e sheh njeriu i sotëm këtë dritë, e cila aq fuqishëm shndriti në muajin rebiul-evvel? Ai muaj quhet muaji i lindjes. Kemi rastin të bëjmë të lindë në veten tonë dëshira që t'ia kthejmë shpinën dritës së rrejshme të epshit dhe të nisemi rrugës për te drita e vërtetë e besimit (fesë). Drita në shpirtin tonë vjen prej islamit, prej namazit, prej këtij mevludi. Drita e Allahut shkëlqen në shtëpi të caktuara, "drita shkëlqen në shtëpitë, në të cilat përmendet emri i Tij dhe e falënderojnë Atë mëngjes e mbrëmje. (Nur, 36) Allahu (xh.sh.), thotë: "**Kurani shpie nga ajo që shëtë më e mira, më e madhja, më e fuqishmja.**" (Kuran, 179) Islami i çon njerëzit nga ajo që shëtë më e mirë në jetë, nga ajo që shëtë më e bukur. Prandaj, Kurani dhe islami duhet të jenë në zemrën e njeriut dhe në shtëpinë e tij. Pejgamberi i Allahut (a.s.), thotë: "Shtëpinë ndriçojeni me këndimin e Kurabit dhe faljen e namazit". Ky shëtë ai nuri, ajo drita, e cila erdhi me Pejgamberin tonë dhe të cilën e këndojmë në mevlud. Sepse, nëse në shtëpi nuk ka Kurani dhe namaz, mbetet shejtani, mbetet errësira.

Lindja e Muhamedit (a.s.), nuk shëtë vetëm lindje e njeriut, por edhe e një ideje, e cila e pushtoi kozmosin dhe u bë nur-dritë apo reflektim i qiejeve karshi tokës dhe i tokës karshi qiejeve. Dhe siç vjen drita e ditës nga dielli, ashtu drita në shpirtin tonë vjen nga Kurani, në të cilin shëtë e vërteta e Zotit, të cilën me besnikëri na e përcollë më i miri prej njerëzve të mirë dhe më i madhi nga pejgamberët e mëdhenj të Allahut – Muhamedi (a.s.).

Marrë në përgjithësi, thelbi dhe esenca e kësaj çështjeje qëndron në faktin që islam duhet kuptuar dhe jetësuar. Duhet të depërtojmë në vetë thelbin dhe esencën e jetës së Pejgamberit (a.s.), në mënyrë që të kuptojmë misionin e tij jetësor, që ta njohim shpirtin e tij. Kemi raste, kur njerëzit mësojnë me mijëra hadithe apo siç thuhet, "i nxjerrin si prej xhepit", por nuk e kuptojnë vlerën e tyre të vërtetë, as shkakun, për ç'arsye Pejgamberi (a.s.), e ka thënë apo ka aprovuar një gjë. Shpesh pyes veten sa e njeh në të vërtetë një mysliman Muhamedin (a.s.), sa e admirojmë atë në të vërtetë dhe sa e si duhet ta duam atë në të vërtetë. Sa i aplikojmë porositë e tij në jetën tonë të përditshme dhe sa e ndjekim shembullin e tij në jetën tonë në përgjithësi.

### SI DUHET TË ORGANIZOHET MEVLUDI?

Autori i veprës Misanul-adil, thotë: "Ceremonitë e mevludit, me të cilat shënohet lindja e Pejgamberit (a.s.), janë të bazuara në islam dhe janë të dëshiruara e të rekomanuara. Unë e kushtëzoj të praktikuarit dhe aplikimin e tyre me kushtet vijuese:

1. Që ceremonia të fillojë me këndimin e pjesëve kuranore.

2. Leximi apo këndimi i teksteve, të cilët përbajnjë detaje nga jeta e Pejgamberit (a.s.), përmendja e disa mu'xhizeve dhe momenteve prej të cilave mund të mëret mësim.

3. Që të pranishmit të këndojnë salavate, sa herë që përmendet emri i Pejgamberit Muhammed (a.s.).

4. Që manifestimi të përbajë ilahi, kaside dhe recitime mbi Muhamedin (a.s.), të cilat janë të mbështetura në Kitabët mu'teber.

5. Shmangia e transmetimeve ngajeta e Muhamedit (a.s.), që nuk janë të bazuara në traditën autentike.

6. Të mos lejohet përzierja e grave dhe burrave në të njëjtën hapësirë (ihtilat)

7. Respektimi dhe aplikimi i edukatës së përgjithshme islamë (kultura e sjelljes), duke mos lejuar në asnje mënyrë dhe measnje veprim të dilet jashtë kuadrit të mënyrës islamë të sjelljes (bontonit islam).

8. Të mbahet një ligjëratë e shkurtër përbajtjesore (10-15 minutash), nga e cila do të përfitojnë të pranishmit në jetën e tyre, duke marrë mësim për veten, familjet dhe njerëzit e tjera në përgjithësi.

O Allah i Gjithëfuqishëm, na forco në qëllimin tonë që ta ndjekim Sunetin e Muhamedit (a.s.).



O Allah i Gjithëdijshëm, na mëso që Muhamedi (a.s.), të jetë shembull në jetën tonë!

O Allah i Gjithëmëshirshëm, le të jetë shefaati i Muhamedit (a.s.), mëshira Jote! (Literatura: Mevludi në gjuhën shqipe Mr. Muhibdin Ahmeti, Wels –Austri)

Argumentet të cilat konfirmojnë se festimi i ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.), shëtë vepër e lejuar të zbatohet (xhaiz)!

Përmendet në "Sahihul Buhari" se Pejgamberi (a.s.), ka

përmendur se Ebu Lehebi, për çdo ditë të hënë i lehtësohej dënim i zjarrit të xhehenemit, për arsy se nga gjëzimi e kishte liruar robëreshën e tij, e cila e kishte informuar për lindjen e Muhamedit (a.s.). (Kitabun Nikah)

Disa nga dijetarët mendojnë se festimi dhe gjëzimi për ditëlindjen e Pejgamberit (a.s.), është qartësuar edhe nga ajeti 58 i kaptinës Junus: **"Thuaj: Vetëm mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij le t'i gjëzohen ..."**. Sipas komentatorëve të Kur'anit, mirësia më e madhe është dërgimi i Pejgamberit (a.s.) dhe rahmet për çdo send, pastaj gjëzimi për ardhjen e Pejgamberit (a.s.), është gjë e porositur.

Se lejohet të festohet ditëlindja e Pejgamberit (a.s.), disa nga dijetarët e mbështesin mendimin e tyre në hadithin e transmetuar nga Muslimi që, kur është pyetur Pejgamberi (a.s.), pse agjeron ditën e hënë dhe të enjte, ai është përgjigjur: "Se në këtë ditë (e hënë) kam lindur dhe mu në këtë ditë ka filluar të më vijë shpallja", (Sahihul Muslim, kitabu Sijam). Po ashtu, këta përmenden faktin se Pejgamberi (a.s.), ka prerë kurban për ditëlindjen e tij.

## QËNDRIMI I DIJETARËVE TË NJOHUR

*"Më e mira risi që është paraqitur në kohën tonë, është ajo çka veprohet çdo vit për ditëlindjen e Pejgamberit (a.s.), duke u dhënë sadaka dhe duke u shprehur gjëzimi për lindjen e Muhamedit (a.s.) dhe respektin ndaj tij, duke e falënderuar Zotin e gjithësisë që e ka dërguar Muhamedin (a.s.), si mëshirë për mbarë botët".*



1. Imam Sehaviju (r.a.), thotë: "Edhe po qe se në këtë nuk ka kurrfarë dobie, përvëç asaj që shejtani do të hidhërohet dhe besimtarët do të gjëzohen, do të mjaftonte (për t'u festuar ditëlindja e Pejgamberit (a.s.)".

2. Dijetari i madh El-Kastalaniju thotë: "Vazhdhimisht myslimanët, pas tri gjeneratave, e festojnë ditëlindjen e Muhamedit (a.s.), duke dhënë sadaka të ndryshme, duke shfaqur gjëzim, duke i shtuar veprat e mira, duke lexuar historikun e lindjes së Pejgamberit (a.s.), dhe mu për këtë,

ata kanë begati dhe bereqet".

3. Dijetari Ebu Shame (r.a.), mësuesi i imam Neveviut (r.a.), thotë: "Më e mira risi që është paraqitur në kohën tonë, është ajo çka veprohet çdo vit për ditëlindjen e Pejgamberit (a.s.), duke u dhënë sadaka dhe duke u shprehur gjëzimi për lindjen e Muhamedit (a.s.) dhe respektin ndaj tij, duke e falënderuar Zotin e gjithësisë që e ka dërguar Muhamedin (a.s.), si mëshirë për mbarë botët".

4. Komentatori i Sahihut të Buharis, dijetari i madh dhe shejhul Islami Ibn Haxher El-Askalaniju, është pyetur për festimin e ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.) dhe është përgjigjur kështu: "Në parim, kjo vepër është risi, e cila nuk është zbatuar nga tri gjeneratat e para (sahabët, tabi'inet dhe tebei tabi'inet), mirëpo, në këtë veprim (festim) ka gjëra të mira, dhe për këtë mund të konkludojmë se është risi e mirë. Këtë e mbështes në atë që përmendet në Buhari dhe Muslim, se Pejgamberi (a.s.), kur ka arritur në Medine, i ka parë Jehudit duke agjerouar ditët e ashures dhe i ka pyetur ata përsë agjerojnë? Ata i kanë thënë: "Kjo është dita kur Allahu e ka përbysur Faraonin, e ka shpëtuar Musain, dhe për këtë agjerojmë si falënderim ndaj Allahut". E Pejgamberi (a.s.), u tha: "Ne jemi më të denjë se sa ju, të agjerojmë për Musain!".

## VETË PEJGAMBERI E KA FESTUAR DITËLINDJEN E TIJ

Vetë Pejgamberi (s.a.v.s.), e ka festuar ditën e tij të lindjes. Në një hadith të transmetuar nga Enesi (r.a.), në Suneniin e Imam Bejhekiut, v.9 fq. 300 nr. 43, tregohet që Pejgamberi (s.a.v.s.), sakrifikoit disa kafshë dhe kreu akikën për vetën e tij, pas shpalljes së Pejgamberisë. Imam Sujutiu deklaron që kjo nuk ishte akika e tij në sensin tradicional, sepse gjyshi i tij tashmë e kishte bërë akikën e tij. Nuk është e lejuar të përsëritet një akt sheriatic, që tashmë është kryer. Imam Sujutiu deklaron që arsyja për sakrificën e kafshëve është akt i falënderimit dhe përkujtimi nga Pejgamberi (s.a.v.s.), për lindjen e tij. Imam Sujutiu konkludon që është mustehab, e pëlqyeshme për ne, që të festojmë mevludin në tumbim bashkërisht, pasi Pejgamberi (s.a.v.s.), sakrifikoit kafshë dhe shpërndau ushqimin, prandaj edhe ne duhet të bëjmë tubime dhe të shpërndajmë ushqime dhe të gjëzohemi në mënyrë të mirë. Husn Meksid fî 'Amel-il mewlid nga Imâm Xhelâl ud-Dîn es-Sujûti, fq. 64-6. Disa kritikë mund të argumentojnë se, meqë akika e Pejgamberit (s.a.v.s.) është bërë në periudhën e xhahilitet, ai deshi ta ripërsëriste atë, që të siguronte efektshmërinë e saj. Mirëpo, ky argument nuk është i pranueshmë, pasi ai që argumenton me këtë, duhet të përgjigjet se pse nuk janë përsëritur veprat e tjera nga Pejgamberi (s.a.v.s.). Për shembull, pse nuk e ka përsëritur nikahun e tij me Hazreti Hatixhen (r.a.), që e ka bërë para Pejgamberillëkut? E është e ditur që nikahu është më i rëndësishëm se akika, pasi është farz e akika është mustehab. Të ishte e nevojshme ripërsëritja, do të fillonim prej akteve prioritare, si nikahu e jo prej akteve jo të detyrueshme, të pëlqyeshme si akika.

# ZEMRA

## dhe misteret e saj

Përshtati: E. Kaduku



### ZEMRA DHE MISTERET E SAJ

Trupi i njeriut është makina më e komplikuar dhe më e përsosur në botë. Ne shikojmë me të, dëgjojmë me të, marrim fryshtë me të, ecim dhe vrapojmë me të, dhe ndjejmë kënaqësi me të. Eshrat e tij, muskujt, arteriet, venat dhe organet e brendshme janë të organizuara me një krijim të mrekullueshëm, dhe kur shikojmë këtë krijim në detaje gjejmë fakte edhe më mahnitëse. Në këtë artikull interesant për kureshtjen e atyre të cilët meditojnë rreth fakteve në vetvetet e tyre dhe përreth, do të flasim për zemrën dhe misteret e saj. Përpara se të flasim rreth mistereve dhe zbulimeve të fundit, do të flasim pak rreth anatomisë dhe fiziologjisë së saj.

### FAKTE DHE SHIFRA

Zemra e njeriut ka një strukturë tepër të vecantë, biles të mrekullueshme. Pjesa përbërëse kryesore e zemrës është muskuli i saj, i cili quhet miokard. Miokardi është i përbërë nga disa shtresa, apo nga disa pjesë përbërëse, që funksionojnë si një e tërë, por anatomikisht përfaqësojnë një strukturë të mrekullueshme helikoidale.

Struktura helikoidale është një strukturë të cilën e gjejmë kudo në natyrë, duke qenë pjesë përbërëse e

një kompozicioni të saj të magjishëm. E gjejmë nga guaskat e detit, në lulen e diellit, në brirët e kafshëve të cilat fortësinë e tyre ia detyrojnë pikërisht kësaj strukture helikoidale. Gjithashtu e gjejmë në brishtësinë e luleve, në bukurinë e trendafilit, në strukturat e atmosferës, në ndërtimin dhe përbërjen e kodit tonë gjenetik ku përcaktohen tiparet tona dhe pikërisht në ADN humane dhe në ADN e cdo lloj përbërësi organik të ketij planeti, e gjejmë në ndërtimin e universit. Madje strukturën e mahnitshme helikoidale e gjejmë edhe në falenderimin dhe nënshtrimin e muslimanëve gjatë tauafit rreth kabes.

Këto krahasime vlejnë për të treguar dhe kuptuar që ndërtimi i zemrës humane konsiston në aplikimin e një strukture anatomike-gjeometrike që ne e gjejmë në jetën e përditshme dhe që përbën nukleusin e universit që na rrëthon, që përbën misterin e lindjes dhe kompozitionit të jetës në këtë planet. Ja pse në artin e të medituarit në do të gjenim përpunhet dhe analogjitet me këtë organ kaq magjepsës. Kjo ngjashmëri e universit, galaktikave, atmosferës, tauafit në qabe, komponentëve të tjera të gjallë që na rrëthojnë me një nga organet tona kryesore është thjeshtë një koïncidencë, është thjeshtë një arsy që i garanton fortësinë dhe qëndrueshmërinë apo mund të jetë dicha tjetër? Ndërsa citojmë fakte të



tjera, meditoni rreth kësaj pyetjeje.

Zemra është pompa që ushqen më shumë se 300 milionë qeliza në trupin e njeriut. Pesha e saj arrin në 250-350 gramë dhe ka përmasat e një grushti. Që në fazën embrionale në barkun e nënës (22 ditë pas fillimit të barrës), zemra bën pompimin e gjakut për në pjesët e ndryshme të embrionit të sapo formuar. Kur rritemi, zemra jonë pompon më shumë se 7000 litra gjak çdo ditë gjatë shtrëngimit dhe lëshimit të saj. Pra, ajo rreh më shumë se 100 mijë herë në ditë. Rreth moshës shtatëdhjetëvjeçare, zemra ka pompuar një milion fuçi gjak gjatë kësaj periudhe.

Për të çmuar rolin e saj të pabesueshëm, na mjafton të dimë se qelizat e trurit mund të shkatërrohen në mënyrë të pakthyeshme nëse ato privohen nga furnizimi me gjak te oksigjenuar për pesë minuta.

A është e mundur që një sistem kaq perfekt të jetë formuar një ditë nga rastësia, në mënyrë perfekte dhe nga vetvetja?

### COPË MISHI APO DIÇKA MË SHUMË?

Zemra është një organ që punon pa pushim. Ajo i ka intriguar njerëzit për shekuj me radhë. Grekët e lashtë mendonin se zemra ishte zona e inteligjencës. Shumë prej poetëve dhe dijetarëve arab e shikonin atë si mbretin e kështjellës, dhe gjymtyrët e tjerë si ushtarët e saj. Të tjerët mendonin se ajo ishte burimi i emocioneve.

Shumica e studiuesve mendojnë se zemra është thjesht një copë mishi dhe ndërrimi i saj nuk shkakton asnjë pasojë tek i sëmuri, përvèc disa ndryshimeve të vogla psikologjike për shkak të operacionit. Disa mendojnë se zemra e përmendur në Kur'an është në kuptimin alegorik dhe jo zemra që ne shohim, njëloj si shpirti. Atëherë, si qëndron e vërteta në këtë cështje?

E vërteta është se, në qoftë se do të ndiqnim thëniet



e mijekëve perëndimorë, të cilët kanë dhënë kontribut të madh në fushën e kardiologjisë, do të shihnim se një pjesë e tyre e pranojnë që nuk e kanë studiuar zemrën nga ana psikologjikë dhe se këtij aspekti të rëndësishëm nuk i është kushtuar ende vëmendja që meriton.

Zemra krijohet para trurit të fetusit dhe fillon të rrahë që nga momenti i formimit e deri në vdekjen e njeriut. Ndonëse shkencëtarët besonin se është truri ai që regullon rrahjet e zemrës, ata vunë re dicka të habitshme gjatë procesit të transplantimit të zemrës: kur vendosnin zemrën e re në gjoksin e pacientit, ajo fillonte të rrihte mënjanëherë, pa pritur që truri të jepte urdhrin për të rrahur. Kjo shpreh qartë pavarësinë e zemrës nga truri. Por, sot disa studiues mendojnë se është zemra ajo që e orienton trurin në punën e tij, madje cdo qelizë e zemrës ka kujtesën e vet. Doktor Shvarc thotë se historia jonë është e shkruar në cdo qelizë të trupit tonë.

### RASTE TË HABITSHME

Ka pasur shumë raporte të pabesueshme rreth organeve të transplantuara, mbi të gjitha të zemrës, të cilat kanë trashëguar apo transferuar kujtesë, përvoya dhe emocione nga donatorët e tyre të vdekur, duke shkaktuar ndryshime në personalitetet e tyre. Janë bërë kërkime të ndryshme, mbi 300 raste të transplantimit të zemrës dhe përfundimi është se në shumicën e rasteve kanë ndodhur ndryshime jo vetem psikike dhe emocionale pas operacionit, por ndryshime edhe në personalitetit të tyre.

Në 1997, u publikua një libër i quajtur "Një ndryshim i Zemrës" që përshkruante ndryshimet e dukshme të personalitetit të pérjetuara nga Claire Sylvia. Në 1988 ajo bëri një transplant të zemres dhe mushkërive në Spitalin Yale-New Heaven. Ajo thotë se kishte ndryshuar sjelljet, shprehëtë dhe shijet pas ndërhyrjes. Ajo kishte dëshira të pashpjegueshme për ushqime që më përpara nuk i kishte pëlqyer. Për shembull, edhe pse ajo ishte një balerinë dhe koreografe e shëndetshme, pas daljes nga spitali ajo kishte një kërkësë të pashpjegueshme për të shkuar në restorante dhe të porosiste ushqime që ajo nuk i kishte ngrënë kurrë. Sylvia e gjeti veten të tërhequr në drejtim të ngjyrave të lehta dhe nuk vishte më te kuqe të ndritshme dhe portokalli që ajo preferonte. Ajo filloi të sillët në mënyrë agresive dhe impulsive, që nuk ishin pjesë e cilësive të saj, por pas kërkimeve rezultoi që sjelja të tillë ishin të ngashme me personalitetin e dhuruesit të saj.

Një rast tjetër, na tregon më së miri vlerën dhe rolin e zemrës në formimin e karakterit të njeriut. Një vajzë e cila kishte pas një sëmundje të rëndë të zemrës, kishte bërë transplant të saj, duke marrë zemrën e një djali të ri, të vdekur në një aksident automobilistik. Babai i vajzës tregon se ajo ishte e egër, e prapë, derisa ajo u sëmur, dhe pas transplantit dhe daljes nga spitali ajo ndryshojet sjellje, duke shpreh madje edhe një dëshirë të pashpjegueshme për të dëgjuar muzikë. Në fakt dhuruesi sipas deshmive te prinderve te tij kishte qënë muzikant dhe shkruante shpesh poezi.

Janë me qindra e qindra rastet, në të cilat kanë ndodhur ndryshime të thella. Kështu p.sh. një vajzë tre vjeçë u mbyt në pishinën e shtëpisë dhe prindërit e dhuruan zemrën e saj që të transplantohen te një fëmijë nëntë vjeçar. E cuditshme eshte se, më pas, ky fëmijë nisi të kishte hidrofobi (frikë nga uji), madje u thoshte prindërvë që të mos i hidhnin ujë.

Një fakt që tërheq vëmendjen është se pacientët, të cilëve u është transplantuar një zemër artificiale, kanë humbur ndjesitë, ndjenjat dhe aftësine për të dashuruar!

Gazeta "Washington Post" botoi një vëzhgim gazetaresk rreth një personi, të quajtur Peter Houghton, të cilil i ishte bërë transplantimi i një zemre artificiale. Ky pacient thoshte: "Ndjenjat e mia kanë ndryshuar tërësisht. Nuk di më si të ndiej si të dashuroj. Madje, as për niperit e mi nuk ndiej gjë dhe nuk di si të sillem me ta. Kur ata me afrohen, nuk e ndiej se ata janë pjesë e jetës sime, sikurse ndjehesha më parë".


Deri sot, mjekët nuk kanë mundur të japid një shpjegim për këtë dukuri. Përse ndodh ky shndërrim i madh psikologjik? Cila është lidhja e zemrës me personalitetin e njeriut. me ndjenjat dhe mendimet e tij?! Prof. Arthur Caplan, Drejtor i Departamentit të Etikës Mjekësore në Universitetin e Pensilvanisë, thotë: "Shkencëtarët nuk i kanë kushtuar rëndësi kësaj dukurie; madje ne nuk e kemi studiuar lidhjen e ndjenjës dhe të shpirtit me organet e trupit, por e trajtojmë organizmin sikur të ishte thjesht një makine".

## ZEMRA DHE ZBULESA KURANORE

Shkencëtarët flasin sot seriozisht rreth memories, trurit që gjendet në zemër, që përbëhet përafërsisht nga 40 mijë qeliza nervore. Pra, ajo që ne quajmë "mendje", gjendet gjithashtu në qendër të zemrës dhe është ajo që shpesh orienton trurin për të kryer detyrat e tij. Prandaj dhe Krijuesi i saj e ka bërë atë organ për të

menduar. Ai thotë në Kur'an: "Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë e të kenë zemra me të cilat **të kuptojnë** dhe vesh që të dëgjojnë? Me të vërtetë, nuk i kanë sytë e verbër (në këto gjëra), por u janë të verbëra zemrat e tyre, që i kanë në krahëror. (Haxh, 46) Ky ajet na ka përcaktuar vendin e zemrës, e asaj zemre që beson, që kupton, dhe që gjendet në krahë dhe jo në kokë, pra te truri. Argumentet e Krijuesit, përvec sfidës ndaj mendjes në tru, ka sfiduar më së shumti mendjen e zemrës, mendjen e besimit.

Sot, një pjesë e mirë e shkencëtarëve, në vecanti të psikologëve flasin për rolin e madh që luan zemra në procesin e të kuptuarit dhe të përceptuarit të gjërave



që na rethojnë. Këtë na e ka thënë Kur'ani në ajetin: "...ata kanë zemra (mend) me të cilat nuk kuptojnë..." (El-Araf: 179). Pra, Kur'ani e ka përcaktuar qartë qendrën e të kuptuarit te njeiru, dhe ajo është zemra.

Shumica e atyre që bëjnë transplantim të zemrës artificial ndiejnë se zemra e tyre e re është e ngurtë, ndiejnë një ashpërsi të cuditshme në gjokset e tyre dhe e kanë humbur besimin, ndjenjat dhe dashurinë. Këtë gjë e ka treguar Kur'ani, nëpërmjet ligjërimit që ua drejton cifutëve; "Por, pastaj (mbasi i patë këto argumente) zemrat tuaja u forcuan e u bënë si guri ose edhe më të fortë..." (Bekare, 74) Pra, Kur'ani na ka cituar dy prej karakteristikave të zemrës: fortësinë dhe butësinë. Prandaj Ai ka thënë për jobesimtarët: "...Mjerë ata që e kanë zemrën të pandjeshme kur përmendet Allahu; Ata janë në humbje të qartë!" (Zumer, 22) Ndërsa për zemrat e atyre që besuan dhe e adhuruan Atë thotë: "...e mandej qetësohen dhe kënaqen lëkurat dhe zemrat e tyre, kur përmendet Allahu (dhe prem-timi i Tij)." (Zumer, 23) Shkencëtarët theksojnë se cdonjera nga qelizat e zemrës përbën një depozitë për infomacionin e ngjarjet, prandaj ata kanë filluar të flasin për kujtesën e zemrës. Për këtë arsy e edhe Allahu ka theksuar se cdo gjë gjendet në zemër dhe se Ai e vë në provë atë cka kemi në zemër: "...e Zoti ju vë në luftë, ju sprovon për t'ju gjurmuar dhe për t'ju pastruar atë që keni në zemrat tuaja. Se Allahu, me të vërtetë din ç'keni në zemrat tuaja. (Ali Imran, 154)

Kërkimet mbi zemrën artificiale kanë dëshmuar faktin se zemra luan një rol themelor në ndjenjën e frikës dhe të trembjes. Kur e kanë pyetur një njeri që kishte vënë zemër artificiale rrëth ndjenjave të tij, ai ka thënë se nuk kishte më frikë dhe nuk interesohet për të ardhmen. Këtë gjë e ka thënë Kur'ani para 14 shekujsh, kur ka theksuar se zemrat frikësohen: "Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur të përmendet Zoti, vërgëllojnë (nga frika dhe përulja), e kur t'u lexohen argumentet e Tij, iu shtohet thellimi në besim dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten, ata që kryejnë namazin dhe japin nga pjesa e asaj që u kemi dhënë Ne. (El Enfal:2-3).

Ka thënë Profeti (a.s.): "Allahu me të vërtetë në Tokë i ka enët e Tij. Enët e Zotit tuaj janë zemrat e robërve të Tij të mirë. Ndërsa, zemrat më të dashura tek Ai janë zemrat e buta dhe më të mira!"

Zemra sëmuret, ashtu siç sëmuret trupi, ndërsa ilaçi i saj është pendim dhe përpjekje për të bërë punë të mira. Zemra ndotet ashtu sikurse ndotet edhe pasqyra, ndërsa pastrohet me njohjen dhe falenderimin e Krijuesit. Zemra mund të jetë pa rroba sikurse trupi, ndërsa rrobat dhe stolia e zemrës është devotshmëria. Zemra ndjen urinë dhe etjen sikurse trupi, ndërsa ushqimi dhe pijë e tij janë dituria, njohja e Krijuesit të tij, dhe dashuria ndaj Tij. Et-Tirmidhiu e ka theksuar një transmetim nga i Dërguari i Zotit (paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të), në të cilën thuhet: "Kur drita hyn në zemër, ajo shpërndahet dhe kthjellohet!". Ata që ishin të pranishëm, pyetën: "Si do ta njohim atë, o i dërguari i Zotit?". Ai i tha: "Vrapin pas botës së përhershme, përbajtjen nga bota e mashtrimeve dhe përgatitjen për ditën e vdekjes para se ajo të vijë!". Kur zemra e humb ndjenjën e dashurisë dhe të falenderuarit ndaj Krijuesit, e ka më të veshtire se sa kur humb thjeshtë funksionin e saj si pompë gjaku, kur syri i humb te pamunit, ose kur veshi humb te degjuarit. Prandaj zemra eshte mashtruese, fatkeqe, e brengosur, e mjere, e pikelluar, perderisa nuk e njeh Zotin e vet. Lumturia ne kete botë dhe në tjetër varet nga pastertia e zemrës, ndersa fatkeqesa nga prishja e saj. I lutemi Allahut te Madheruar qe nga mëshira dhe bujaria e Tij te na fale zemer te shendoshe dhe të singertë. Ne trup është një cope mish, nëse ajo është në rregull tërë trupi është në rregull ndërsa nëse ajo prishet, atëherë prishet i tërë trupi, ajo është zemra" (Buhariu)

## LITERATURA

1. Abd El-Daim El-Kehil, "Zemra me të cilën mendojmë".
2. Ajad. A, "Shërimi i trupit dhe shpirtit".
3. Shkoza. A, "Fiziologjia e njjeriut".
4. Prifti. E, "Arti i kardiologjisë".
5. Ibën Kajim El-Xheuzi, "Thesari i diturisë".

# Zbritja e Kuranit pjesë-pjesë

Ma. Gilman Kazazi

Në këtë numër do të flasim rreth zbritjes së Kuranit; kur filloj, sa zgjati zbritja e tij dhe cila ishte urtësia e zbritjes pjesë-pjesë.

Kurani ka filluar të zgresë në natën e Kadrit dhe ka vazduar për 23 vite, 13 vite në Mekë dhe 10 vite në Medine. Sipas disa dijetarëve, më saktësish 12 vite, 5 muaj dhe 13 ditë në Mekë dhe 9 vite, 9 muaj dhe 9 ditë në Medine.

Allahu thotë: "Muaji i Ramazanit, kur filloj të shpalley Kurani, i cili është udhërrëfyes për njerëzit, sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i së vërtetës nga gjenjeshtra) ..." (el-Bekare, 185)

"Ne e zbritëm atë (Kuranin) në natën e Kadrit." (Kadr, 1)

"Ne e zbritëm atë në një natë të begatë..." (Duhan, 3)

Ajetet e Kuranit janë të ndërlidhura njëri me tjetrin, sqa-rojnë dhe shpjegojnë njëri-tjetrin. Kush e lexon Kuranin, duhet të jetë i vëmendshëm në lidhjen që kanë ajetet njëri me tjetrin. Në ajetet e lartpërmendura, Allahu na tregon se Kurani ka filluar të zgresë në një natë të begatë, e cila është nata e Kadrit, një natë prej netëve të Ramazanit.

"Kurani është, pa dyshim, shpallje e Zotit të të gjithë botërave. E solli i besuari Xhebrail. Në zemrën tënde të bëhesh thirrës, lajmëtar, në një gjuhë të qartë arabe." (esh-Shuara', 192-195)

"Thuaj: "Atë e shpalli me të vërtetë shpirti i shenjtë nga Zoti yt, për t'i forcuar edhe më tepër ata që kanë besuar, si edhe të jetë udhërrëfyes e sihariq për të gjithë myslimanët." (en-Nahl, 102)

"Ilartësuar është Ai, që i ka shpallur Kurani (i cili ndan të vërtetën prej të pavërtetës), robit të Vet (Muhamedit), që të jetë paralajmëruar për botërat (njerëzit)" (Furkan, 1)

Gjatë 23 viteve, Kurani është shpallur pjesë-pjesë në varësi të pyetjeve, ndodhive a problemeve që kanë ndodhur në kohën e profetit Muhamed. Herë-herë zbriste një ajet i plotë, dy ajete, 5 ajete, 10 ajete ose një pjesë ajeti, e herë-herë një sure e plotë. Sureja el-Alak ka 19 ajete, ndër të cilat fillimisht janë shpallur 5 ajetet e para, pastaj më vonë është plotësuar sureja. Sureja ed-Duha ka 11 ajete, së pari janë shpallur vetëm 5 ajetet e para e më vonë është plotësuar. Sureja el-Fatiha, el-Keuther, en-Nasr dhe el-Ihlas, janë sure që u shpallen të plota që në fillim.<sup>1</sup>

Nëse dikush pyet se ku qëndron urtësia në zbritjen e Kuranit pjesë-pjesë?

Themi:

Allahu e tregon urtësinë në këto dy ajete:

1. "E ata që nuk besuan, thanë: përsë të mos i ketë zbritur atij (Muhamedit) Kurani përnjëherësh? Ashtu (e zbritëm pjesë-pjesë), që me të të forcojmë zemrën tënde dhe e sollëm atë ajet pas ajeti (dalëngadalë)." (el-Furkan, 32) Idhujtarët e Mekës ishin mësuar se, kur dikush thurte një poezi, e recitonte atë përnjëheri fillim e mbarim, po ashtu kishin dëgjuar nga çifutët se Teurati i Musait (a.s.), ka zbritur përnjëheri, kështu që pretendonin se edhe Kurani duhet të zgresë i gjithi pa shkëputje.

2. "Dhe Kuranin (ta shpallëm pjesë-pjesë) e ndamë për t'u lexuar njerëzve dalëngadalë..." (el-Isra', 106)

- Profeti Muhamed (a.s), gjatë thirrjes për në Islam, është ndeshur me vështirësi, shqetësimë, mundime, sprova dhe përgjënjeshtrime. Zbritja e Kuranit pjesë-pjesë, kontakti me Xhebrailin dhe shpalljen hyjnore, ia ka lehtësuar këto vështirësi, i ka dhënë kurajo e vullnet për të vazduar në misionin e tij, ia ka qetësuar mendjen dhe zemrën për t'i përballuar sprovat. Zbritja e ajeteve pak nga pak, e ka

1. Tahir el-Xhezairi, et-Tibjan liba'di el-mebahith el-mutealikati bil-Kuran, Bejrut, fq, 60.

nxitur atë për durim dhe vendosmëri, i përkujtonte ngjarjet e profetëve para tij dhe sprovat e tyre, e rikujtonte atë me forcën absolute të Allahut dhe premtimin e Tij në triumfin e Islamit.<sup>2</sup> **"Të gjitha këto që t'i rrëfyem ty nga lajmet e pejgamberëve, janë që të forcojnë zemrën tënde. Në to të ka ardhur e vërteta, këshilla dhe përkujtimi për besimtarët."** (Hud, 120) **"Po ty mos të të mundojnë thëniet e tyre. E tërë fugia dhe ngadhënimi i takon vetëm Allahut. Ai i dëgjon dhe i di të gjitha."** (Junus, 65)

- Profeti Muhamed (a.s.), nuk ka ditur shkrim as lexim, po ashtu edhe shumica e popullatës së arabisë, në atë kohë ka qenë analfabete. Muhamed (a.s.), ishte shumë i kujdesshëm në përvetësimin e ajeteve kuranore që i shpalleshin. Dëshira e tij e zjarri për ta memorizuar Kuratin, e bënte atë të shpejtonte në leximin e tij. Allahu ka zbritur dy ajete për të treguar këtë realitet: "... **mos nxito në të lexuarit e Kurant (o Muhamed!) para se të përfundojë (shpalja e tij), dhe thuaj: "O Zoti im, shtoma dijeninë mua!"**" (Taha, 114) **"Mos nxito në të lexuarit e Kurant me gjuhën tënde, Ne, do t'i tubojmë pjesët e tij (Kuranit), për ta lexuar atë (si eshtë). E, kur ta lexojë Xhebraili atë (Kuranin), përcille ti leximin e tij e pastaj, Ne do ta shpjegojmë."** (el-Kijameh, 16-19). Pra, për ta lehtësuar dhe thjeshtësuar mësimin dhe leximin e Kurant, metoda më e mirë ka qenë zbritja e tij pjesë- pjesë, "... **për t'ua lexuar njerëzve dalëngadalë.**" (el-Isra', 106)

Në Kurantin famëlartë ekzistojnë disa ajete të zbritura për një kohë të caktuar, sipas rrëthanave të jetës së asaj periudhe. Këto ajete janë abroguar dhe shfuqizuar nga ana e Allahut gjatë jetës së profetit Muhamed, si shkak i ndryshimit të kushteve dhe rrëthanave. Imam Bahariu transmeton nga Aisheja (r.a.), se ka thënë: "Ajetet e para që janë shpallur, i kanë përkujtar njerëzit me xhenetin dhe xhehenemin (çështjet e besimit) e, pasi njerëzit janë përqendruar në besim, atëherë kanë zbritur ajetet e hallallit dhe haramit (ligjet). Sikur të kishte zbritur në fillim "mos pini alkoolin" ose "mos bëni imoralitet", nuk do ta kishin lënë alkoolin ose imoralitetin kurrë." Vihet re metoda edukative e Kurant dhe urtësia e Allahut në zbritjen e Kurantit pjesë- pjesë. Gradualiteti në edukimin e gjeneratave të para të myslimanëve, kërkonte shkallëzim në zbritjen e Kurantit. Largimi i idhujtarëve nga bestytnia, shkëputja e tyre prej zakoneve të prapambatura, vendosja e stabilitetit shoqëror mes fiseve arabe, nuk mund të bëhej përnjëherësh.

Kështu, në Kurant, alkooli u ndalua gradualisht, fazë pas faze. Në fazën e parë thuhet: **"Të pyesin për alkoolin dhe bixhozin. Thuaj: "Që të dyja janë mëkat i madh. Ka edhe ca dobi për njerëzit, por dëmi nga ato eshtë më i madh se dobia."** (el-Bekare, 219) Në fazën e dytë citohet: **"O besimtarë, mos iu afroni namazit, kur jeni të dehur, ..."** (en-Nisa, 43). Dhe në fazën e tretë urdhërohet: **"O ju që besuat, s'ka dyshim se vera, bixozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (përfall) janë vepra të ndyra nga shejtani. Pra,**

2. Shih: Prof. dr. Muhamed Ebu Shuhbeh, el-Med'hal lidirasetil-Kur'an, Kajro, 1992, fq. 65-66.

***largohuni prej tyre, që të jeni të shpëtuar.***" (el-Maideh, 90)

- Shpalosja e mrekullisë kuranore në zbritjen e tij pjesë- pjesë. Edhe pse Kurani u shpall gjatë një periudhe 23 vjeçare, ajetet dhe suret e tij janë harmonike, të ndërlidhura dhe pa kundërthënie. Mënyra e të shprehurit eshtë standarde dhe me një stil të lartë gjuhësor. Kohëzgjatja e zbritjes nuk ka ndikuar në lëkundjen e nivelit gjuhësor apo kuptimor. Sfida e Allahut, drejtuar poetëve të asaj kohe, për të sjellë një Kurant të ngjashëm, mbeti aktuale përgjatë gjithë periudhës së shpalljes.

- Disa pjesë të Kurantit janë zbritur si përgjigje e pyetjeve që i janë drejtuar profetit ose si zgjidhje e problemeve me të cilat eshtë ballafaquar profeti me sahabët e tij. P.sh:

1. Disa idhujtarë të Mekës shkuan te Profeti Muhamed e i thanë: "Na e cilëso, o Muhamed, Zotin tënd!" Atëherë Allahu shpall suren el-Ihlas dhe përshkruan cilësitet e Tij, duke thënë: **"Thuaj: Ai, Allahu eshtë Një. Allahu eshtë Ai, të cilit çdo kriesë i drejtohet për çdo nevojë. As s'ka lindur kënd, as nuk eshtë i lindur. Askush nuk eshtë i barabartë me të."** (Ihlas, 1-4)

2. Në një ditë xhumaje, kur Profeti Muhamed ishte në hytbe duke këshilluar xhematin, vjen një karvan tregtarësh nga Shami me ushqim, veshje dhe gjëra të tjera të nevojsme për medinasit. Zakonisht, kur vinte ndonjë karvan i tillë, përcillej me daulle për të lajmëruar banorët, por edhe si lojë e dëfrim. Kështu që, njerëzit e lëshuan dëgjimin e hytbes dhe shkuan të merreshin me tregti. Për këtë arsye, shpallet ajeti 11, i surel el-Xhumua dhe ku u tërhiqej vërejtja besimtarëve se furnizuesi më i mirë eshtë Allahu: **"Dhe kur ata shohin ndonjë tregti ose aheng, mësyhen atje, kurse ty të lënë në këmbë. Thuaju: Ajo që eshtë tek Allahu, eshtë shumë më e mirë se dëfrimi dhe tregtia e Allahu eshtë furnizuesi më i mirë."** (Xhumua, 11)


3. **"Të pyesin ty për verën dhe bixhozin, thuaju: që të dyja janë mëkat i madh..."** (Bekare, 219)

4. **"... të pyesin ty për bonjakët; thuaju: po t'i ndihmoni në punët e tyre, eshtë më mirë..."** (Bekare, 220)

5. **"Të pyesin ty për shpirtin; thuaju: shpirti eshtë kriesë e Zotit tim e juve ju eshtë dhënë fort pak dixe."** (Isra', 85)

6. Esmaë, vajzës së Ebu Bekrit, i erdhë nëna (Kutejleti ibnetu Abdil-Uza) për vizitë, kur ajo ishte ende idhujtare, me ç'rast i solli dhurata e ushqime. Vajza refuzoi të pranonte peshqeshet dhe ta fuste nënën në shtëpinë e saj. Për këtë, Aishja e pyeti Profetin (a.s.), Allahu zbriti ajetin: **"Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë e as nuk ju dëbuani prej shtëpive tuaja; Allahu i do ata që mbajnë drejtësi."** (el-Mumtehineh, 8). Atëherë, ajo u urdhërua t'i pranonte peshqeshet dhe nënën e saj.

Lexues i nderuar, edhe pse Kurani u zbrit pjesë-pjesë për arsyet e lartpërmendura, tanë ai eshtë i plotë para jush. I zbritur për t'ju udhëzuar kah e bukura, për t'ju qetësuar zemrën dhe për t'ju ndriçuar mendjen. Përdoren edhe ju urtësinë e të lexuarit pjesë-pjesë, ashtu siç edhe Kurani u shpall pjesë-pjesë.



# Modeli i njeriut me vatër dashurinë -1-

Atilla Jargëxhë

Bota sot, nga një anë, éshtë duke eksposuar zhvillimet marramendëse teknologjike dhe shkencore, ndërsa nga ana tjetër po bën hapa prapa dhe éshtë duke jetuar kaos nga aspekti i vlerave humane dhe moralit. Njeriu që nuk njeh limit që nga krijimi, për sa i përket potencialit të mendjes, pasionit dhe zemërimit, ka dalë nga shinat dhe ka rënë në ekstremizë, për arsy se e ka privuar veten nga zbatimi i parimeve hyjnore që vendosin një rregull për këto potenciale humane dhe, duke humbur drejtësinë në caktimin e një ekuilibri mes këtyre ndjësive, éshtë duke dëmtuar veten, ambientin, shoqërinë dhe të gjithë njerëzimin.

Pangopësia dhe ambicia e njeriut bëri që bota të mbytej në gjak sa e sa herë vetëm në shekullin e kaluar. Arsyet kryesore të kësaj situate janë shenjtërimi i shkencës në vend të fesë, rritja e ndikimit të mendimit dhe rrymave materialiste mbi njeriun, heqja e besimit në Zot dhe dashurisë në emër të Zotit, nga zemra e njeriut. Personi që nuk ushqen besim dhe dashuri për Zotin, dhembshuria dhe mëshira e të Cilit nuk njeh kufi, e ka të pamundur që të dojë, t'i dhimbset, të mëshirojë dhe të tregohet i ndjeshëm ndaj rrethit të njeriut, të cilin Zoti e krijoj si krijesën më fisnike. Në vend që të donte Allahun, ta adhuronte Atë dhe të donte njerëzit e tjerë në kuptimin e adhurimit, njeriu konsideroi idhuj të tij interesat personale, pasionet e tij dhe shkencën dhe nuk e pati për gjë që gjithçka ta bënte theror për hir të këtyre idhujve. Botëkuptimi që ka humbur boshtin e tij, që ka humbur rrugën e arsyses dhe ka dalë nga linja e besimit, që shkaktari i vdekjes së qindra miliona njerëzve dhe la po aq të gjyqtuar në shekullin XX, që disa autorë

e quajtën edhe "shekulli i mega-vdekjeve", këto dyzet-pesëdhjetë vitet e fundit éshtë duke pasur ndikim në shoqëritë e ndryshme njerëzore nga një aspekt tjetër. Tani njerëzit nuk e duan më njëri-tjetrin. Ata e shohin njëri-tjetrin si "kokë turku". Martesat janë shndërruar në martesa interesash, po ashtu edhe miqësitë janë shndërruar në miqësi interesash. Njeriu i perëndimit, që e ka refuzuar krishtërimin si model jete, për shkak të qëndrimeve të gabuara të kishës dhe që nuk e lejon islamin të hyjë në jetën e tij, jeton duke qenë i palumtur dhe duke mos ditur ç'është dashuria, me gjithë kaq shumë avantazhe që i ka ofruar atij civilizimi. Me fjalë të tjera, ndjenja e dashurisë që njeriu duhet të ushqejë për njerëzit e tjerë, e kanë kthyer drejtimin kah objekte pa shpirt, siç janë makina, paraja, shtëpia, mallrat e konsumit të luksit dhe rrobat e modës. Qasja ndaj jetës, sa vjen e bëhet më mekanike, ndërsa njeriu éshtë duke u shndërruar në një makinë që duhet trajtuar si një objekt pa shpirt.<sup>2</sup>

Për këtë arsy, njeriu perëndimor dhe çdo gjë që ndodhet nën kontrollin e tij, janë në kërkim të dashurisë së humbur, të cilën nuk e zëvendëson asnjë gjë tjetër. Filmat, romanet, serialet televizive, çdo e ditë e më shumë nxjerrin në pah frytet e hidhura të mungesës së dashurisë. Familja éshtë institucion i prekur më shumë nga dashuria që ushqehet për çdo gjë tjetër, përvçse njeriut. Në shumë vende perëndimore me në krye SHBA, përqindja e divorceve ka kapur shifren shtatëdhjetë. Një pjesë e familjeve nuk dëshirojnë të kenë fëmijë, si rezultat i dashurisë së génjeshtërt që ushqejnë brenda tyre, ndërsa të tjerat i kanë shndërruar fëmijët në viktivi


ma të shoqërisë, për shkak të divorceve që kanë kryer. Në shtetet myslimanë përqindja e divorceve është më e ulët, krahasuar me shtetet e tjera, por edhe në këto shtete po vihet re një rritje e këtij fenomeni. Kjo tregon se modeli i jetës sipas tipit perëndimor, është duke ndikuar për keq në familjen e shteteve myslimanë. Në këtë artikull do të përpinqemi që të paraqesim zgjidhjet që ofrohen nga perspektiva kuranore, me qëllim daljen nga kjo krizë e mungesës së dashurisë, të cilën po e përjeton një pjesë e madhe e njerëzimit.

### A. NGJASHMËRIA MES SHOQËRISË NË TË CILËN U SHPALL KURANI DHE SHOQËRISË SË DITËVE TONA

Rrethi në të cilin u shpall Kurani përbëhej nga njerëz, për të cilët marrëdhënia e dashurisë qe korruptuar. Me fjalë të tjera, dashuria mes Zotit dhe njeriut, mes njeriut me njeriun dhe mes njeriut me rrëthin dhe ambientin që e rrëthonte, ishte demonizuar. Para së gjithash, po të mos llogarisim ato pak thërrime që kishin mbetur nga feja e drejtë, në të cilën e kishte ftuar njerëzimin profeti Ibrahim, në shoqërinë e xhahilijes dalin në plan të parë idhujt, nga aspekti i marrëdhënieve së dashurisë mes Zotit dhe njeriut. Idhujtarët i konsideron idhujt që i bën me duart e tyre, si ndërmjetës mes tyre dhe Zotit, tek i cili vetëm me gojë sa pohonin se i besonin. (Zumer, 3, 38) Sipas fjalëve që përdor vetë Kurani, idhujtarët u jepnin rëndësi idhujve pa shpirt, pa ndjenja, pa frymë, që i bën me duart e tyre dhe i donin si të donin vetë Zotin. (Bakara, 165) Ndërsa në një ajet tjetër thuhet: ***"Idhujtarët e braktisën Allahun në jetën e kësaj bote dhe u morën me dashurinë dhe adhurimin e idhujve."*** (Ankebut, 25) Për këtë arsy, mund të themi se, kur njerëzit e xhahilijetit filluan të ushqenin dashuri ndaj idhujve, ata filluan njëkohësisht të mbronin një botëkuptim të jetës, në qendër të së cilës ndodhej dashuria për idhujt. Fakti se idhujt që gjenden në Qabe bënte që fiset e tjera arabe të kishin më konsideratë për Meken, duke pasuruar në këtë mënyrë vetë mekasit, luajti një rol të rëndësishëm në përhapjen e kultit të idhujve. Nga ana tjetër, dashuria që njerëzit ushqenin për njëri-tjetrin ishte aq e vogël, saqë nuk mund të merrej në konsideratë. Nuk mund të thuhet se marrëdhënia që kishin krijuar me fiset e tjera këta njerëz që e konsideron dhunën si vlerë burrerie, që e kupto-

nin atë si virtytshmëri dhe që thurnin vargje poetike, ku shpreheshin se "Po nuk u tregove i keq me njerëzit, do të tregohen ata të këqinj me ty", të mbështetej mbi dashurinë e ndërsjellët. Kështu për shembull, Dhuhej b. Ebu Thulma, njëri nga poetët e njohur të poezeve muallaka, reciton vargjet: "Ata që nuk e ruajnë me forcën e armëve vendin, pozitën dhe fisin e tyre kanë fund të hidhur. Ai që nuk ushtron dhunë mbi të tjerët, meriton të nepërkëmbet prej tyre."<sup>4</sup>

Për këtë arsy, ata e konsideronin të drejtë një ambient ku i forti bënte padrejtësinë që donte, sepse nuk kishte kush t'i dilte kundër. Në këtë shoqëri, ku herë pas here ndodhë që vajzat e vogla të groposeshin të gjalla, ekzistonte diskriminimi i femrës përpara burrit dhe ndaj fëmijëve vajza nuk ushquej dashuri. (Nahl, 58-59; Zuhraf, 18; Tekvir, 8)



Gjithashtu, gruaja nuk kishte më shumë vlerë sesa një objekt që mund të shitej dhe të blihej. Mund të thuhet shumë lehtë se gratë, pothuajse nuk kishin asnjë të drejtë.<sup>5</sup> Mbështetur në gjithë këto fakte, mund të thuhet se atmosfera që sundonte në shoqërinë e xhahilijetit, nuk formohej nga dashuria, por nga urrejtja, armiqësia dhe dhuna, ndërsa marrëdhënia mashkull-femër nuk ishte gjë tjetër përveç se një "marrëdhënie shfrytëzimi".<sup>6</sup>

Ndërsa në ditët tona shohim se vendin e dashurisë ndaj idhujve në shoqërinë e xhahilijetit, e kanë zënë sërisht objektet pa shpirt, që nuk i japin karshillëk njeriut. Shprehur me fjalë të tjera, një grup

njerëzish që e kanë shndërruar veten në perëndi, i kanë shndërruar në idhuj interesat e tyre dhe mjetet që mundësojnë komoditetin e tyre dhe kanë filluar t'i duan objektet sikur të donin Zotin vetë, ashtu siç i donin një herë e një kohë idhujtarët idhujt e tyre. Nga ana tjetër, njeriu i ditëve të sotme nuk arrin të shprehë dhembshurinë dhe dashurinë e vërtetë ndaj fëmijëve të tij, qofshin djem ose vajza, për shkak se janë përqendruar vetëm në këtë botë dhe në përfitimet materiale të saj. Njeriu i sotëm materialist është duke i dëmtuar fëmijët e vegjël më shumë se sa njeriut i shoqërisë së xhahilijetit. Nuk ka dyshim se njeriu i xhahilijetit kryente krimin më të rëndë, duke mbytur fëmijën e vogël, duke u hequr atyre të drejtën e jetës në këtë botë dhe, ashtu siç thuhet në Kur'an, kanë për të dhënë llogari për këtë veprim në botën

tjetër. Në të shumtën e rasteve, njeriu i sotëm përpinqet vetëm që fëmija i tij të edukohet, në mënyrë që të fitojë një post dhe një punë të mirë në këtë botë, ndërkohë që nënvlefëson aspektin e tij moral dhe shpirtëror, duke e shkatërruar jetën e tij të përjetshme.

Po t'u hedhim një sy marrëdhënieve mes njerëzve dhe shoqërive, do të shohim se, megjithëse ka kaluar kaq shumë kohë, në vend të dashurisë, përherë në plan të parë kanë dalë urrejtja dhe barbaria. Gjithashtu, nuk mund të lëmë pa përmendur edhe këtë dallim: Në qoftë se në kohën e xhahiljetit barbaria dhe dhuna brohoritej dhe duartrokitej, në ditët e sotme dhunën e kemi përpara, vetëm se të veshur me petkat e drejtësisë. Bota është dëshmitare e personave që shprehen se vënë drejtësinë në vend dhe, nga ana tjetër, mbajnë qëndrim barbar, kur as nuk u dridhet syri, teksa kryejnë çdo lloj padrejtësie.

Nga ana tjetër, në periudhën e xhahiljetit gruaja ishte e zhveshur nga shumë të drejta dhe blihej e shitej si plaçkë, ndërsa në ditët e sotme shohim se gruaja në shoqëritë perëndimore është duke u shfrytëzuar fizikisht dhe seksualisht në emër të lirisë. Nuk mund të lëmë pa përmendur faktin se ky lloj shfrytëzimi nuk shfaqet vetëm në shoqëritë perëndimore, por edhe në shoqëritë lindore, që guxojnë të imitojnë verbërisht Perëndimin.

#### **B. FORMIMI I NJERIUT ME VATËR DASHURINË: BAZA E BESIMIT DHE MARIFETIT**

Situata në të cilën gjendet shekulli ynë, na obligon edhe një herë më shumë që t'i ofrojmë njerëzimit prozimet që këshillon Kurani, në lidhje me zgjidhjen e problemeve me qendër dashurinë për njeriun. Kjo situatë na kushtëzon që ta lexojmë me kujdes Kur'anin, në mënyrë që të gjejmë zgjidhjet që na ofrohen në lidhje me këtë çeshtje.

Njëra nga arsyet më të mëdha, që qëndron pas deformimit të marrëdhënies së dashurisë mes njeriut të sotëm dhe Allahut, është fakti se zjarri i besimit në zemra është shuar. Gjithçka fillon atëherë kur të ndizet sërisht ky zjarr. Botëkuptimi pozitivist, i privuar nga baza e besimit, të cilin filozofia e iluminizmit ia dhuroi njerëzimit, krijoi në mendjet e njerëzve pengesa të vështira për t'u kapërcyer. Shkaqet më të mëdha, që qëndrojnë pas faktit që

njerëzit janë të zhveshur nga dashuria për Zotin, njeriun dhe shoqërinë janë mungesa e besimit ndaj Zotit, mosnjohja e Tij e vërtetë dhe mosbesimi ndaj ahiretit.

Zoti e ka pajisur njeriun me aftësi dhe mundësi perceptimi në mënyrë që ai të njohë Zotin, atributet e Tij dhe t'i besojë Atij. Njeriu ka për detyrë vetëm t'i vërë në përdorim këto aftësi, që të njohë dhe besojë tek Zoti dhe këtë duhet ta bëjë me vullnetin e tij. Për të realizuar këtë gjë, ai duhet para së gjithash që të mendojë. Mendja e njeriut thotë se asnjë gjë nuk mund të bëhet vetveti dhe në mënyrë të rastësishme. Asnjë njeri me logjikë të shëndoshë nuk mund të pohojë se makina prodhohet prej pjesëve të saj vetveti. Dhe kompjuteri përpara nesh nuk mund të jetë rezultat i rastësisë. Tavolina ku ulemi, lapsi me të cilin shkruajmë, rroba që veshim janë të gjitha të prodhua nga duart e një mjeshtri. Nuk

ka njeri me mendje të shëndoshë që nuk e di këtë gjë. Ja pra, njohja nga ana jonë e kësaj të vërtete dhe meditimi, na shtyjnë të mendojmë edhe rreth kriesave që nuk janë prodhim i punës së njeriut. Meqenëse kompjuteri që kryen shumë funksione, nuk mund të krijohet vetveti, atëherë si mund të jetë krijuar vetveti njeriu që e ka prodhuar atë? Në qoftë se tavolinën e ka prodhuar një person, po pemët me të cilat bëhet tavolina, kush i krijoi? Për më tepër, çdo gjë e krijuar në këtë botë është dizajnuar në mënyrë që t'i shërbujej njeriut. Largësia mes diellit dhe botës, hapësira mes hënës, botës dhe diellit janë përcaktuar me një precizion të përpiktë nga Dikush që ka menduar për të mirën e njeriut. Të

mendosh se atmosfera që rrëthon planetin tonë nuk është krijuar nga një Individualitet me dhembshuri dhe dashuri të pafundme, do të thotë se nuk dëshiron që ta vësh mendjen në punë. Pra, duhet të ketë një Individualitet, që ka menduar për të gjitha hollësitë dhe zotëron fuqinë që t'i realizojë ato.

Njeriu e ka të pamundur t'i realizojë të gjitha këto me fuqinë e tij. Krijesat e tjera nuk kanë as mundësinë ta logjikojnë një gjë të tillë. Për këtë arsy, ekziston një Krijues që ka fuqi t'i kryejë të gjitha këto dhe i njeh në mënyrën më perfekte nevojat e njeriut. Ai është vetëm Një. Regulli dhe harmonia në gjithësi, mospasja e asnjë konfuziteti në këtë harmoni, tregojnë se Ai është "Një". (Enbjia, 22)



# Çfarë presin të moshuarit nga të rinjtë



*Salih Zeki Meric*

Kur ishim fëmijë na dukeshin shumë të mëdha moshat tridhjetë-dyzet vjeç dhe në veten tonë shfaqej një ndjenjë sikur nuk do ta arrinim asnjëherë atë moshë. Vitet rritheshin në syrin tonë dhe pothuajse formonin një kohë që nuk mbaronte kurrë.

Veten tonë e ndjenim të sigurt sikur të kishte një jetë të pafundme në portin e këtyre viteve madhështore, të cilat dukej se nuk do të mbaronin. Madje, kur njeriu arrin moshën tridhjetë-dyzet vjeç edhe këtë herë i vjen sikur nuk arrihen vitet gjashtëdhjetë-shtatëdhjetë.

Kjo ndjenjë që formohet te fëmijët, vazhdon edhe në vitet e rinisë. Kur njeriu martohet e bëhet me grua e fëmijë dhe pastaj e kthen kokën prapa, shikon se kanë kaluar vite të cilat ia vlen të shënohen. Kështu, në vend të përjetimeve që nuk kalojnë më tutje se ndjenja, ai ka mbresa më reale.

Plekëria, si një zgjatje e pjekurisë, përkufizohet si një kohë ku shikohen ndryshimet fizike dhe shpirtërore në periudhën e mëpasme të jetës.

Jetën e njeriut mund ta ndajmë në katër klasa: fëmijëria, rinia, pjekuria dhe plekëria. Plekëria është periudha më e vështirë që përjetohet në jetën e njeriut. Ajo është një pjesë kohe, ku njeriu bëhet i ndjeshëm nga aspekti fizik e ndjesor, ku dobësohet dhe kur ka nevojë për kujdesje.

Njeriun e tmerron ndjenja se me kalimin e viteve po i afrohet një fundi të pashmangshëm. Ajo është një kohë kur ai mendon se jeta që ka jetuar, ka rrjedhur si uji ose kur ndjenja e mosvlerësimit të kimetit të viteve të kaluara ndikon shumë.

Ndërkohë që njeriu ndjen mallëngjim për të kaluarën, tashmë ai nuk mund të bëjë plane për të ardhmen. Por ka një të vërtetë që nuk ndryshon dhe ajo është fakti se njeriu nuk mund t'i rezistojë kohës dhe plaket.

Koha e plekërisë nga njëra anë, është një kohë kur shpresat për jetën kanë shteruar dhe nga ana tjetër është një kohë kur shfaqen pendimet rreth së kaluarës. Njeriu hyn në një gjendje shpirtërore në të cilën preket pothuajse si një fëmijë. Një të riu, sigurisht se është e vështirë t'i tregosh se çfarë psikologjia ka plekëria.

Sado që të plaket njeriu, përsëri nuk është aq e lehtë që të ushtronhet me plekërinë. Në çfarëdo moshe që të jetë, ai mendon se është herët për të vdekur. Por vdekja nuk shikon as moshën dhe as trupin.

Në literaturën e vdekjes nuk ka dallime. Kujt t'i plotësohet koha, vjen dhe e merr. Më i rëndësishëm, krahas kohës se

kur do të vdesim, është fakti se si do ta presim vdekjen, e cila vjen befasisht.

Të gjithë ata që kanë jetë të gjatë, herët apo vonë do ta përjetojnë ndjenjën e plekërisë. Para se të vijmë në këtë gjendje, duhet të meditojmë rreth kësaj pyetjeje: "Çfarë presin prej nesh njerëzit në moshën që ne e quajmë plekëri apo si duhet të sillemi kundrejt tyre?"

Kur ta vendosim veten tonë në vendin e atyre, mund t'u përgjigjemi më saktë këtyre pyetjeve.

Para së gjithash, të moshuarit duhet t'i bëjmë të ndjejnë se ata kanë një pozitë të lartë në shoqëri.

Ata nuk duhet t'i bëjmë që të ndjejnë mangësitë fizike e shpirtërore, që burojnë nga plekëria dhe duhet t'ua bëjmë të ditur se gjithmonë janë të vlefshëm.

Çdo njeri të moshuar që e takojmë në shoqëri, duhet ta konsiderojmë si më të afërmint tonë, madje si nënën e babain tonë dhe në atë masë të shfaqim respektin, dashurinë e më-shirën tonë ndaj tyre.

Gjendja me të cilën përballen më shumë njerëzit e moshuar, është vëtmia dhe ndarja nga shoqëria. Një njeri i moshuar, i cili e ndjen këtë, mund të kaplohet nga ndjenja se jeta që jeton tashmë nuk ka asnjë dobi.

Njerëzit përreth të moshuarve duhet ta dinë këtë, duhet t'i fusin ata në ambjente sociale dhe nuk duhet t'i lënë të përjetojnë ndjenjën e vëtmisë.

Të moshuarit duhet të jenë pasqyrë për njerëzit. Te ata duhet të shikojmë të ardhmen tonë. Mbartja e ndjenjës se një ditë do të plakemi edhe ne, na e lehtëson ndjeshmérinë.

Njeriu i moshuar, sado që të dobësohet fizikisht, në aspektin e përvojës së jetës është njeri që ka arritur gradën më të lartë. Për këtë arsy, secili prej tyre duhet të mbartë një vlerë të veçantë për ne.

Ata duhet të jenë njerëz prej të cilëve mund të përfitojmë dhe t'i pyesim për mendimet e tyre. Në këtë mënyrë, mund t'i rregullojmë ata dhe mund të përfitojmë nga përvaja e tyre.

Së fundi, vitet e rinisë në të cilat jemi të fortë e të fuqishëm dhe të cilave nuk ua dimë shumë vlerën, një ditë do t'ia lënë vendin plekërisë, e cila të bën të kujtosh stinën e vjeshtës.

Ndërkohë që jetojmë pranverën e jetës, nuk duhet të harrojmë se kjo pranverë ka edhe një vjeshtë dhe një dimër. Nuk ka nevojë që të presim të nesërmën për të korrrat atë që kemi mbjellë. I riu i kësaj dite, është i moshuari i së nesërmes. Çfarëdo që të mbjellim sot, do ta korrim nesër.

# NËNA dhe LIRIA

*Edison Çeraj*

Një herë, e patën pyetur Profetin Muhammed nëse mund ta shlyente ndonjëherë njeriu borxhin që ka ndaj nënës së tij dhe përgjigjja e Profetit ishte e prerë dhe e shkurtër: "Jo, asnëjëherë." Pasi dha përgjigjen, hodhi disa hapa për të ikur, por, aty për aty, ndoshta pa kaluar një minutë, u kthye dhe tha: "Vetëm në një rast: atëherë kur e gjen të robëruar dhe bëhet shkak për t'i (ri)dhënë lirinë".<sup>1</sup>

Çdo njeri që mund ta ketë çuar nëpër mend borxhin ose detyrimin që ka ndaj nënës së tij, ka dalë në përfundimin se nuk ka se si ta shlyejë ndonjëherë, qoftë edhe sikur të kemi parasysh vetëm një fakt, pa përmendur asnëjë tjetër nga mijëra syresh: nëna (edhe babai) është ajo që – pas Zotit, që është Krijuesi – na sjell në këtë jetë, me shumë e shumë mundime të parrëfyeshme. Dhe më pas, na rrit me dashuri dhe përkujdesje përsëri të parrëfyeshme, derisa hedhim hapat e parë mbi tokë dhe nxjerrim tingujt apo fjalët e para. Dhe jo vetëm kaq, por për aq sa nëna është gjallë, ne mbetemi fëmijë të saj dhe ajo shfaq ndaj nesh po të njëjtën dashuri e përkujdesje, pavarësisht se kur rritemi, ndonjëherë kjo na duket e tepruar, por në thelb nuk është aspak e tillë.

Në një varg të Kur'anit, Zoti ka vendosur, pas adhurimit të Tij, respektimin e prindërve.<sup>2</sup>

Përsëri në një thënie të Profetit, kur dikush e pyeti se cili është ai njeri që e meriton më shumë respektin tim, Profeti i tha: "Nëna jote".

Në një rast tjetër, Profeti është shprehur se "Paraja është nën këmbët e nënës".<sup>3</sup>

Besoj se në çdo gjuhë, fjala nënë thotë më shumë se çdo koment apo interpretim që mund t'i jepet, po kështu edhe në gjuhën tonë.

Por ja që qenka një rast, kur njeriu e shlyen borxhin që ka ndaj nënës së tij; dhe ky rast, siç e përmendëm më sipër,

është kur njeriu e gjen nënën e tij të robëruar dhe bëhet shkak për ta liruar atë. Në këtë rast kemi të bëjmë me rolin kyç të nënës në jetën e njeriut, nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër, me pozitën kyçë të lirisë.

Çdo qenie lind e lirë<sup>4</sup>, por jo çdo qenie e jeton lirinë sa dhe si duhet. Është e vërtetë se liria nuk kuptohet; ajo vetëm jetohet (Kant), por sidoqoftë e ngado që t'ia mbajmë, nevojitet një kuptim apo një perceptim i saj, sa në rrafshin individual e aq edhe në atë shoqëror.

Njeriu nuk mund ta përbushë qëllimin (ose fatin) e tij të ekzistencës, nëse nuk është i lirë, pasi, mbi të gjitha, ai nuk mund të bëjë atë që dëshiron<sup>5</sup> dhe që mendon se duhet të bëjë në këtë jetë. Pikërisht për këtë arsy, Profeti na mësoi se njeriu e shlyen borxhin ndaj nënës, nëse i jep lirinë pas rënies në robëri. Pra, sepse liria është rikthim në zanafillë, në atë gjendje në të cilën lindim.

*Për aq sa mund ta kuptojmë lirinë*

Të gjitha arritjet më të larta njerëzore janë bërë nga mirëushtrimi i lirisë. Nga kequshtrimi i saj, tragjikisht, janë bërë edhe fatkeqësítë më të mëdha të njerëzimit. Ajo është në themel të qenies njerëzore dhe ushtrimi i saj, për mirë apo për keq, ka pasur gjithmonë pasoja të jashtëzakonshme për njeriun. Parë si dhuratë apo si barrë, ajo nuk mund të shmanget dot. Ne nuk mund të shpëtojmë nga ajo, por ajo mund të na shpëtojë ose të na humbasë. Ne nuk mund të lirohem nga të qenët të lirë. Nuk do të kishte vlera njerëzore, nëse nuk do të kishte liri; ato janë ngritur mbi të. Një pjesë e konsiderueshme e mendimit dhe e përpjekjes njerëzore, ka të bëjë me kuptimin e lirisë. Liria është ajo që e bën njeriun njeri, sepse vetëm nëpërmjet saj, njeriu mund të përbushë ekzistencën e tij. Prandaj, ai nuk mund të shkëputet nga moraliteti, sepse moraliteti është shprehja e lirisë së tij, në mënyrën se si ai lidhet me veten dhe gjithçka rrötull, në realizimin e vetjakes së tij. Kështu që, kuptimi dhe realizimi i saj duhet të jetë objektivi

1. Citim nga memoria. Kjo thënie, ose ky fragment ngajeta e Profetit është i njohur dhe autenticiteti është i provuar.

2. "Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuroni askënd tjetër përvëç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë të ti, mos u thuaj atyre as "uh!", mos i kundërshto, por drejtoju atyre me fjalë respekti." (Kurani, 17/23)

3. Pavarësisht diskutimeve rreth autenticitetit të këtij hadhithi, kupt - mi i tij qëndron në mënyrë të padiskutueshme.

4. Madje edhe kafshët kanë lirinë e tyre, dhe kjo provohet kur ne ndërhyjmë në jetën e tyre, duke ua tjetërsuar natyrshmërinë përmes disa mënyrave që mund t'i shpikë vetëm njeriu, kur abuzon me lirinë e tij.

5. Përbrenda kufijve të parimeve universale dhe lokale.

i parë i njeriut.<sup>6</sup>

Njeriu mund ta realizojë lirinë vetëm në përputhje me natyrën e tij. Domethënë, liria nuk ka të bëjë vetëm me prirjen instinktive për të kundërshtuar kufizimet, pasi kjo haset rëndom te çdo gjallesë, si në botën shtazore, po ashtu edhe në atë bimore. Dihet shumë mirë se si reagon një kafshë apo një zog, kur ndryhet në kafaz; siç dihet fare mirë se çfarë ndodh me një lule, kur e mbyllim diku brenda, duke e privuar nga drita dhe rrezet e diellit. Pra, qenia nuk është vetëm aq sa e përfshin atë filozofia, biologjia apo psikologjia, sepse i bie që letërsia dhe arti në përgjithësi të jenë sfera krejt absurde e të padobishme deri në shpërfillje të plotë, meqë bëjnë fjalë për dimensionin tjetër të njeriut, atë dimension që shpesh i nënshtrohet harresës, dhe ky mbetet një problem ekskluzivisht individual.

Çështja që duhet, jo thjesht të kihet parasysh<sup>7</sup>, por të kuptohet sa më drejt ose sa më thellë të jetë e mundur – aq sa na lejon domeni njerëzor, jo tepër njerëzor – është se njeriu nuk është vetëm gjallesë, por më shumë se kaq.

Kjo do të thotë se, kur njeriu ia njeh kufijtë vetes dhe është i bindur për qenësinë e këtyre kufijve, për peshën kyçë të tyre, që lidhet drejtëpërdrejt me veçantinë e natyrës njerëzore, atëherë ai e provon katërcipërisht lirinë me të cilën lind. Një qenie që e zotëron dhe e përban veten, tregon haptazi se është e lirë, pasi një qenie e tillë, fjalë vjen, ndalohet/përbahet nga disa veprime, sikundërse, nga ana tjetër, është e bindur dhe e vetëdijshme se disa veprime të tjera duhen bërë. Domethënë, qenia zgjedh ndërmjet veprimit apo mosveprimit të një gjëje, dhe aty ku ka zgjedhje – kur qenia zgjedh – aty ka edhe liri. Ndërsa, kur dikush mendon apo shprehet se unë bëj ç'të dua, pra ç'të më vijë për mbarë dhe duke vendosur aty për aty në varësi të gjendjes (së qenies) dhe rrëthanave (të jashtme), atëherë ky njeri shfaq dukshëm varësinë tërësore që ka nga vetja dhe nga rrëthanat e rastit – pasi ai nuk u paraprin gjërvave, duke qenë i vendosur (si rrjedhojë e një besimi, ideje, mendimi apo parimi të caktuar), por vendos aty për aty, krejt i dorëzuar përpara rrëthanave; pra, parimi i kësaj kategorie njerëzish nën mbretërinë e harresës, është se nuk kanë asnjë parim.

Por njeriu mund të arrijë lirinë e jashtme dhe përsëri të mos jetë i lirë. "Kam parë skllevër të ecin kaluar dhe princër të ecin në këmbë", thotë Solomoni. Liria e vërtetë është liria e brendshme, kur njeriu është i lirë të vendosë. Liria kërkon përgjegjshmëri dhe njeriu i shmanget përgjegjësisë, madje edhe me koston e humbjes së lirisë. Kur u hoq bujkrobëria në Rusi, në vitin 1860, ndodhi një dukuri e çuditshme, por jo e rrallë në historinë e njerëzimit: shumë nga bujkrobërit nuk e priten mirë. Deri në atë moment, ata nuk kishin pasur asnjë përgjegjësi dhe kështu mund të qortonin të tjerët për vendimet. Gjithçka rrëth tyre vendosej nga të zotët e tyre; tanë ata duhej të vendosnin vetë. Kjo sillte përgjegjësi dhe, pikërisht këtë, ata nuk e donin.

6. Joani, 2001.

7. Na nevojitet përbrendësimi me mendje e me zemër, që sigurisht, nuk mund t'i behë papritur si një varg poezie, por përmes përpjekjes dhe ngulmimit të vazhdueshëm që duhet të ushtrojë njeriu në rrugën për ruajtjen e njerëzores.

Dëshironin më mirë të ishin jo të lirë, vetëm të mos kishin përgjegjësinë, ndonëse jo të gjithë ishin të vetëdijshëm pér këtë. "Liria – shkruan dr. Frankl – nuk është fjala e fundit. Liria është vetëm një pjesë e historisë dhe gjysma e së vërtetës. Liria është vetëm aspekti negativ i tërësisë së dukurisë, aspekti pozitiv i së cilës është përgjegjësia. Në fakt, liria ka rrezik të degjenerojë në arbitraritet, përderisa ajo nuk do të jetohet në kushtet e përgjegjësisë. Pér këtë arsy, rekmandoj që Statuja e Lirisë në bregun lindor, të plotësohet nga një Statujë e Përgjegjshmërisë në bregun perëndimor."<sup>8</sup>

Por pyetja që shtronet pashmangshëm, është se ç'është përgjegjësia dhe si arrihet ajo? Kjo është një temë më vete dhe, pér rrjedhojë, do një hapësirë më vete; por ajo që mund të thuhet përbledhtas, është se përgjegjësia – së pari në raport me Zotin e më pas me veten dhe me njerëzit – është ajo që nuk e lë njeriun të zgresë/bjerë nga statusi/gjendja e njerëzores, si gjendje zanafillore e qenies. Pra, mungesa e saj shkon në formë paralele me mungesën ose cenimin serioz të njerëzores përbredha.

Dhe tani, le ta prekim edhe pak çështjen e nënës, që mbase sot – vetë nëna si qenie dhe gjithë çfarë ajo përfaqëson, si institucioni më i lartë i një shoqërie – ndodhet në një pozitë problematike në marrëdhënie me vlerat, të cilat duhet t'i mbartë e t'i përcjellë. Mungesa ose cenimi i këtyre vlerave, që janë në domenin e nënës, do ta shndërronte një shoqëri në kope/masë, ose në një grumbull qeniesh që nuk jetojnë, por që vetëm gjallojnë.

Duke iu rikthyer thënies së Profetit, ku na tregon se njeriu e shlyen borxhin ndaj nënës, vetëm nëse e gjen të robëruar dhe ndërhyr pér t'i (ri)dhënë lirinë, çështja që qet krye është se sot nuk ka më robëri të asaj forme që kishte kohë më parë, pasi siç dihet, është e ndalur me ligj pothuajse në çdo vend të botës. Pra, nuk ka më robëri si dikur, domethënë, kemi një trajtë tjetër robërie, madje deri në atë shkallë, sa përfshin një popull apo popuj të tërë, siç qe rasti me sistemet totalitare dhe sikundërse është rasti me sistemet e "reja" njëdimensionale, të cilat i kanë vënë poshtë shoqëritë duke i tëhuajësuar në gjendje gjallese, pér t'u bërë fli pa kushte parajsës tokësore, që siç dihet, është një ide me origjinë hebraike.

Kjo do të thotë se njeriu nuk lind, por bëhet; duke e shkëputur kështu njeriun (fëmijën) nga dashuria dhe përkujdesja e pazëvendësueshme e nënës e duke e bëre/formatuar sipas shëmbelltyrës së parëndësisë së "re", e cila ka shumë emra, në përputhje me rrëthanat që përshepjtojnë parajsën tokësore.

A nuk është kjo një robëri, në të cilën ka rënë nëna, duke ia mohuar asaj përherë e më shumë të drejtat mbi fëmijën (njeriun)?!

Megjithatë, një rrugëdalje do të ketë përherë, e cila vjen vetëm duke nisur nga vetja, ku secili nga ne duhet të jetë përgjegjës pér t'i rikthyer nënës së tij lirinë, jo me qëllimin që të shlyejmë borxhin ndaj saj, por që edhe fëmija (njeriu) të jetë i lirë.

8. Joani, 2001.

# Dybazat e identitetit të myslimanit

Prof. dr. Ismail L. Çakan

Nga Malik bin Enesi transmetohet se Profeti, *salallahu alejhi ue selem*, ka thënë: "Ju kam lënë dy gjëra që nuk do t'i humbisni. Ato janë: Libri i Allahut (Kurani) dhe Suneti i të Dërguarit të Tij."

Dy bazat kryesore të islamit janë Libri (*Kurani*) dhe Suneti, që do të thotë: jeta dhe udhëzimi i Profetit, *salallahu alejhi ue selem*. Asnjë mendim dhe praktikë që nuk mbështetet drejtëpërdrejt ose indirekt dhe që nuk buron prej këtyre dy burimeve, nuk mund të fitojë statusin e përfshirjes në fenë islamë.

Hadithi që përmendëm më lart, i cili zë vend në transmetimet që kanë lidhje me Haxhin e Lamtumirës, bën pjesë në fjalitë e fundit këshilluese të Profetit, *salallahu alejhi ue selem*. Siç shihet qartë në transmetimin që është në Muuatta, i cili bazohet në komentimin e Zurkani-ut<sup>2</sup>, këto fjalë i përkasin kohës dyditore "**para vdekjes së Profetit, salallahu alejhi ue selem.**" Prandaj, duhet t'i kushtojmë rëndësi qëndrimit mbi të.

Dy parimet kryesore të islamit, i cili është dërguar si fe e fundit dhe e përsosur, janë Libri (*Kurani*) dhe Suneti, që do të thotë: jeta dhe udhëzimi i Profetit, *salallahu alejhi ue selem*. Asnjë mendim dhe praktikë që nuk mbështetet drejtëpërdrejt ose indirekt dhe që nuk buron prej këtyre dy burimeve, nuk mund të fitojë statusin e përfshirjes në fenë islamë. Për këtë, në të kaluarën dijetarët janë përpjekur të vlerësojnë me të gjitha fuqitë dhe metodat shkencore këto dy burime themelore dhe të përcaktojnë mënyrën më të duhur të ekzekutimit, sipas kushteve të periudhës dhe të vendit në të cilën kanë jetuar. Pikërisht kështu, ata kanë mundur t'u fitojnë një "status islam"

mendimeve dhe zbatimeve të tyre. Përveç kësaj, ata kanë luftuar duke iu përmbajtur kufijve të *Kuranit* dhe *Sunetit*, për të kundërshtuar çdo zhvillim dhe rrymë të huaj për islamin dhe kanë ndihmuar në ruajtjen e vlerave islame të popujve.

Sipas hadithit të mësipërm, *Kurani* dhe *Suneti*, të cilët janë dy parimet kryesore të padiskutueshme të islamit, janë shkaqe për udhëzimin dhe lumturinë e myslimanëve edhe në ditët pas vdekjes së Profetit, *salallahu alejhi ue selem*, me kusht që ata të kafen fort, madje edhe shumë më fort pas tyre. Ky është një sihariq i Profetit, *salallahu alejhi ue selem*. Por fjalë që duhet të trajtojmë këtu është temessuk ose *i'tisam*, që do të thotë "të kapesh shumë fort." Kësaj mund t'i themi, që të kapesh me të dyja duart fort pas *Kuranit* dhe *Sunetit*. Ndërsa frazë "Suneti i të Dërguarit të Allahut" duhet ta kuptojmë si "shpalljet e Profetit, *salallahu alejhi ue selem*, të detyruar nga shpallja e *Revelatës*."<sup>1</sup>

Temat që nxisin për t'u kapur fort pas *Kuranit* dhe *Sunetit* (*el-i'tisam bi'l-kitap ue's-sunne*), të cilat i shohim në librat e haditheve, janë të mbushura me ajete dhe hadithe, që tregojnë për rëndësinë që paraqet *Kurani* dhe *Suneti* nga aspekti i arritjes së identitetit islam, të jetuarit sipas tij dhe mbrojtjes së tij. Hadithi që përmendëm më lart, paraqet haptazi objektivin e këtyre ajeteve dhe haditheve: *të mos devijosh... domethënë, "të mos humbësh identitetin tënd."*

**“...Juve ju erdhi nga Allahu dritë dhe libër i qartë. Allahu e vë me të (me Kuratin) në rrugët e shpëtimit, atë që ndjek kënaqësinë e tij dhe, me ndihmën e Tij,**



**i nxjerr ata prej errësirave nē dritē dhe i udhëzon nē një rrugë që është e drejtë.”** (Maide, 15-16)

**“Dhe kapuni që tē gjithë ju pér litarin (fenë) e Allahut (dhe pasoni Kurann) e mos u pérçani!”** (Ali Imran, 103)

**“Dhe pérmbajuni asaj mē tē mirës që ju është shpallur (Kuranit) nga Zoti juaj!”** (Zumer, 55)

**“Ky Kuran është një kumtesë (e mjaftueshme) pér njerëzit.”** (Ibrahim, 52)

**“Thirrjen e tē Dërguarit, mos e konsideroni si thirrjen tuaj ndaj njëri-tjetrit.** (Duhet t'i përgjigjeni thirrjes së tij.)” (Nur, 63)

Imam Malikut i erdhi një burrë dhe i drejtoi një pyetje. Imami filloi t'i përgjigjej, duke i thënë: “I Dërguari i Allahut ka thënë: ... Njeriu donte tē mësonte mendimin e imamit dhe e pyeti: “Cili është mendimi yt?” Pas kësaj, Imam Maliku lexoi ajetin sipas kuptimit: **“...prandaj, le tē ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e tē Dërguarit tē Allahut, se ata do t'i zërë ndonjë telash ose do t'i godasë dënimini i hidhur!”**<sup>14</sup> Me këtë ai theksoi se vetëm fjala dhe mendimi i Profetit, *salallahu alejhi ue selem*, është fjala që duhet tē dëgjohet dhe mendimi që duhet tē mësohet.

**“Kush i bindet Pejgamberit, ai i është bindur Allahut...”** (Nisa, 80)

**“Kur Allahu dhe i Dërguari i Tij kanë vendosur pér një çështje, nuk i takon (nuk i lejohet) asnjë besimtar i dhe asnjë besimtareje që nē atë çështje tē tyre personale tē bëjnë ndonjë zgjedhje tjetër. E kush e kundërshton Allahun dhe tē Dërguarin e Tij, ai është larguar shumë larg së vërtetës.”** (Ahzab, 36)

**“Ju kishit shembullin mē tē lartë (tē mrekullueshëm) nē tē Dërguarin e Allahut...”** (Ahzab, 21)

Kur vlerësohen këto ajete, bashkë me to edhe hadithet, tē cilat na përcjellin me fjalë rëndësinë dhe funksionin e Kurannit dhe Sunetit, pér nga aspekti i identitetit dhe personalitetit islam, po tē analizohen më hollësisht dhe më nga afër ata që thonë se janë myslimanë, do tē dalë nē pah se nē ç'masë është lindhja dhe pasimi i tyre ndaj

këtyre dy burimeve, domethënë, do tē shfaqet cilësia dhe identiteti i tyre islam. Në këtë aspekt, ky hadith duhet tē vlerësohet patjetër nga tē gjithë: **“Askush nga ju nuk mund tē bëhet besimtar (i përsosur), pérderisa nuk ndjek tē vërtetat që kam kumtuar unë.”**<sup>15</sup>

Institucionet dhe bashkësítë që pretendojnë se edukojnë breza me identitet dhe personalitet islam, duhet tē jenë tē përgjegjshëm pér tē pasur shumë kujdes ndaj parimeve të Kurannit dhe Sunetit. Duhet tē qëndrojnë absolutisht larg sjelljeve dhe fryshtimeve që kushtëzojnë myslimanët ndaj njëri-tjetrit dhe që kufizojnë islamin sipas botëkuptimeve personale.

Në ecurinë e kohës sonë shumë tē ngatërruar dhe dëshpëruese, pasimi i bazave tē islamit që kumtoi Profeti, *salallahu alejhi ue selem*, nga emocionet dhe ambicjet që parapëlqejnë një jetë tē lirë dhe gjithnjë tē shthurur, është një detyrë shumë më e rëndësishme dhe më serioze se sa nē tē kaluarën. Sot, animi i zemrave tē shtresës së rëndësishme të myslimanëve tek një botëkuptim dhe jetë tē shkatërruar nga ndjenjat, propaganda dhe elementë jashtë islamit, është një realitet i hidhur që nuk mund tē mohohet. Të lokalizosh vështrimin te emocionet dhe ambicjet e myslimanëve, tē cilët duhet tē ndjekin nē çdo rast dhe nē çdo konditë Kurannit dhe Sunetit, nga aspekti i identitetit dhe personalitetit islam, tregon se nē shoqërinë njerëzore ekziston një patologji e madhe. Pothuajse tē gjithë përkujdesen tē bëhen myslimanë, sipas emocioneve dhe ambicievet jetake. Individët kanë filluar t'i komentojnë çështjet duke thënë “sipas meje...”, ndërsa grupet e xhemateve “sipas nesh...”, madje nuk janë tē vëmendshëm se po neglizhojnë detyrën “të jesh mysliman, sipas islamit”. Mirëpo, ne nuk jemi urdhëruar tē jemi myslimanë sipas emocioneve dhe ambicieve, por tē jemi myslimanë sipas Kurannit dhe Sunetit.

**“...e kush është më i humbur se ai që ndjek epshin e vet...”** (Kasar, 50)

**“E kush iu frikësua paraqitjes para Zotit tē vet dhe ndaloi veten prej epsheve, xheneti është vendi i tij.”** (Naziat, 40-44)

Pér t'u kapur fort pas Kurannit dhe Sunetit dhe pér tē pasuar me gjithë zemër ato që na solli Profeti, *salallahu*



*alejhi ue selem*, në fillim duhet t'i njohim dhe t'i mësojmë këto parime. Prandaj hadithi që përmendëm më lart, shpreh bindshëm me fjalë nxitjen për të mësuar *Kuranin* dhe *Sunetin*. Mësimi i *Kuranit* dhe i *Sunetit* varet nga shqyrtimi që ata u bëjnë këtyre të dyjave. Ndërsa kjo mund të arrihet duke qëndruar mbi ajitet e hadithet dhe duke përsiatur rreth tyre, si dhe duke mësuar dhe vlerësuar komentimet dhe botëkuptimet e dijetarëve të kaluar. A ka ndonjë sjellje më të mirë dhe më të përshtatshme për myslimanin, se sa të meditojë mbi ajete dhe hadithe për t'i kupuar, për t'i ndarë në kohë dhe për të marrë dije të nevojshme prej tyre?

Iniciativat e "islamizimit të dijes", që vijnë kohët e fundit në rend të ditës, të sjellin ndër mend nevojën për të islamizuar mendjet dhe zemrat e myslimanëve, madje për të islamizuar edhe shkencat islame. Kjo na bën të mendojmë për nevojën e hulumtimit të të argumentuarit sipas *Kuranit* dhe *Sunetit*. Kapja fort pas *Kuranit* dhe *Sunetit* nuk duhet të bëhet me një pretendim të kotë. Ajo kërkon dije, përsiatje dhe një vullnet të fortë. Gjithashtu, kërkon që të dalësh përtej kushteve të rrethit shoqëror. Që të gjitha këto mund të arrihen duke mbështetur personalitetin tonë islam te burimet bazë, në mënyrë të ndërgjegjshme dhe duke u përpjekur gjithnjë për këtë.

Myslimani me cilësinë dhe detyrën kryesore "të qenët rob i Allahut", i cili është në një pozitë të ndryshme dhe dallon (është i privilegjuar) nga njerëzit e tjerë, nuk ka të drejtë të largohet pa asnjë pretekst nga *Libri* (*Kurani*) dhe *Suneti*. Sepse vazhdimësia e tij në rrugë të drejtë dhe lumturia e tij në të dy botët, varet nga të kapurit e tij fort pas këtyre dy parimeve dhe trashëgimeve të Profetit, *salallahu alejhi ue selem*. Ky realitet mbështetet në deklarimin e sipërpërmendor të Profetit të fundit Muhammed Mustafa, *salallahu alejhi ue selem*.

Përveç kësaj, duhet të theksojmë se individët dhe grupet shoqërore, të cilët kanë rënë në një agitacion (*trazirë*) identiteti e personaliteti dhe duket se janë larguar nga epiteti i tyre islam, rezultojnë se nuk janë



kapur siç duhet pas *Kuranit* dhe *Sunetit*.

Nuk duhet të harrojmë se feja mund të mbrohet duke e jetuar atë vetë, duke ndërtuar dhe mbajtur gjallë institucionet e saj, duke studiuar e duke u arsimuar në të. Nëse këto tri obligime realizohen në kuadër të *Kuranit* dhe *Sunetit*, atëherë do të ruhej identiteti dhe personaliteti islam dhe do të ishte shembull edhe për brezat e ardhshëm. Përndryshe, sido që të jetë pretendimi, natyrisht që përbalja me pasoja negative do të jetë e paevitueshme, për shkak të mosmarrjes për bazë të *Kuranit* dhe *Sunetit* dhe të mos të jetuarit në përputhje me to.

Institucionet dhe bashkësitë që pretendojnë se edukojnë breza me identitetin dhe personalitetin islam, duhet të jenë të përgjegjshëm për të pasur shumë kujdes ndaj parimeve të *Kuranit* dhe *Sunetit*. Absolutisht duhet të qëndrojnë larg sjelljeve dhe fryshtimeve (*sugjerimeve* dhe *indoktrinimeve*) që kushtëzojnë myslimanët ndaj njëri-tjetrit dhe që kufizojnë islamin sipas botëlkuptimeve personale. Ne jemi të urdhëruar të ndjekim rrugën e drejtë që na orienton *Kurani* dhe *Suneti*, jo duke përshtatur islamin sipas vetes sonë, por duke iu përshtatur atij.

Asnjë ide (*mendim*) dhe doktrinë që parashtronet dhe që do të parashtronet si alternativë ndaj islamit ose ndaj *Kuranit* dhe *Sunetit*, nuk mund të mendohet si element përbërës i identitetit të myslimanëve, të cilët janë të obliguar të kapen fort pas këtyre dy parimeve. Në rast të kundërt, është i pashmangshëm erozioni dhe humbja e identitetit dhe e personalitetit.<sup>6</sup>

#### Referencat:

- 1. Muvatta, Kader 3; Hakim, *el-Mustedrek*, I, 93; Ibn Abdilberr, *el-Xhami*, II, 134, 221; përvëç kësaj shiko: Ebu Davud, Menasik 56; Ibn Ma-xhe, Menasik 84; Ahmet b. Hanbel, *Musned*, III, 26. - 2. Shiko: *Sherhu'l-Muvatta*, V, 236. - 3. Aliju'l-Kari, *Mirkatu'l-mefatih*, I, 210; el-Baxhi, *el-Munteka*, VII, 203. - 4. Për ngjarjen që përmendet në suretu en-Nur: 24/63 shiko: el-Begavi, *Sherhu's-sunne*, I, 191. - 5. Shiko: et-Tebrizi, *Mishkatu'l-Mesabih*, I, 66. - 6. Për të shqyrtuar më hollësisht çështjen e identitetit, shiko Çakan, *Identiteti i Myslimanit*, Stamboll, 2002.

Nuredin Nazarko

# Paracaktimi dhe liria

Qenia njerëzore vjen në ekzistencë nga mosekzistenca, natyrisht pa dëshirën dhe vendimin e saj për të ardhur në ekzistencë, si qenie në botë. Qenia njerëzore, e zbritur përmbi dhe në këtë botë, jeton me jetën dhe vdekjen, e rrethuar nga një botë e parapërgatitur për të, në mënyrë që të disponojë të gjitha kushtet bazë dhe të pandryshueshme për të jetuar deri në një afat të paracaktuar. I gjendur mes një bote dhe universi, me pafuqinë e influencës, për ndryshimin e ligjeve, mbi bazën e të cilëve funksionojnë, njeriu rreh të zbulojë në-përmjet hulumtimit përsenë e ekzistencës së tij dhe të qenët e botës e të universit, ashtu sikundërse i gjen me ardhjen në ekzistencë dhe jo ndryshe. Duke ndjekur nga pas përsenë e të qenit të botës dhe universit dhe gjithçkaje që është midis tyre, përsenë e ekzistencës së tij, kështu siç manifestohen, kërkon të arrijë të kuptojë qëllimin që fshihet pas përsesë. Duke studiuar universin, ngjarjet që ndodhin në të, botën me kushtet e saj, krijesat me jetën e tyre, bimësinë me natyrën e saj, anatominë fizike të vvetvates, nuk shpik ligjet e funksionimit të tyre, por zbulon se gjithçka funksionon sipas ligjeve të një rendi gjëresh, tërësisht të paracaktuara të funksionojnë kështu dhe jo ndryshe. Gjendja mes një bote dhe ekzistence të paracaktuar në kushte të caktuara, e vendos njeriu në pozitën e parashtruesit të pyetjes, nëse gjendem për të jetuar mes një paracaktimi, apo jam unë i paracaktuar në ngjarjet e jetës sime këtu dhe atje? A jam unë i lirë për të vendosur, për të zgjedhur mënyrën time të të jetuarit dhe a është kjo zgjedhje, ky vendim i paracaktuar të ndodhë kështu dhe jo ndryshe?

Qeniet njerëzore nuk ndajnë të njëtin qëndrim përkundrejt kësaj çështjeje. Disa besojnë se, meqenëse rendi i gjérave është i paracaktuar të ndodhë kështu dhe jo ndryshe, nga Qenia Absolute Hyjnore, atëherë do të ishte një vetëmashtrim të besonim që jemi të lirë të vendosim dhe zgjedhim mënyrën tonë të të jetuarit, pasi ajo është e paracaktuar para se të ndodhë. Kësosoj, njeriu është i detyruar në mënyrën e tij të të jetuarit, për shkak të domosdoshmërisë se realizimit të asaj që është paracaktuar të ndodhë dhe aspak i lirë në zgjedhjet që bën përgjatë jetës së tij. Përfundimisht, i nënshtuar ndaj rendit të paracaktuar të gjérave, pret vetëm realizimin e paracaktimit, duke justifikuar mënyrën e tij të të jetuarit me paracaktimin.

Disa besojnë se pas një universi dhe bote tërësisht të paracaktuar, nuk qëndron aspak një paracaktim për mënyrën e të jetuarit të njeriut, madje është ky i fundit, që me vullnet dhe ndërgjegje të lirë vendos se çfarë do të bëjë ose jo me jetën e tij, edhe pse ajo është e paracaktuar. Kësosoj, njeriu nuk është i detyruar në mënyrën e tij të të jetuarit, nga domosdoshmëria e realizimit të paracaktimit dhe janë përpjekjet e tij individuale dhe të padiktuara nga ndonjë vullnet i jashtëm, që mbushin afatin e të qëndruarit në këtë botë. Pra, njeriu ndihet tërësisht i lirë dhe vepron sipas devizës, njeriu bëhet dhe nuk lind, edhe pse vepron në një mjeshtësi të paracaktuar për të qenë i tillë.

Disa besojnë se rendi i gjérave është tërësisht i paracaktuar para se ato të ndodhin, por kjo paracaktueshmëri nuk është detyruese për njeriun në zgjedhjen që bën për mënyrën e të jetuarit, edhe pse zgjedhjet dhe rrjedha e ngjarjeve ndalen tek

kufijtë e caktuar nga paracaktimi. Pyetja që shtrojmë është: Pse paracaktimi nuk e detyron njeriun në zgjedhjen e tij të mënyrës së të jetuarit, si shkak i realizimit të domosdoshmërisë së tij? Edhe pse rrjedha e jetës së njeriut është tërësisht e paracaktuar, ka një element që nuk e çorenton njeriun në lirshmërinë e zgjedhjes së mënyrës së të jetuarit. Ky element është pamundësia dhe kufizueshmëria për të zbuluar atë çfarë do të ndodhë, para se ajo të ndodhë. Njeriu është kureshtar të mësojë mbi të ardhmen e tij dhe jo rrallëherë drejtohet tek individë të caktuar që pretendojnë se mund të lexojnë të ardhmen, për të mësuar mbi të ardhmen e tij. Ajo çfarë do të ndodhë është e fshehtë, e pazbulueshme për njeriun dhe vetëm në dijeninë absolute të Atij që e ka paracaktuar. Pazbulueshmëria dhe fshehtësia e paracaktimit nuk e zhbën domosdoshmërinë e realizimit të tij, por i jep njeriut të drejtën për të zgjedhur dhe vendosur mbi mënyrën e të jetuarit, përderia nuk mund të njohë atë çfarë Qenia Hyjnore ka paracaktuar për të. Meqenëse njeriu, as nuk e njeh dhe as nuk mund ta zbulojë të paracaktuarën, atëherë i duhet të zgjedhë brenda kufizueshmërisë së natyrës së tij se në cilin drejtim do të orientohet, mbi cilin botëkuptim do ta ndërtojë mënyrën e të jetuarit. Në qoftë se njeriu do të ishte i detyruar nga paracaktimi apo paracaktimi nuk ndërhyr në zgjedhjen e njeriut, përsë do të duhej që Qenia Hyjnore të urdhëronte për kryerje të punëve të mira dhe heqje dorë nga kryerja e të këqiaje, si përbushje të imperativit hyjnor, pra si përbushje të lirisë për të zgjedhur rrugën drejt së cilës njeriu orientohet në jetën e tij? Ngjarjet jetësore ndodhin ashtu siç ndodhin. Përiqemi të shhangim të këqijat, të kryejmë të mirat, të realizojmë vlerat, të mos molepsemi nga antivlerat. Herë triumfojmë e herë thyhem. Të tjerë kryejnë të kundërtën. Në qoftë se njeriu nuk do ishte i lirë për të zgjedhur mënyrën e të jetuarit, atëherë nuk do të kishim ekzistencë të njeriut në përkthimin haidegerian të ekzistencës si përgjegjësi. E në qoftë se nuk do të kishim përgjegjësi për mënyrën e të jetuarit, atëherë çfarë vlore do të kishte besimi se një ditë duhet të japid llogari para Qenies Hyjnore? Fakti që paracaktimi është, buron nga dija, fuqia absolute e Qenies Hyjnore që di atë që ka qenë, atë që është, atë që do të jetë, atë që nuk është, po të ishte, si do të ishte dhe nga kjo dije absolute njeriu di në kufizueshmërinë e tij, aq sa Qenia Hyjnore ka dashur që njeriu të dijë dhe padysnim, kjo është më e mira për njeriun, pasi me kufizueshmërinë e tij si krijesë, nuk mund të arrijë të ngërthejë pakufizueshmërinë e urtësisë hyjnore. Njeriut i është dhënë gjithçka që ai të mund të ekzistojë si njeri dhe jo si gur, shkëmb, kafshë, engjell. Atij i duhet që ta realizojë larine, për të zgjedhur nëse do të jetë prej më vepërmirëve apo jo, duke mos u implikuar në shqetësimë të panevojshme për të njohur atë që Qenia Hyjnore si mësirë ndaj tij, ka dashur ta lërë të panjohshme në këtë botë. Po edhe sikur të vepron të kundërtën, a do të mund ta njihet atë që është paracaktuar të mos e njohë apo do të dilte nga paracaktimi? Sido që të veprojë, vepron sipas paracaktimit, jo i detyruar nga paracaktimi, përderisa ekziston si njeri dhe mban përgjegjësi për çfarë flet dhe vepron.

# Borxhi i besnikörisé

Ali Riza Temel



Besnikëri do tē thotë tē kryesh diçka, tē mbash fjalën, tē mos harrosh mirësitë që tē janë bërë dhe, atyre që tē kanë bërë mirësi, t'ua kthesh me tē njëjtën apo me më shumë. Atyre që punojnë me besnikëri, u thonë besnikë, ndërsa atyre që punojnë pa besnikëri, u thonë jobesnikë ose tradhëtarë. Njeriut dhe, veçanërisht myslimanit, i ka hije besnikëria.

Besnikëria më e madhe është njohja e Krijuesit të Madhëruar, vlerësimi i mirësive që ka dhënë, përdorimi i tyre në mënyrë tē dobishme dhe falënderimi ndaj Tij. Të adhurosh Zotin, ashtu siç e meriton Ai, është mbajtje e premtimit që ia kemi dhënë në "Elestu bi rabbikum?".

Ndërsa borxhin e besnikërisë, që e kemi ndaj Hazretit Pejgamber (s.a.s.), i cili na ka treguar Zotin e Madhërishëm, mund ta paguajmë duke u përpjekur që tē jemi një umet i përshtatshëm ndaj tij.

Pas Allahut dhe tē Dërguarit tē tij, janë prindërit ata tē cilët meritojnë tē sillemi me më shumë besnikëri ndaj tyre, sepse ata janë bërë shkak që ne tē vijmë në këtë botë dhe kanë shfaqur sakrificat më tē mëdha për tē na rritur. Allahu i Madhëruar, pas adhurimit ndaj Tij, urdhëron mirësinë ndaj prindërve. Në ajetin fisnik thuhet:

**"Zoti yt ka urdhëruar që tē mos adhuron i askënd tjetër përvëç Atij dhe, tē silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose tē dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as "of!", mos i kundërshto, por drejtoju atyre me fjalë tē mira. Lësho para tyre krahët e përuljes prej mëshirës dhe thuaj: "O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogëll!"** (el-Isra, 23-24.)

Nuk ka asnjë shprehje tjetër që ta japë më bukur vlerën e prindërve.

Njëri prej sahabëve shkoi te Hazreti Pejgamber, sallallahu alejhi ve sellem, dhe i tha: "Unë kam ardhur për tē tē dhënë besën për hixhret. Nënën dhe babain i kam lënë duke qarë." I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i tha: "Kthehu te prindërit. Gëzoji ata ashtu siç i ke bërë për tē qarë!" (Buhari, Edebu'l-Mufred. Hadith nr: 19.)

Lumturia e kësaj bote dhe e botës tjetër është e lidhur me kënaqësinë dhe lutjen e prindërve. Lutja e prindërve është në krye tē lutjeve që pranohen më shpejt. Kënaqësia dhe lutja e tyre e begatojnë jetën, ndërsa trishtimi dhe mallkimi i tyre tē shkatërrojnë, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër.

Hazreti Pejgamber, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

"U Shkatérroftë, u shkatérroftë, u shkatérroftë!" I thanë: "O i Dërguari i Allahut! Kush u shkatérroftë?" I Nderuari ynë (s.a.s.), tha: "U shkatérroftë ai, i cili nuk mund të hyjë në xhenet, për shkak se nuk u shërben prindërve apo njërit prej tyre, kur pleqëria i arrin pranë." (Buhari, Edebu'l-Mufred, Hadith nr: 10.)

Respekti dhe shërbimi ndaj prindërve nuk bëhen vetëm kur janë gjallë, por vazhdojnë edhe pasi ata të ndërrojnë jetë. Ndërmjet detyrave që u takojnë fëmijëve për të bërë pas vdekjes së prindërve, mund të përmendim këto:

"Përkujtimi i tyre me mirësi, lutja për ta, kryerja e porosive që mund të kenë lënë, respektimi i miqve të tyre dhe bërrja e mirësive për ta.

Pejgamber (a.s.), është shembulli më i bukur për ne në çështjen e besnikërisë, ashtu siç është edhe në çdo çështje tjeter. Mirënjohja që shfaqte ndaj zonjës Fatime, e cila ishte bashkëshortja e xhaxhait të tij, Ebu Talibit, shpreh një ndjesi, e cila t'i mbush sytë me lot, kur e kujton.

Kjo zonjë e nderuar u shpërndul nga Meka në Medine si myslimanë. Pastaj, kur ndërroi jetë, i Nderuari ynë tha: "Ndërroi jetë nëna ime". Këmishën e tij e bëri qefin për të dhe me duart e tij e vendosi në varr. Ndërsa atyre që e pyetën për shkakun e këtij interesimi, iu përgjigj:

"Asnjë njeri nuk më ka bërë më shumë mirësi, sa më ka bërë kjo grua, përveç Ebu Talibit. Këmishën time ia dhashë për qefin, që të veshë prej rrobave të xhenetit në ahiret. U shtriva bashkë me të në varr, që të jetë ngrrojtë në të. Ajo ishte nëna ime. Ndërkohë që fëmijët e saj ishin të uritur dhe rrudhnin fytyrën, ajo së pari më ushqente mua dhe më krihte flokët."

I Nderuari ynë nuk e ka nënvlerësuar vizitën e varrit të nënës së tij. Gjithmonë dhe në çdo lloj mënyre i ka respektuar nënët e tij të qumështit, hallat e qumështit, tezet e qumështit, motrën e qumështit, Shejmën dhe ka ndihmuar të tjerët për hir të tyre. Edhe nënën tonë Hatixhen, e cila i dha mbështetjen më të madhe në çastet më të vështira, e ka përkujtuar gjithmonë me mëshirë dhe i ka respektuar shumë të afërmit e saj.

Besnikëria e Hazretit Pejgamber, sallallahu alejhi ve sellem, nuk ka përfshirë vetëm miqtë dhe myslimanët,

por të gjithë njerëzit. Kur të Nderuarit tonë i erdhën të dërguarit e prijësit të Habeshit, u interesua për ta dhe i respektoi shumë. Ndërsa atyre që e pyetën për shkakun e kësaj, iu përgjigj kështu:

"Këta u kanë dhënë vend dhe i kanë respektuar shokët e mi që shkuan në Habeshistan. Tani edhe unë dua t'u shërbuje atyre." Kur i Dërguari i Allahut përkufizoi besimtarin e vërtetë, tha: "Atij që nuk i zihet besë, nuk ka iman dhe ai që nuk ka besnikëri, nuk ka fe." (Bejhaki, 9/231.)

Sjellja me besnikëri ndaj të gjithëve në çdo kohë, është një çështje bazë në Islam, por nuk duhet të harrojmë se besnikëria më e madhe duhet të shfaqet ndaj të moshuarë dhe të paaftëve, sepse ata kanë më shumë nevojë për ndihmë dhe shërbim. Një herë, erdhi një i moshuar që dëshironte të takohej me Hz. Pejgamber. Xhemati nuk shfaqi shumë interes për t'i hapur vend atij. I Dërguari i Allahut reagoi menjëherë dhe tha: "Ai që nuk mëshiron të vegjëlit dhe nuk respekton të mëdhenjtë nuk është prej nesh." (Taxh, 5/17.)

I Nderuari ynë, sallallahu alejhi ve sellem, tha për babain e Hz. Ebu Bekr, Ebu Kuhafen, të cilin e sollën pranë Hz. Pejgamber (a.s.), për t'i dhënë besën: "Përsë e keni lodhur këtë të moshuar? Unë mund të shkoja te ai."

Hazreti Abdullah b. Umer e hipi në devenë e tij një të moshuar që e takoi jashtë Medines. Çallmën ia vendosi atij dhe vetë eci në këmbë. Atyre që e pyetën për këtë, iu përgjigj: "Ky burrë është miku i babait tim, është i moshuar, kështu që duhet respektuar."

Të moshuarit janë begatia e shoqërisë. Ata që kanë jetë të gjatë dhe vepra të mira, janë njerëzit më të mirë. Sa e bukur është ajo jetë që kalon me adhurim ndaj Allahut dhe shërbim ndaj të gjitha kriesave. Ata që japid në rini, janë ata që meritojnë të marrin më shumë në pleqëri. Ata kanë mbjellë gjëra të bukura. Kështu që kanë të drejtë të korrin gjëra të bukura.

Fëmijët dhe të rinjtë duhet të marrin parasysh se çfarë sakrificash të mëdha kanë bërë prindërit për ta, që nga periudhat e para e deri në ditët e sotme. Ashtu siç janë marrë nën mbrojtje ata vetë, kur ishin të paaftë dhe të dobët, po ashtu duhet të shfaqin butësi e modesti kundrejt prindërve dhe të moshuarve, të cilët jetojnë në dobësi dhe paaftësi për shkak të pleqërisë.



Rinia dhe pleqëria nuk janë me para, por me radhë. Çdo njeri që është i gjallë, do t'i ngjisë një nga një shkallët e jetës dhe do ta plotësojë atë. Në pleqëri lindin ndryshime fizike dhe shpirtërore. Rudhje në lëkurë, njolla në trup, zbardhje e flokëve, shtohet dobësia e dëgjimit dhe shikimit. Shpejtësia, me të cilën trupi riparons vetveten, bie ndjeshëm dhe muskujt i lë fuqia.

Rritja ndalon në moshën njëzet e pesë vjeç. Pas moshës tridhjetëvjeçare, funksionet e trupit dalëngadalë fillojnë të pakësohen. Në moshën dyzetyeçare fillon rënia. Në moshën pesëdhjetëvjeçare lëkura fillon të rrudhet dhe shikimi fillon të pakësohet. Në moshën gjashtëdhjetë-shtatëdhjetëvjeçare, fuqia e muskujve është sa gjysma e fuqisë së tyre në rini.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit, mosha 45-60 pranohet si plakje mesatare, 60-75 si plakje, 75-90 si plakje e përparuar dhe 90 e sipër, si plakje shumë e madhe. Përafërsisht, pesëmbëdhjetë përqind e njerëzve janë mbi moshën gjashtëdhjetë e pesë vjeç.

Shfaqja e interesimit të veçantë, duke filluar nga prindërit, pastaj ndaj të moshuarve të afërm apo jo të afërm, është shfaqje e besnikërisë së shoqërisë. Nëse i respektojmë të gjithë të afërmit, atëherë duhet t'u shërbejmë edhe të moshuarve në qendra zyrtare apo publike, në mënyrë që edhe ata të bëjnë një jetë si njerëz dhe t'i ndihmojmë që të shpërngulen nga kjo botë me qetësi shpirtërore.

Për shkak se lidhjet familjare në popujt perëndimorë janë të dobëta, të moshuarit në përgjithësi jetojnë të ndarë nga fëmijët e tyre. Sipas disa statistikave në Perëndim, një e treta e të moshuarve jetojnë vetëm, pesëdhjetë përqind e tyre me bashkëshorten dhe vetëm dhjetë përqind me fëmijët e tyre.

Ndërsa te ne, tetë për qind jetojnë vetëm, njëzet e dy përqind jetojnë vetëm me bashkëshorten dhe gjastëdhjetë e gjashtë përqind jetojnë bashkë me bashkëshorten dhe fëmijët. Përsëri sipas disa statistikave, përqindja e depresionit te ata që qëndrojnë në azile dhe kanë fëmijë, është njëzet përqind. Kjo përqindje tregon se ndjenja e braktisjes nga fëmijët shkakton depresion te njerëzit.

Siq na kanë rritur prindërit në krahët e tyre, kur ishim të vegjël edhe ne, kur t'u arrijë pleqëria, duhet të kujdesemi për ta sa të jetë e mundur dhe të marrim lutjet e tyre. Shërbimi ndaj tyre në pleqëri, është shansi më i madh për të hyrë në xhenet.

Sikundër kësaj edhe prindërit nuk duhet t'i lënë fëmijët e tyre në kopsht, me arsyetimin se po punojnë, ndërkohë që ata janë në moshë shumë të vogël dhe kanë më shumë nevojë për dashurinë e nënës e butësinë e babait. Lënia e të moshuarve në azile, nga një aspekt është bërë hakmarrje e lënies së fëmijëve në kopsht.

Siq nuk janë fëmijët zogj që dalin nga inkubatori edhe të moshuarit nuk janë krijesa që duhen lënë në mjedise të ftohta, larg dashurisë së fëmijëve dhe të afërmve.

Siq do ta shohin të gjithë shpërbllimin e punëve të tyre në ahiret edhe në këtë botë, pak ose shumë, mirë apo keq, do të shikohet shpërblli mi i atyre gjérave që janë bërë. Hazreti Pejamber i ka përgëzuar kështu të rintjtë, që u shërbijnë të moshuarve: "Nëse një i ri e nderon një të moshuar, për shkak se është i moshuar, edhe Allahu e bën një njeri që ta nderojë atë kur të plaket." (Tirmidhi, Hadith nr: 2022.)

Të moshuarit dhe të pafuqishmit janë amanet ndaj shoqërisë. Përdorimi i njerëzve në kohën e rinisë dhe lënia e tyre në pleqëri, është tradhëtia më e madhe. Hz. Umer, i cili ishte shembull i drejtësisë, e pyeti një çifut të moshuar e të verbër që po lypte, se përsë po lypte.

Kur i moshuri i tha se po lypte për shkak të pleqërisë, nevojës dhe taksës, Hz. Umer i dha këtë urdhër nëpunësit të thesarit: "Ki kujdes ata që janë në këtë gjendje! Të përfitosh prej njerëzve në rini dhe t'i lësh ata në pleqëri, është mizori."

Këtij të moshuari çifut i lidhën një rrogë dhe ia hognë detyrimin e taksës. Ky duhet të jetë konceptimi i besnikërisë që duhet të kenë të gjithë, por në veçanti myslimanët. Borxhi i parë që duhet të paguhet, është borxhi i besnikërisë. Siq mund të paguhet me para, ai mund të paguhet edhe me një buzëqeshje, me interesim ndaj gjendjes së të tjerëve, me vizita me këshilla etj., sepse qëllimi është të fitojmë zemrat e njerëzve, të marrim lutje dhe hallallëk, të mos harrojmë dhe të mos harrohem.





# Besimi në Zot çelësi i kurimit të sëmundjeve

Anderson Marku

Gjëja më e bukur që krijoi Zoti është toka, gjëja më e bukur që gjendet në tokë është njeriu, gjëja më e mirë që gjendet tek njeriu është zemra e gjëja më e bukur që gjendet tek zemra është besimi. Besimi i ngjan fanarit ndriçues që shndrit në mes të territ të idhujtarisë dhe mohimit. Besimi është forca e moralit dhe morali i forcës, shpirti i jetës dhe jeta e shpirtit, sekreti i botës dhe bota e sekreteve, bukuria e ekzistencës dhe ekzistencia e bukurisë, drita e rruqës dhe rruga e dritës.<sup>1</sup>

Njeriu, si një kriesë sociale, përpipet të angazhohet në shoqëri. Pjesëmarrja e tij në mënyrë aktive apo qoftë dhe pasive, e bën atë të mbingarkohet nga ana emocionale dhe mendore. Shpeshherë, bombardimet me informacione krijojnë tek ai mjaft probleme, madje arrijnë deri në atë pikë, sa këto probleme të kthehen në sëmundje serioze mendore.

Teksa shqyrtojmë gjendjen e këtyre personave, vihet re një dukuri e cila shfaqet në shumicën e këtyre rasteve e ajo quhet: "Mungesë besimi". Dr. Ass. Paul Ernest Adolf, pedagog në universitetin e St. Jones dhe anëtar i shoqatës së kirurgëve amerikanë, tregon shkaqet përsë ndodhin këto probleme mendore: "Ndër shkaqet më kryesore të këtyre sëmundjeve janë ndjesia e mëkatit, e frikës, e urrejtjes dhe e pasigurisë. Është për të ardhur keq se shumë nga mjekët arrijnë të përcaktojnë shkaqet e sëmundjes, por nuk arrijnë dot ta trajtojnë atë. Kjo, pasi ata nuk i referohen besimit te Zoti në trajtimin e sëmundjeve".<sup>2</sup> Dr. Henri Link, një mjek i shquar amerikan, pas shumë eksperimenteve dhe studimeve, arriti në një përfundim të artë: "Kushdo që beson dhe frekuenton vendet e adhurimit, gjëzon një personalitet më të fortë e më të mirë se ata që nuk besojnë dhe nuk shkojnë në këto vende!"<sup>3</sup> Ndërsa shkrimitari dhe sociologu amerikan, Dale Carnegie, në librin e tij "Lëre shqetësimin dhe fillo jetën", tregon disa dobi që sjell feja dhe besimi në jetë: "Feja ushqen besimin, shpresën dhe guximin, ndërsa largon frikën, pasigurinë dhe shqetësimin. Ajo më mëson qëllimet dhe rezultatet e jetës dhe hap para meje horizontet e lumburisë, si dhe më bën të jetoj në oazin e besimit, mu në mes të shkretëtirës së jetës sonë".

1. Dr. Jusuf Kardawi, "Besimi dhe jetë".

2. Nga libri "Zoti shfaqet në epokën e shkencës".

3. Nga libri "Kthimi në besim", fq. 25-26

Të shumtë kanë qenë ata mjekë psikiatër, të cilët kanë provuar në mënyrë të vazhdueshme se besimi te Zoti dhe tejeta tjetër, ka qenë një nga mënyrat më efikase për të shëruar sëmundjet mendore. Ata kanë kuptuar se besimi i fortë, kapja pas fesë dhe praktikimi i lutjeve, janë të mjaftueshme për njeriun, që ai të vëré poshtë problemet dhe shqetësimet nervore dhe mendore. "Një njeri që beson, nuk vuan kurrë nga sëmundjet mendore", shprehet Dr. Alexis Perel, ndërsa një ndër mjekët më të shquar në SH.B.A, i njohur në mbarë botën, Dr. Karl Jang, shprehet kështu: "Gjatë 30 viteve të shkuara, më kanë kërkuar konsulta, njerëz nga vende të ndryshme të botës. Kam kuruar qindra të sëmurë dhe kam konstatuar se problemet e atyre që kishin arritur gjysmën e moshës (35 vjeç), vinin nga mungesa e besimit dhe mosfrequentimi i mësimeve fetare. Nuk gaboj, nëse them se secili nga këta të sëmurë, kishte rënë pre, ngaqë ia kishte mohuar vetes qetësinë shpirtërore që të dhuron besimi. Dhe asnjëri prej tyre nuk u shërua, pa iu kthyer më parë besimit dhe mësimeve të fesë".

Po pse vallë, besimi te Zoti dhe mbështetja tek Ai sjellin paqe, siguri dhe prehje tek njeriu?

Përgjigjen e kësaj pyetjeje, po ia lëmë filozofit të njohur të shkollës filozofike pragmatiste, William James, i cili thotë: "Dallgët e oqeanit, nuk e trazojnë aspak thellësinë e tij të sigurt dhe nuk ia prishin qetësinë që e karakterizon. Po kështu edhe njeriu, që beson fort tek Zoti, nuk mashtrohet me prehje sipërfaqësore dhe nuk trazohet aspak nga problemet dhe shqetësimet, por e ruan ekuilibrin e tij dhe është vazhdimit përgatitur për të nesërmën". Besimi në Zot është dritë që nuk shuhet kurrë, pasuri që nuk shteron...

Thënë me një fjalë të vetme, besimi është domosdoshmëria e jetës së njeriut; domosdoshmëri për personin të gjejë prehjen, lumburinë dhe përparimin, domosdoshmëri për shoqerinë që të gjejë qëndrueshmërinë, unitetin dhe vazhdimësinë. Mjekët nuk zotërojnë ndonjë gjë më të vyer dhe efikase se arma e besimit dhe e fesë, kthimi drejt mëshirës Hyjnore, drejt përkujdesjes së Zotit, drejt fuqisë dhe madhështisë së Tij!



# Ekuilibri ndërmjet fesë dhe botës

Doç. dr. Sulejman Derin

Parimet kryesore të besimeve dhe ideologjive përcaktohen nga këndvështrimet e tyre ndaj kësaj bote dhe besimit në ahiret. E rëndësishme për mendimet filozofike si komunizmi, është bota në të cilën jetojmë dhe ndarja e saj me të tjerët. Sipas kësaj filozofie, bota është e vërteta e vetme, kështu që besimi në ahiret nuk ka kuptim.

Ndërsa kapitalizmi, megjithëse i bën idhuj pasionet e njerëzve, nuk e refuzon tërësisht besimin në ahiret. Madje, kur i leverdis, e përdor lehtë edhe fenë për interes. Në të njëjtën mënyrë edhe ithtarët e feve hyjnore kanë nxjerrë teza të ndryshme me njëra-tjetrën, në lidhje me këtë botë dhe botën tjetër.

Sipas ithtarëve të feve të tjera, çifutët e kanë tepruar në përfitimin nga mirësitë e kësaj bote. Kur po përparonin në rrugën e shpëtimit hyjnor që ua tregoi Musai, alejhisselam, ata nuk mundën të sakrifikonin qoftë edhe kënaqësitë shumë të vogla të kësaj bote, si qepët dhe hudhrat.

Nga ana tjetër, kristianët shpikën murgërinë, hoqën dorë totalisht nga kjo botë dhe e konsideruan mëkat nevojnë njerëzore më themelore.

Islami, që është shpallja e fundit që i ka ardhur njerëzisë, qëndron larg këtyre dy ekstremeve. Islami ka vendosur ekuilibrin ndërmjet fesë dhe botës. Këtë botë e pranon si arë të ahiretit dhe sugjeron që të përdoret në rrugë të Allahut (xh.xh.). Sipas Islamit, fusha më e rëndësishme në të cilën sprovohet mysliman, është lidhja e tij me këtë botë. Kur bota të përdoret për fenë dhe të jetë një mjet për ahiretin, atëherë është arritur qëllimi.

Por për fat të keq, mashtrimi dhe joshja e kësaj bote i ka deviuar shpeshherë njerëzit nga rruga e drejtë. Për këtë arsy, të mëdhenjtë e misticizmit i kanë paralajmëruar një-

rëzit e thjeshtë dhe ata të elitës në lidhje me çështjen e mashtrimit të kësaj bote.

Në këtë material do të ndajmë me lexuesit tanë këshillat e Imam Rabbanit, të cilat na ndihmojnë që të vendosim ekuilibrin ndërmjet fesë dhe kësaj bote. Sipas Imam Rabbanit, realiteti i kësaj bote është ky:

*"O bir! Kjo botë është një vend sprovimi dhe vështirësie. Aparenca e saj është e stolisur dhe e zbuluar me çdo lloj stolie. Fytyra e kësaj bote, me makiazhin me pikëla dhe vija ngjyrangjyra që ka bërë, me gërshtet dhe me faqet fallso që mezi i kazbuluar, i ngjan një gruaje të shëmtuar. Me shikim të parë duket joshëse, e bukur, e freskët, e re dhe vezulluese. Ndërsa në të vërtetë, i ngjan një kërme mbi të cilën është hedhur erë e mirë dhe një vendi plehrash, drejt të cilit vrapojnë qentë dhe mizat. Ajo është një helm, e shfaqur si vegim në shkretëtirë dhe si diçka e ëmbël, të cilën njeriu i etur e pandeh se është ujë."* (Letra e 73.)

Me të vërtetë edhe sot, shumë njerëz mashtrohen ndaj kënaqësive të përkohshme të kësaj bote dhe punojnë për dynjanë, sikur nuk do të vdesin asnjëherë. Ata jetojnë dhe brengosen vetëm për këtë botë, duke e harruar ahiretin. Të shpëtosh nga këto lloj brengosjesh si një njeri me vlerë, është shumë e vështirë. Në këtë situatë, Imam Rabbani na këshillon që ta lëmë këtë botë, të paktën ligjërisht:

*"Atij njeriu që dëshiron të fitojë ahiretin, i takon që ta lërë këtë botë. Për shkak se sot është e vështirë që ta lësh këtë botë në kuptim të plotë, atëherë është obligim që të lihet ligjërisht. Lënia e botës ligjërisht do të thotë:*

*"Të lidhesh ashtu siç duhet pas ligjeve të sheriatit të lartë në çështjet fetare, të respektosh kufijtë ligjorë në çështjet e ngrënies, pirjes dhe banimit. Të mos e teprosh në këto çështje, të japësh zekatin e pasurisë dhe të kafshëve, i cili është obligim. Nëse është e mundur që të stolisemi me ligjet e sheriatit, është e mundur që të shpëtojmë edhe nga dëmet e kësaj bote. Ja, pikërisht atëherë është arritur ekuilibri ndërmjet botës dhe fesë."* (Letra e 72.)

Sipas Imam Rabbanit, myslimanët që janë mashtruar pas jetës së kësaj bote, janë ata që nuk kanë zbatuar urdhrat e fesë në lidhje me çështjen e pasurisë që kanë fituar. Këtë klasë njerëzish, Imam Rabbani e përkufizon kështu:

*"Nëse një njeri nuk mund ta lërë këtë botë, qoftë edhe ligjërisht, ky lloj njeriu është jashë temë sonë. Besimi i tij në këtë formë, nuk do t'i bëjë dobi në ahiret."* (Letra e 72.)

Imam Rabbani tregon se është shumë e vështirë për të ikur nga kjo botë dhe se janë shumë të paktë ata myslimanë që mund të shpëtojnë nga sherri i saj. Ai thotë:

*"Sa fatmirë është ai njeri që e dëgjon këtë fjalë të drejtë, edhe pse në këtë botë ka shumë shërbëtorë që shtiren, ushqime të shijshme dhe rroba të bukura që e ndihmojnë.*

*Ai që e ka mbyllur veshin ndaj thirrjes sime, nuk dëgjon! la shpjegoj, qaj, por ai nuk pranon!"* (Letra e 72.)

Hazreti Imam Rabbani e përkufizon kështu këtë botë, e cila nënçmohet në Kur'an dhe në hadithe:

*"O bir! A e di çfarë është kjo botë? Kjo botë është çdo gjë, si gratë, fëmijët, pasuria, fama, pozita, argëtimi dhe loja që të largojnë nga Allahu Subhanahu ve Teala dhe të pengojnë që të arrish te Ai."* (Letra e 73.)

Faktikisht, këto mirësi janë krijuar për njeriun. Problemi nuk është në përdorimin e tyre, por, kur të përdoren, të mos humbasë synimi bazë dhe të mos lejohen që të pengojnë arritjen te Allahu Teala.

Ata, të cilët largohen nga Allahu, duke u kënaqur me këtë botë, faktikisht janë njerëz që e kanë humbur ekuilibrin mendor. Ata janë njerëz që e kanë këmbyer të përhershmen me të përkohshmen dhe të bukurën me të shëmtuarën. Njëkohësisht e kanë harxuar edhe kapitalin e përjetësisë që kanë në duart e tyre:

*"Ai që është dashuruar me të (dynjanë), konsiderohet shpërdorues dhe i marrë. Ai që ndjek atë, është i çmendur dhe i mashtruar. Kush jepet pas aparençës së atij njeriu, në fytyrë i vendoset vula e humbjes së përhershme."* (Letra e 73.)

Sipas Imam Rabbanit, njeriu së pari duhet ta njohë mirë mashtrimin e kësaj bote, në mënyrë që të mbajë ekuilibrin ndërmjet fesë dhe botës. Përndryshe, kjo botë e mashtron njeriun dhe e bën ta harrojë ahiretin.

*"I mençur është ai që nuk mashtrohet pas një kënaqësie të tillë të thatë dhe që nuk ndjen interes për një gjë të prishur si kjo. Për këtë arsy, fakihët (juristët myslimanë) kanë thënë: "Nëse një njeri ua lë testamentin e pasurisë së tij njerëzve të mençur, pasuria e tij u jepet njerëzve asketë." Sepse ata nuk ndjejnë interes ndaj kësaj bote. Kjo tregon mentalitetin dhe zgjuarsinë e lartë të tyre."* (Letra e 50.)

Këto fjalë të Hazretit Imam Rabbanit janë për ata njerëz të cilët mashtrohen ndaj bukurive të përkohshme të kësaj bote. Sikundër kësaj, Hazreti Imam Rabbani në letrat e tij është bërë shkak që t'u plotësojë nevojat e kësaj bote shumë njerëzve dhe që mundësitet që kanë njerëzit, të përdoren në shërbim të fesë. Ai e shprehte kështu faktin se pasuria që harxhohet për të ngritur lart sheriatin te Allahu do të ketë shpërbirim të pafund, duke thënë:

*"Nëse me mijëra florinj harxhohen për të lartësuar sheriatin dhe fenë, edhe virtyti i tyre do të jetë shumë i lartë. Madje, edhe një grosh që harxhohet me këtë qëllim, është i barabartë me mijëra florinj që harxhohen për qëllime të tjera."* (Letra e 48.)


Të mëdhenjtë nakshibendij kanë vendosur parimin: "Dora në punë, Zemra te Zoti", për t'i mbajtur në ekuilibër punët e fesë dhe ato të kësaj bote. Njerëzit e mëdhenj, si Musa Topbashi, që ishte prej të mëdhenjve të zinxhirit të hoxhallarëve dhe që e kemi humbur në një kohë të afërt, fitonin për hir të Allahut dhe pasurinë e tyre sa malet e harxonin për të.

Kur këta miq të mëdhenj të Allahut shpenzonin për vete, ishin shumë kursimtarë, ndërsa kur bëhej fjalë përfenë e Allahut, xhelle xhelaluh, jepnin me lehtësi pasuri shumë të madhe, madje pa përdorur emrat e tyre.

Në këtë mënyrë e shtruan dynjanë poshtë këmbëvë të tyre për hir të fesë, në vend që të harxhonin fenë përfhir të kësaj bote dhe pasurisë e saj, që është arma më e madhe e shejtanit përfshirë mashtruan myslimanët, e bënë kurban në rrugë të Allahut, Subhanahu ve Teala. Shkrimin tonë le ta mbyllim me këto fjalë të Hazretit Imam Rabbanit:

*"Prej etikës së misticizmit është edhe parimi që ta ndash shumë pasurinë dhe të mos e kursesh atë, por pa i lënë në pozitë të vështirë fëmijët dhe gruan. Ai që e njeh Allahu, thesaret e Tij i shikon si një det, ndërsa veten e tij si një njeri të ulur në breg të atij deti. Ai, i cili qëndron në breg të detit, nuk ka nevojë që të mbartë ujë, përfshak se gjithmonë është pranë ujit."* (Sadik Dana, Ligjëratat e Alltënollukut, III, 52.)


I Nderuari Hz. Musa Topbash e vendosi lidhjen që kishte me këtë botë në një themel të tillë dhe harxhoi në rrugë të Allahu pa iu trembur syri. I lutemi Allahu të Madhëruar që edhe ne të na ndihmojë ta arrijmë këtë moral shembullor që kishin miqtë e Tij me karakter të lartë.





# FOTOJA E MUAJIT

PIAGA, FUSHE ÇELË  
NE SHKODER, 1961



# Koncepti i haramit në Kuranin Famëlartë

Shqipron Saramati

Besimtarët janë të detyruar të largohen dhe të ndalohen rreptësisht nga të gjitha ato gjëra që Allahu i Lartësuar i ka ndaluar për njerëzimin. Duhet ditur se ato që Allahu i ka urdhëruar, janë për interesin dhe të mirën e njeriut, por nuk duhet të harrojmë se edhe ato që ka ndalur Allahu (xh.sh.), padyshim janë në interes dhe në të mirë të njeriut.

Në fenë islame, të gjitha ato gjëra që janë ndaluar nga ana e Allahut (xh.sh.), për besimtarët quhen haram. Harami apo ndalesat, në fenë islame ndahen në dy grupe: Harami Li-Ajnihi dhe Harami Li-Gajrihi.<sup>1</sup>

**Harami Li-Ajnihi:** nënkupton atë që Ligjdhënësi (Zoti) e ka ndaluar rreptësisht, si: prostitucioni (zinaja), vrasja, ushqimet e ndaluara etj. Të pish verë dhe çfarëdo lloj pijesh alkoolike, të vjedhësh, të gjenjesh, të luash kumar etj. Në këto raste, vepruesi meriton të ndëshkohet nga ana e Zotit (xh.sh.), në këtë botë dhe në botën tjetër, pra në Ahiret.<sup>2</sup>

**Harami Li-Gajrihi:** nënkupton që për shkaqe të tjera konsiderohet haram. Ky haram është ai që në parim është i lejuar (mubah), por që për shkaqe të ndryshme është i ndaluar, pra haram, p.sh., agjërimi në ditën e bajramit. Pra, megjithëse agjërimi është farz (obligim), në ditën e bajramit është i ndaluar.

Duhet thënë se në Kuranin Famëlartë, gjërat që Allahu (xh.sh.), ka ndaluar (haramet) në krahasim me ato që ka lejuar (hallallet), janë të pakta.

**Zinaja-prostitucioni:** Në fenë islame, lidhjet farefisnore, mertesore dhe sociale, përveçse janë të pëlqyera, në të njëjtën kohë urdhërohet që të mos ndërpriten. Kurse në anën tjetër, lidhjet jashtëmertesore apo sëmundja shoqërore, e cila quhet "prostitucion", është e papëlqyer dhe e ndaluar.<sup>3</sup>

Feja Islame i ndërpërt rrugët të cilat çojnë drejt kësaj vepre të turpshme, të pamoralshme dhe rreptësisht të ndaluar.

1. TDV Islam İlmihali, c.l, faq.175

2. Hallalli dhe Harami, Kardavi, Jusuf, faq. 10

3. <http://www.guncelvaaz.com/kurani-karim-vaazlari/297-kiran-rimde-haramlar-vaaz.html>

Islami ndalon edhe nga të gjitha ato rrugë, të cilat të çojnë në këtë krim të turpshëm. Islami ndalon shikimin me qëllim epshi, prekjen, llafosjen me qëllime të tillë, nëpërmjet të cilave njeriu bie në këtë vepër të ligë. Kjo sëmundje shoqërore ka përfshirë më tepër popujt e arsimuar dhe me kulturë të lartë, të ashtuquajtur me kulturë perëndimore, sesa popujt që janë në nivel më të ulët të kulturës. Në këtë kohë tejet të vështirë, njerëzimit po i kanoset rreziku i dekadencës dhe i deformimit të pjellës njerëzore nga kjo sëmundje shoqërore. Prostitucioni, qoftë ai në shtëpi publike ose në mënyrë ilegale, po merr përmasa të gjera ndër radhët e rinisë, sidomos të asaj shkollore. Kjo vepër e shëmtuar dhe e dobët, është e palejuar dhe dënohet nga etika dhe mjekësia. Edhe feja e sheh me përbuzje e, sidomos feja islame, e gjykon si krejtësisht të ndaluar. Në të gjitha mënyrat islami dëshiron që kjo sëmundje të evitohet e të mos ekzistojë në radhët e besimtarëve. Për këtë, Allahu (xh.sh.), thotë:

**"Mos ju afroni imoralitetit, sepse është me të vërtetë një rrugë shumë e keqe."** (Isra, 32)

Me ajetin e lartpërmendor, Allahu (xh.sh.), së pari na bën me dije që të mos i afrohemë imoralitetit, ngase dëshira për të bashkuarit e gjinive të kundërtë ka aktivizuar dhe aktivizon shumë energji, emocione, synime, shpresë, por edhe shpirtligësi.

Në një ajet tjetër, Allahu (xh.sh.), na mëson se si besimtarët duhet t'i mbrojë shikimet e tij dhe se si duhet ta mbrojë nderin e tij: **"Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, se kjo është më e pastër për ta. Allahu është i njohur hollësishët për atë që bëjnë ata."** (Nur, 30)

**Të vrasësh:** Feja islame e ka ndaluar rreptësisht mbytjen e njeriut. Nëse mbytet një njeri, vrasësi do të jetë i ndëshkuar nga Allahu (xh.sh.) në këtë botë dhe në botën tjetër. Allahu në Kur'an thotë: **"Kush e mbyt një besimtar me qëllim, dënim i tij është Xhehenemi, në të cilin do të jetë përgjithmonë. Allahu është i hidhëruar ndaj tij,**



**e ka mallkuar dhe i ka përgatitur dënim të madh.**" (Nisa, 93)

**Ushqimet e ndaluara:** Në fenë islame disa ushqime janë të ndaluara. Allahu (xh.sh.), thotë: "**(Allahu) Ua ndaloi juve vetëm të ngordhurën, gjakun, mishin e derrit dhe atë që theret (ngrihet zëri me të), jo në emër të Allahut. E kush shtrëngohet (të hajë nga këto), duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos e tepruar, për të nuk është mëkat. Vërtet Allahu fal, është mëshirues.**" (Bekare, 173) Sipas Kuranit, të gjitha ushqimet janë hallall, përvèç ushqimeve të veçanta që janë përmendur në Kuranin Famëlartë, si haram. (Bekare, 172)

Pra, duke shikuar ajetin e lartpërmendor, kafshët e ngordhura, gjaku rrjedhës ose i ngrirë dhe nënproduktet e tij, derri, duke përfshirë edhe të gjitha nënproduktet e tij, kafshët e therura pa e përmendor emrin e Allahut, gjatë therjes së tyre. Kafshët e mytura në mënyrë që e ndalojnë gjakun plotësisht të kullojë nga trupi i tyre. Kafshët mishngrënëse, si: luani, qeni, ujku, tigri, etj. Shpendët grabitqarë, si: skifteri, shqiponja, kuvajka, huti, etj. Zvarranikët, gjarpëri, krokodili, etj. Mushka dhe gomari; kafshët e dëmshme, si: akrepi, miu, etj. Organet riprodhuese të kafshëve të lejuara. Allahu (xh.sh.), e ka ndaluar rreptësisht ngrënien e tyre. (Bekare, 172)

**Kamata:** Tregtia në fenë islame është e pëlqyer dhe e lejuar, mirëpo mashtrimi dhe fitimi i padrejtë është i ndaluar. Kurse feja islame e ka ndaluar kamatën në të gjitha llojet, format dhe ngjyrat e saj, sepse ajo përbën një fitim të pistë dhe pasuri të ndaluar, pasuri të cilën të pasurit kamatëdhë-nës (apo kreditorët) e marrin nga të varfërit nevojtarë pa të drejtë, pa mundim dhe pa punë. Kamata është e ndaluar në Kur'an, Sunet dhe sipas ixhmait të të gjithë dijetarëve. Allahu (xh.sh.), në Kur'anin Famëlartë thotë:

**"O ju që besuat, mos e hani mallin e tjetrit në mënyrë të palejuar, përpos tregtisë në të cilën keni pajtueshmëri mes vete dhe mos mytni veten tuaj (duke mytur tjetrin). Vërtet, Allahu është i mëshirueshëm përju."** (Nisa, 29)




**Pijet alkoolike:** Kurani Famëlartë i ka ndalur të gjitha ato gjëra që kanë pije alkoolike. Duhet ditur se nga metodat e tjera që përdor shejtani për t'i humbur njerëzit, është edhe përdorimi i pijeve alkoolike dhe bixhozi. A ka dëgjuar dikush ndonjëherë gjëra të mira që sjellin bixhozi e pijet dehëse? Kurrë. Që të dyja këto dukuri mbarojnë me një përfundim të ngjashëm: familja lihet në harresë, shkatërrohen dhe çdo gjë shuhet. Në lidhje me këtë, Allahu i madhëruar thotë:

**"O ju që besuat! S'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall), janë vepra të ndyra të shejtanit. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar. Shejtani nuk dëshiron tjetër, përvèçse nëpërmjet verës e bixhozit të hedhë armiqësi mes jush, t'ju pengojë nga të përmendorit e Zotit dhe t'ju largojë nga namazi. Pra, a po u jepni fund (alkoolit e bixhozit)?"** (Maide, 90-91)

Këtu shihet se Kurani na tregon gjerësisht se konsumimi i pijeve alkoolike, bixhozi, të gjitha këto janë shpikje dhe sajime të shejtanit dhe qëllimi i tij është që, nëpërmjet tyre, të sjellë urrejtje, armiqësi dhe përçarje mes nesh. Sa e sa martesa janë prishur si rezultat i këtyre veprave të ndyra? Sa fëmijë gjenden nëpër spitale, si shkak i rrahjes nga prindërit e tyre pjanecë? Sa gra duhet të vuajnë, për shkak se i kanë burrat përdorues të alkoolit, bixhozit? Kemi edhe gra të cilat konsumojnë alkolin, a thua se në të gjitha sëmundjet shoqërore nuk ka dallim mes mashkullit dhe femrës ... është vërtet për t'u pikëlluar. Kur njeriu konsumon alkool, harron edhe ekzistencën e Allahut, pasi i dehuri nuk di çfarë bën. E tërë kjo vjen si rezultat i faktit se njeriu i dehur nuk mund të kontrollojë mendjen.

Dhe në fund, duhet përmendur se harami dhe gjérat e lejuara janë çështje që vetëm Allahu (xh.sh.), i vendos: **"Mos i thoni asaj gënjeshtës së gjuhëve tuaja: "Kjo është hallall e kjo është haram" e të shpifni ndaj Allahut rrenën. Vërtet, ata që shpifin ndaj Allahut, nuk kanë shpëtim."** (Nahl, 116)



# Një Ajet

*Me emrin e Allahut,  
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!*

**“O besimtarë! Kërkonit ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit! Në të vërtetë, Allahu është me të duruarit.”** (Bekare, 153)

Kurani e konsideron jetën si një shkollë, kurse njeriun si nxënësin e saj. Përmes kësaj shkolle njeriu aftësohet e zhvillohet, duke arritur pjekurinë e duhur për të përbushur qëllimin, për të cilin është krijuar. Allahu na urdhëron të largohemi nga kjo shkollë, të pastruar nga veset e këqija dhe të zbukuruar me virtute.

Në shumë vende të Kuranit flitet për durimin dhe shpërblimin e madh që ai i sjell njerut, duke nxitur që durimi të bëhet veti e pandashme e çdo besimtar. Sepse përgjegjësia me të cilën është ngarkuar njeriu në këtë botë, është e madhe. Nga njëra anë, besimtarit i duhet të përballet me pengesat që i dalin përpara, gjatë rrugës së komunikimit dhe përcimit të mesazhit islam, nga ana tjetër, i duhet të luftojë me botën e tij të brendshme kundër egoizmit, i cili është në natyrën e njeriut dhe ngacmimive të shejtanit. Për këtë arsy, njeriu duhet të pajiset me vetinë e durimit, për të ngadhënjer mbi vështirësitë.


Durimi është aftësia për të duruar e për të përballur vështirësi, shqetësimë vuajtje e fatkeqësi në rrugë të drejtë, pa u ankuar e pa u ligështuar. Ashtu si nuk ka lidhje me kokfortësinë, durimi nuk ka lidhje as me mungesën e reagimit ndaj së keqes. Besimtarit i duhet të jetë krenar dhe i nderuar dhe jo t'u nënshtrohet pëdrejtësive. Së pari, durimi është cilësi dalluese e Pejgamberëve të Zotit dhe ndjekësve të tyre besnikë. Një sërë cilësish morale fitohen nëpërmjet durimit. Të jetuarit si mysliman është e lidhur ngushtë me durimin. Kur Pejgamberi (a.s.) u pyet se çfarë është imani, tha: “*Të jesh durimtar dhe tolerant.*” Durimi është faktor dominues në sigurimin e ndihmës së Allahut dhe për pasojë, suksesit. “*Sa herë, me ndihmën e Allahut, një ushtri e vogël ka ngadhënjer mbi një ushtri të madhe! Allahu është me të durueshmit.*” Pra, ndihma e Allahut është pranë durimtarëve. Durimi është një veti që i sjell besimtarit përfitime materiale dhe shpirtërore. Durimi është formula përsukses në këtë botë dhe lumturi të përjetshme në botën tjetër. Pa durim nuk mund të arrihet, as morali i lartë dhe as ibadetet nuk mund të kryehen siç duhet. Pa durim, njeriu nuk mund të ketë sukses, as në studime, as në jetën profesionale. Besimtarit i duhet të jetë i durueshëm me familjen, të afërmët, fqinjët, me shokët në çdo kohë dhe mjedis, duke i përballuar me qetësi shqetësimet që mund të vijnë prej tyre.

Një nga mënyrat më të mira për t'i kerkuar ndihmë Allahut, është namazi. Rukuja dhe sexhdja, në një mënyrë është lutje për ndihmë. Durimi dhe namazi janë përmendur puqur për rolin që kanë në arritjen e ndihmës së Allahut. Durimi dhe qëndresa përballë vështirësive të kësaj bote kanë nevojë për mbështetje shpirtërore. Nëpërmjet lidhjes së ngushtë që krijon ndërmjet besimtarit dhe krijuesit, namazi i bën besimtarin të qëndrueshëm përballë vështirësive. Gjatë rrugës së jetës, namazi është ushqimi më i rëndësishëm për besimtarin, sepse e mban njeriun larg nga vesveset e shejtanit dhe kështu, ai vazhdon rrugën e tij pa u ligështuar.

Durimi merr vlerë vetëm në një moment të caktuar dhe ai është momenti i parë i përballetes me vështirësitë. Një karakteristikë e jetës së njeriut është ndryshueshmëria. Për një moment jeton i gëzuar, i lumtur, pastaj papritur mund të përballet me një fatkeqësi ose anasjelltas.

Jeta nuk është gjithmonë bardhezi; ajo është e mbushur me të gjithë spektrin e ngjyrave.

Jeta e njeriut nuk është gjithmonë e lumtur apo e trishtueshme; shpesh këto gjendje zëvendësojnë njëratjetëren. Jeta e njeriut rrjedh ndërmjet këtyre dy gjendjeve. Për rrjedhojë, duhet të jemi të përgatitur për çdo të papritur që mund të na ofrojë jeta, me uljet dhe me ngritjet e saj.



# Një Hadith

*Transmetohet nga Abu Hurejra (r.a.)  
se Resulullahi (s.a.v.s.) ka thënë:*

“Prej shenjave të besimtarit të mirë është braktisja e të padobishmes.”

Çdo gjë në këtë botë, Allahu e ka krijuar për dobi të njerëzve. Për rrjedhojë, asgjë në këtë botë nuk është e padobishme, por jo gjithmonë, çdo gjë është në dobi të çdo njeriu. Në hadithin e mësipërm, çdo gjë që nuk sjell përfitim për këtë botë apo botën tjetër, konsiderohet e padobishme.

Pejgamberi (a.s.), përmes hadithit, nxit besimtarët të përsosin besimin e tyre, duke braktisur çdo gjë që nuk është në interes dhe dobi të tyre. Tregues të besimtarit të mirë janë virthyte të tilla, si drejtësia, besnikëria, ndershmëria. Kurse tregues i besimtarit të dobët është gënjeshtra, tradhëtia, pabesia. Ky hadith i drejtohet gjithë bashkësisë islame, për ta pajisur me virthyte, që zbuluojnë besimin dhe i afrojnë njerëzit te Krijuesi. Eleminimi i një sërë dukurive negative në shoqëri, bëhet i mundur me braktisjen e gjërate të padobishme. Preokupimi i njeriut me gjëra të dobishme, është në interes të tij, sepse, nëse ai nuk e bën këtë, do të bjerë në kurthet e mëkateve. Kush preku pohet me njerëzit, harron veten e tij dhe merret me thashetheme.

Një tjetër kuptim i rëndësishëm që nxjerrim nga hadithi, është edhe rëndësia e kohës, sepse njeriu që merret me gjëra të padobishme, ka harxhuar kohën, mirësinë më të madhe që i është dhuruar njeriut.

Kriter për të përcaktuar saktë çfarë është e dobishme dhe çfarë jo, është feja dhe jo opinioni i njerëzve, sepse sot në mesin e myslimanëve po vihet re indiferentizëm i theksuar ndaj shumë dukurive negative, që janë urdhëruar të pengohen me shariat, me pretekstin se nuk u interesojnë. Ky nuk është largim nga e padobishmja, por shmangje nga përgjegjësitet, siç është këshillimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja.

## Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Mospreokupimi me punë të padobishme është shenjë e besimit të përsosur
2. Njeriu duhet të angazhohet me punë që sjellin përfitime në këtë botë dhe në botën tjetër
3. Braktisja e të padobishmes vjen si pasojë e ndërgjegjësimit të personit se në çdo moment është në mbikëqyrjen e Allahut.



Nga morali shembullor i të dashurve të Allahut

## TË ZGJEDHËSH BOTËN TJETËR NË VEND TË KËSAJ BOTE

Çdo besimtar, nga vetë natyra e besimit ia di për nder dikujt që i bën një të mirë, e falënderon dhe bën dua për të. E nëse gjen rastin, mundohet t'i kthejë nderin me diçka edhe më të mirë. Është e domosdoshme të falënderosh, qoftë edhe për një gotë ujë, sepse kjo tregon edukatë dhe mirësjellje.

Në një ajet fisnik urdhërohet:

**"Nëse do t'i numëronit mirësitë e Allahut, nuk do të mund t'i llogarisnit ato..."** (en-Nahl, 18)

Dhe padyshim, mirësia më e madhe është **"besimi"**. Ashtu siç tregojmë mirënjohje për çdo mirësi, duhet të tregojmë mirënjohje edhe për mirësinë e besimit. Mirënjohja më e madhe që mund të tregohet për mirësinë e besimit, është të jetuarit me devotshmëri dhe besim të sinqertë, duke falënderuar dhe duke përmendur shumë Allahun.

Besimtarit duhet t'i jetë mirënjohës Allahut për çdo mirësi që Ai i ka falur dhe veçanërisht, për mirësinë e **"besimit"**, sepse, nëse dikush nuk tregon mirënjohje për një të mirë që i është falur, nuk mund të quhet as meritues i saj.

Besimi është mirësia më e madhe hyjnore. Ndërsa sprova është një njësi që mat vlerën dhe rëndësinë e vet dhe mbrojtjen që i bëjmë. Ajo që kërkohet prej besimtarëve, është ruajta e besimit me durim dhe nënshtrim, duke i përballuar me sukses të gjitha ndryshimet e kushteve të jetës. Në të njëjtën kohë, ky është edhe tregues i nivelit në arritjen e shpërblimeve hyjnore. Në një ajet të Kur'anit Kerim urdhërohet:

**"Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit..."** (et-Teube, 111)

Koha e kaluar në këtë botë, nuk është as sa një pikë ujë ose një kokërr rëre, në krahasim me pafundësinë e botës tjetër. Mirëpo, rezultati i provimit të kësaj bote, është ose

Xheneti, vendi i lumturisë së pafundme, ose Xhehenemi, vendi i dhimbjeve pa fund. Drejtimi i udhës që do të marrë njeriu, përcaktohet nga **"zgjedhja midis botës tjetër dhe kësaj bote"**, që bën ai në këtë jetë të përkohshme. Në bazë të kësaj, nuk mund të ketë mashtrim më të madh sesa pakujdesia që tregohet, kur zgjidhet kjo botë e përkohshme në vend të botës tjetër.

Ndërsa të dashurit e Allahut, që janë zgjuar nga gjumi i shkujdesjes prej dritisë së afërsisë me Hakun, çdo germë të librit të gjithësisë e shohin me syrin e zemrës dhe urtësinë e mendjes. Ata janë të vetëdijsëm se gjithësia është krijuar me një qëllim madhështor, se asgjë nuk është krijuar më kot dhe se çdo ditë shkëputet nga një fletë prej kalendarit të jetës së njeriut, që i afrohet varrit edhe një hap më shumë. Ata jetojnë një jetë në një gjendje shpirtërore të thelli dhe delikate, duke medituar mbi pyetjet: "Cili është kuptimi dhe urtësia e mirësisë së jetës? Përse kjo botë është përgatitur për t'u menaxhuar nga njeriu? Prej nga erdhëm në këtë botë dhe ku po shkojmë?".

### TREGUESI I NJË ZEMRE TË PASTËR

Në lidhje me atë, për të cilën do të kemi më tepër nevojë në ditën e gjykimit, Allahu Teala shprehet:

**"Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përvëç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!"** (esh-Shu'ara, 88-89)

Ndërsa arritura e një **Zemre të pastër**, varet nga përgatitja për udhëtimin në botën tjetër, pa ardhur ftesa nga bota e varrit. Për këtë arsy, kërkohet që zemra të rafinohet nga çdo gjë që e largon atë nga Allahu, pra, të pastrohet dhe, të mirat që i janë falur në këtë botë, t'i kthejë në një kapital të lumturisë dhe shpëtimit në botën tjetër.

Të dashurit e Allahut i kanë përkufizuar kështu, dy cilësítë më kryesore të një **zemre të pastër**:



1. Të mos cenosh askënd dhe të mos cenohesh nga askush, sepse zemra është vend vështrimi hyjnor.

2. Kur të përballesh me punë të kësaj bote dhe të botës tjetër, të zgjedhësh punët e botës tjetër.

Besimtar që arrin përsosmërinë morale me zemër të pastër, ka arritur kulmin e vetëdijes së të qenit bashkë me Allahun. Ai e ndjen veten gjithmonë në prezencën e Allahut dhe nën kamerat hyjnore. Gjithashtu, ai gjendet gjithmonë duke medituar këto ajete fisnike:

*“...Ai është me ju kudo që të gjendeni...”* (el-Hadid, 4)

*“...Ne jemi më pranë tij se damari i qafës.”* (Kaf, 16)

Të dashurit e Allahut, që ndodhen në kulmin e devotshmërisë, tregojnë shumë kujdes për të vërtetën e botës tjetër, të cilën Allahu i Madhëruar na e kujton shpesh dhe ndjekin udhën e drejtë në rrugëtimin e kësaj bote. Gjithashtu, janë të gatshëm të heqin dorë nga çdo e mirë e kësaj bote, vetëm e vetëm që të mos u cenohetjeta e botës tjetër.

### EDHE SIKUR TË NA JAPIN GJITHË BOTËN, NUK E NDËRROJMË ME NJË PUNË TË BOTËS TJETËR!..

Ndërsa Musai (a.s.), ishte duke jetuar mes të mirash në sarajin e Faraonit, mori vesh se Faraoni donte ta vriste. Prandaj mori menjëherë rrugën për në Medjen, pa u pajisur me ushqim. Vazhdoi të ecetë për tetë ditë me radhë, pa ngrënë e pa pirë. I pafuqishëm dhe i këputur, arriti deri përparrë mureve të kalasë së Medjenit. Pasi i ndihmoi vajzat e Shuaibit (a.s.), për t'u dhënë ujë kafshëve, por pa e ditur

se kush ishin ato, u ul nën hijen e një peme dhe filloj t'i lutej Allahut, duke thënë:

*“...Zoti im, unë me të vërtetë kam nevojë për çfarëdo të mire që të më japësh!”* (el-Kasas, 24)

Kur Shuaib (a.s.), mori vesh për këtë person, që i kishte ndihmuar vajzat e tij, e ftoi në shtëpi për ta gostitur. Megjithëse Musai (a.s.), kishte tetë ditë pa futur gjë në bark, nuk e zgjati dorën tek ushqimet që iu vunë përparrë dhe i tha Shuaibit (a.s.):

*“Ne jemi një familje e tillë që, edhe sikur të na jatin gjithë botën, nuk e ndërrojmë me një punë të botës tjetër! Unë nuk ju ndihmova për këtë ushqim, por për hir të Allahut”.*

Shuaibi (a.s.), u kënaq shumë nga kjo përgjigje dhe tha:

*“Këtë ushqim nuk po tajapim për arsy se na ndihmove, por sepse ja mysafir i Hakut”.* Pas këtyre fjalëve, Musai (a.s.), e pranoi ushqimin që iu ofrua.

Ja pra, ky është një shembull shumë i bukur i pasqyrimit të besimit në botën tjetër tek sjelljet. Ky është virtyti që e bën njeriun të mos e ndërrojë një punë të botës tjetër me ndonjë gjë të kësaj

bote, edhe nëse e di shumë mirë se do t'i humbasë e gjithë fuqia prej urisë... Një shembull tjetër të një pjekurie të tillë shpirtërore, na e sjell Uasilebin Eska (r.a.), i cili tregon:

Gjatë ditëve, kur ishim duke u përgatitur për të dalë në fushatën e Tebukut (unë nuk kisha as armë dhe as kafshë që të merrja pjesë në këtë fushatë, por për të mos u privuar nga kjo luftë e shenjtë), u thirra vëllezërve të mi myslimanë në sheshin e Medinës:



*“...Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet.”* (Kaf, 16)

*Besimi është mirësia më e madhe hyjnore. Ndërsa sprova është një njësi që mat vlerën dhe rëndësinë e vet dhe mbrojtjen që i bëjmë.*

*ajo që kërkohet prej besimtarëve, është ruajtja e besimit me durim dhe nënshtrim, duke i përballuar me sukses të gjitha ndryshimet e kushteve të jetës.*

*"Kush do të më marrë në kafshën e vet në këmbim të plaçkës së luftës, që do të më bjerë për pjesë?"*

Një burrë i moshuar prej Ensarëve tha se mund të më merrte në luftë, me kusht që të hipnin me radhë në kafshën e tij. Kur erdhi çasti, dola për udhë së bashku me atë njeri bujar. Allahu na bëri kësмет që të fitojmë edhe plaçkë luftë. Më ranë disa deve dhe i çova të gjitha tek njeriu që më mori në luftë. Ai më tha:

*"Merri devetë dhe shko!"*

Megjithëse ngula këmbë, duke i thënë: "Sipas marrëveshjes që kemi bërë këto të takojnë ty", Ensari m'u përgjigj:

*"O vëlla! Merre plaçkën tënde, sepse unë nuk e dua atë hise. (Unë të solla këtu duke menduar për shpërblimin që do të na japë Allahu në botën tjetër.)" (Ebu Daud, Xihad, 113/2676.)*

Kështu që, ai Ensar i bekuar, në vend që të zotëronte disa deve si pasuri e kësaj bote, zgjodhi shpërblimin që do të merrte në botën tjetër. Ai veproi me urtësi, duke braktisur një interes me vlerë të madhe të kësaj bote, për të shtënë në dorë një mirësi për hir të Allahu.

Njërin prej të dashurve të Allahu e pyetën nëse kishte përjetuar ndonjë ngjarje që i kishte lënë shumë mbresa. Ai tregoi këtë ndodhi:

*"Kur isha në Meke-i Mumerreme, humba qesen me para dhe ngela në vështirësi. Po prisja ca para nga Basra, por nuk po vinin. Flokët dhe mjekra më ishin rritur goxha shumë. Vajta tek një berber dhe e pyeta: "A më qeth për hir të Allahu, sepse nuk kam para?".*

Në atë moment, berberi ishte duke qethur dikë tjetër, por menjëherë më bëri me shenjë një vend bosh dhe më tha: "Ulu aty". E la myshteriu të priste dhe filloj të më qethite mua. Kur myshteriu, i cili po priste, filloj të bënte fjalë, berberi tha:

*"Ju kërkoj ndjesë zotëri. Juve po ju qeth me para, por ky njeri më kërkoi ta qeth për hir të Allahu. Punët që janë për hir të Allahu, kanë gjithmonë përparrësi dhe nuk kanë ndonjë interes material. Shpërblimin e punës për hir të Allahu, njerëzit as nuk mund ta dinë dhe as nuk mund ta paguajnë!".*

Pasi më qethi, berberi më futi në xhep me zor disa monedha ari dhe më tha:

*"Këto i ke për nevojat më urgjente dhe ma bëj hallall, sepse kaq mundësi kam!".*

Ditën e nesërme më erdhën paratë që po prisja nga Basra dhe i çova berberit një qese me flori. Berberi tha:

*"Nuk i marr kurrë! Shpërblimin e punës për hir të Allahu, robi nuk mund ta paguajë kurrë. Shkonit dhe vazhdoni rrugën tuaj. Allahu ju dhëntë paqe dhe mirësi!".*

I kërkova hallallëk dhe u ndava me të, por tash e dyzetë vjet, çdo mëngjes bëj dua për të.

Ja pra, kjo është urtësia e mosndërrimit të punëve për hir të Allahu, me punët e kësaj bote... Kjo është një sjellje e përsosur, të cilën nuk mund ta kuptojnë mendjecekëtit, që janë mësuar të shohin gjithçka nga pamja e jashtme dhe, që prej ambicies për të fituar para, nuk bëjnë dallim mes hallallit dhe haramit... Kjo është një ndjenjë, e cila nuk mund të kuptohet pa shikuar prej horizontit të miqësisë me Hakun. Kjo është urtësia dhe zgjuarsia e vërtetë...

## MENÇURIA E VËRTETË!

Në bazë të logjikës dhe mendjes së shëndoshë, interesat e vogla dhe të përkohshme braktisen për hir të fitimeve më të mëdha, të cilat zgjasin pafundësish. Allahu Teala, në një ajet fisnik urdhëron:

*"Jeta e kësaj bote është vetëm lojë e argëtim, kurse bota tjetër, padyshim që është më e mirë për ata që i frikësohen Allahu. Pra, a nuk po mendoni?" (el-En'am, 32.)*

Ndërsa në një hadith të nderuar, Profeti (a.s.), shprehet kështu, në lidhje me zotëruesit e mendjes:

*"I mençur është ai që e mbizotëron nefsin (egen), i kërkon llogari (nefsit) dhe përgatitet për (jetën) pas vdekjes. Ndërsa mendjelejtë është ai që shpreson (mirësi) nga Allahu, megjithëse nefsi i tij shkon pas epsheve dhe dëshirave". (Tirmidhi, Kiamet, 25/2459.)*

Mençuria dhe zgjuarsia e vërtetë e një njeriu duhet të peshohet nën dritën e këtyre të vërtetave. Mendje e shëndoshë është ajo që zgjedh të përhershmen në vend të së përkohshmes.

Profeti ynë (a.s.), në një hadith të nderuar ka thënë:

*"Gjendja e kësaj bote në krahasim me botën tjetër, është sikur dikush prej jush të fusë gishtin në det dhe ta nxjerrë. Çfarë të nxjerrë gishti (nga deti), aq është edhe kjo botë (në krahasim me botën tjetër)". (Hakim, Mustedrek, 4/319.)*

Në periudhën e Mekes, kur sahabët e nderuar ndodheshin nën torturat dhe embargon e mushrikëve, thoshin me njëri-tjetrin:

*"Ne po durojmë çdo vuajtje, përt' u bërë robër të devotshëm të Allahu. Ndërsa mohuesit, që i ngrenë krye Allahu, shëtisin botën të qetë dhe i përdorin të mirat e kësaj bote sipas*



*dëshirës*". Për këtë arsy, Allahu i Madhëruar i urdhëroi besimtarët që të zgjedhin botën tjetër, e cila është më e mirë se kjo botë:

*"Ti (o Muhamed) mos u mashtro nga bredhja e jobesimtarëve nëpër botë! Kjo mirëqenie është e shkurtër; pastaj, strehimi i tyre është Xhehenemi. Eh, sa shrat i keq është ai vend! Por, ata që i frikësohen Zotit të tyre, do të kenë kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përjetësisht, si dhuratë prej Allahut. Dhe ajo që është tek Allahu, është dhurata më e mirë për besimtarët e vërtetë."* (Al'i Imran, 196-198.)

Prandaj nëse shohim prej drithares së botës tjetër, do të kuptojmë se mirëqenia dhe rehatia e kësaj bote nuk janë gjë tjetër, veçse përfitime të vogla. Nëse kjo botë do të kishte ndonjë vlerë tek Allahu, Ai do të bënte që robërit e Tij më të dashur, profetët, të jetonin në saraje luksoze deri në ditën e kiametit. Mirëpo, Allahu Teala, u tregoi profetëve dhe robërve të Tij të dashur ftyrën e vërtetë të kësaj bote të përkohshme dhe i orientoi zemrat e tyre për nga bota tjetër, e cila është më e mirë se kjo botë.

Në një hadith të nderuar, Profeti ynë (a.s.), thotë:

*"Unë nuk kam asnje lidhje me këtë botë. Puna ime në këtë botë është si udhëtari që ndalon nën hijen e një peme dhe pastaj vazhdon rrugën".* (Tirmidhi, Zuhd, 44.)

Jeta e sahabëve të nderuar, të cilët u edukuan me edukatën profetike, është një shembull i pashoq për ne, në lidhje me këtë çështje. Malli i tyre për botën tjetër dhe dëshira e tyre për të rënë dëshmorë, ishin aq të forta, saqë janë bërë legjenda që transmetohen brez pas brezi.

Dëshira për këtë botë ishte fshirë nga sytë e të rinjve myslimanë, që kalonin midis xhelatëve të gatshëm për t'u prerë kokat, vetëm për të dorëzuar letrat e ftesës në Islam të Resulullahut. Dashuria për Profetin (a.s.), u kishte kapluar çdo qelizë, madje edhe vetë qenien e tyre. Ndërsa guximi i besimit të tyre ishte i tillë, sa trembte edhe mbretërit. Ata ishin aq shumë të lidhur shpirtërisht me Profetin (a.s.), saqë edhe në rreziqet, ku ndihej shija e vdekjes, thoshnin:

*"O Resulallah! Vepro si të duash. Na urdhëro dhe ne jemi me ty. Për Allahun, i Cili të ka dërguar, edhe nëse hyn në det, do të hyjmë bashkë me ty dhe askush prej nesh nuk do të ngelet pas!..* (Ibën Hisham, II, 253-254.)

Në fillim të hilafetit të tij, Omeri (r.a.), i pati thënë njërit prej myslimanëve të parë, Habbabin Eret'it (r.a.):

*"A po më tregon pak për torturat që ke hequr në rrugë të Allahut?"*

Habbabi (r.a.), tha:

*"O emiri i besimtarëve, shiko shpinën time!"*

Kur Omeri (r.a.), pa shpinën e tij, tha me habi të madhe:

*"Në jetën time nuk kam parë një shpinë njeriu kaq të dëmtuar."*

Më pas, Habbabi (r.a.), vazhdoi:

*"Qafirët ndiznin zjarr dhe më shtrin mbi prush, pa asnjë rrobë mbi trup. Zjarri fikej vetëm prej dhjamat që shkrihej nga kurri im".* (Ibën Esir, Usdu'l-Gabe, II, 115.)

Ja pra, kështu i torturonin mushrikët besimtarët, në vitet e para të Islamit, por përsëri nuk ia arritën qëllimit që t'i bënë besimtarët të thoshnin fjalë kufri, sepse forca e besimit i shuanë të gjitha dhimbjet e përkohshme.

Në kahasim me dëshirën dhe shqetësimin e sotëm të njerëzimit për të jetuar më rehat dhe më gjatë, dëshira më e madhe e brezit të sahabëve, ishte të shkonin në botën tjetër faqebardhë, me ndërgjegje të qetë dhe zemër të pastër.

Një ditë, Ibën Mes'udi (r.a.), u tha shokëve të tij:

*"Ju agjeroni, falni namaz dhe bëni punë të mira më shumë se sahabët e Resulullahut (a.s.), por ata ishin më të mirë se ju".*

Ata pyetën të habitur:

*"E si është e mundur kjo?"*

*"Ata ishin më larg kësaj bote dhe e dëshironin më shumë se ju botën tjetër."* -tha ai. (Hakim,

Mustedrek, 4/135.)

Njësoj si brezi i sahabëve, që me forcën e madhe të besimit ia kushtuan jetën e tyre Allahut edhe myslimanët në luftën legjendare të Çanakalesë, me forcën e besimit të tyre shfaqën shembuj të pashoq. Ata ishin të vetëdijshëm për borxhin që kishin në mbrojtjen e vatanit dhe nuk ngurruan të jepnin edhe jetët e tyre.

Edhe ne, ashtu si brezi i sahabëve dhe gjyshërit tanë, e kemi për detyrë që, kur të jetë nevoja, ta braktisim këtë botë dhe të ecim në gjurmët e shenjta dhe të ndritura të Profetit (a.s.).

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë herëpasHERE dhe në raste të ndryshme: *"O Allah! Jeta e vërtetë, është vetëm jeta e botës tjetër".* (Buhari, Rikak, 1.)

Edhe ne, si umeti i Profetit (a.s.), duhet që këtë parim ta qëndisim në zemrat tona. Nëse përfitojmë diçka prej të mirave të kësaj bote, të themi: *"O Allah! Jeta e vërtetë, është vetëm jeta e botës tjetër"* dhe të falënderojmë pronarin e vërtetë të këtyre mirësive. Gjithashtu, duhet të qëndrojmë larg kryeneçësisë, shkujdesjes dhe arrogancës. Në lidhje me ata që janë të privuar nga këto ndjenja, Allahu shpre-



**“Në Ditën, kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!” (Shuara, 88-89)**

het kështu:

**“...Jobesimtarët i gëzohen jetës së kësaj bote, por jeta e kësaj bote, në krahasim me botën tjetër, është vetëm kënaqësi kalimtare.”** (er-Ra’d, 26.)

Edhe kur të përballemi me ndonjë fatkeqësi apo dëshirë të madhe për diçka që na e vështirëson durimin, si besimtarë që jemi, duhet të themi: “O Allah! Jeta e vërtetë, është vetëm jeta e botës tjetër” dhe të ruajmë qëndresën dhe ekuilibrin shpirtëror, duke treguar durim, dorëzim dhe mbështetje tek Allahu. Gjithashtu, duke kërkuar gjithmonë strehim tek Allahu, të jetojmë të vetëdijshëm se “...kënaqësitë e kësaj jete janë të vogla. Jeta tjetër është më e mirë për ata që e kanë frikë Allahu e s’bëjnë gjynahe...” (en-Nisa, 77.)

Në një ajet fisnik tregohet qartë se jeta e kësaj bote, e cila konsumohet në mënyrë të shthurur, duket sikur nuk do të ketë kurrë mbarim, në fakt nuk është gjë tjetër, veçse një periudhë kohore e shkurtër:

**“Ditën kur do ta shohin atë, (njerezve) do t’u duket se kanë qëndruar (në Tokë) veç një mbrëmje apo një mëngjes.”** (en-Naziat, 46.)

Prandaj, gjëja më e bukur, që mund të bëjmë në këtë jetë shumë të shkurtër, është devotshmëria e singertë ndaj Allahut. Mirëpo, për fat të keq, ashtu si të gjitha mirësitë e tjera edhe mirësia e jetës nuk kuptohet, nëse nuk e humbet. Sa kuptimplotë është kjo bejte e Nexhip Fazllit, që na kujton se “meditimi i vdekjes” është mundësia e vetme që mund të shpërndajë mjegullën e shkujdesjes së përgjithshme, e cila qëndron mbi nocionin “kohë”:

Koha është një këmishë force, ajo që e shqyen është vdekja;

Në bazë të kësaj të vërtete, të parët tanë, zemrat e të cilëve janë gatuar në atmosferën e besimit dhe dijes, nëpër varreza, që na kujtojnë përkohshmérinë e kësaj bote, kanë mbjellë pemë selvie, të cilat nuk i lëshojnë kurrë gjethet dhe simbolizojnë pafundësinë e botës tjetër.

Këto këshilla të Llukmanit, në lidhje me vetëdijen për botën tjetër, janë shumë të rëndësishme për ne:

**“Biri im! Sakrifikokojetë e kësaj bote për botën tjetër, që t’i fitosh të dyja. Por ki kujdes! Mos sakrifikoketë e botës tjetër për këtë botë, sepse do t’i humbësh të dyja.”**

Kjo botë dhe bota tjetër u ngajnjë dy anëve të peshores. Nëse i jepet rëndësi njërs anë, lehtësohet ana tjetër. Por zemra e besimtarit me mendje të shëndoshë, duhet të anojë gjithmonë për nga bota tjetër. Kjo, sepse dashuria për botën tjetër del nga zemra e atyre që kaplohen nga dashuritë e përkohshme të kësaj bote, u binden epsheve të kota dhe lumturohen me to. Por, kur në zemër zë vend zëri i ftesës për në botën tjetër, mendimi i ftesës për këtë botë bëhet i huaj.

### ILAÇI I NGURTËSIMIT TË ZEMRËS

Shumë prej problemeve që po përjetohen në ditët e sotme dhe që qëndrojnë në thelb të shqetësimeve shpirtërore dhe të ngurtësimit të zemrës, burojnë nga harrimi i botës tjetër dhe dhënia mbas kësaj bote. Aq sa, shumë të varfër torturojnë shpirtin me ambicjen për t’u bërë të pasur dhe shumë të pasur bëjnë të njëjtën gjë me ambicjen për t’u bërë edhe më të pasur. Ata jepen pas lukseve të mbushura me zbukurime dhe të mbuluara me ar të kësaj bote të përkohshme, por harrojnë se pasuria më e madhe është të jesh i kënaqur me atë që ke.

Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

**“Kush dëshiron botën tjetër, Allahu ia pasuron zemrën dhe ia lehtëson punët. Ndërsa kjo botë, i vjen nga pas e nënshtruar. Kush dëshiron këtë botë, Allahu vendos varfërinë midis dy syve të tij dhe ia vështirëson punët. Ndërsa prej kësaj bote nuk përfiton më shumë se sa i është caktuar.”** (Tirmidhi, Kiamet, 30/2465.)

Ja pra, kjo është receta profetike për qetësimin e shpirtit, të zemrës dhe ndërgjegjes...

Një herë, kur Resulullahu (a.s.), u pyet për kuptimin e fjalës “sherh/hap”, që kalon në këtë ajet: **“Allahu ia hap**

**zemrën për (të pranuar) Islamin atij që dëshiron ta udhëzojë..."** (el-En'am, 125), u përgjigj:

"Kur nuri hyn në zemër, kraharoni hapet dhe zgjerohet përtë".

Përsëri e pyetën: "A ka ndonjë tregues përkëtë?" dhe ai u përgjigj:

"Po, ka! Kthimi i shpinës ndaj kësaj bote mashtruese, orientimi përngrajeta e pafundme, që është bota tjetër dhe përgatitja përvdekjen, pa ardhur ajo". (Ihja'u-Ulumi'd-Din, IV, 406-7.)

Në një hadith tjetër, profeti ynë (a.s.), thotë:

"Atij që zgjedh këtë botë, në vend të botës tjetër, Allahu i jep tri bela: shqetësimin që nuk i hiqet kurrë prej zemrës, varférinë, prej së cilës nuk ka mundësi të shpëtojë dhe ambicien që nuk di të ngopet". (Ihja'u-Ulumi'd-Din, IV, 411.)

## PROBLEMI NUK ËSHTË TEK KJO BOTË, POR TEK AI QË MASHTROHET ME TË...

Në fakt, të mirat e kësaj bote, të cilat tundojnë nefsin (egon) e njeriut, Allahu Teala me urtësinë e Vet, i ka bërë sprova, me të cilat duhet të përballohem. Mashtrimi me këto të mira, i ngjan peshkut që ngel në grep. Peshku mashtrohet pas karremit dhe nuk e sheh grepin që është fshehur në të. Ja pra, ata që nuk e shohin këtë kurth, nuk mund të shpëtojnë pa u mashtruar prej tij. Për të kaluar sprovat hyjnore, ku kanë rrëshqitur shumë këmbë dhe janë fundosur shumë shpirtëra, duhet kuptuar mirë thelbi i të mirave të kësaj bote dhe të arrihet të perceptohet "misteri i sprovës", që fshihet në to. Ndërsa, përtë zotëruar një aftësi të tillë, është kusht që të jemi vijgilentë ndaj kurtheve joshëse të kësaj bote, si pasuria, epshi dhe fama dhe, si do që të jetë puna, të zgjedhim shpëtimin e botës tjetër.

Në lidhje me këtë çështje, Allahu Teala na paralajmëron kështu:

**"Por ju, përkundrazi, më shumë po parapëlqeni jetën e kësaj bote, ndonëse jeta tjetër është më e mirë dhe e amshuar."** (el-A'la, 16-17)

**"...Ju dëshironi të mirat kalimtare të kësaj bote, kurse Allahu dëshiron botën tjetër..."** (el-Enfal, 67)

Pasuria që fitohet në këtë botë, më e shumta e shoqëron të zotin deri në varr. Pasuria e dukshme, që mund të marrë njeriu në varr prej kësaj bote, është vetëm qefini. Ndërsa pasuria e padukshme, është besimi dhe punët e tij. Prandaj, nuk duhet të mashtrohem pas pasurisë së pabesë dhe kënaqësive të përkohshme të kësaj bote.

Sipas transmetimeve, Dhulkarnejni, i cili pushtoi të gjithë botën, para se të vdiste, la këtë amanet:

"Më lani dhe më qefinosni! Pastaj më vendosni në një tabut, por krahët m'i lini të varurjashtë! Shërbëtorët e mi të më vijnë nga pas dhe pasurinë time ngarkojeni nëpër mushka! Le ta shohë populli se unë po iki me duar bosh, ndonëse zotëroja kulmin e madhështisë dhe thesaret e gjithë botës. Edhe shërbëtorët të shohin se thesarët e mi qëndruan në këtë botë e nuk më erdhën pas! Prandaj, të mos mashtrohen prej kësaj bote gënjeshtare dhe të përkohshme!..

Dijetarët e kanë komentuar kështu, këtë amanet:

"...E gjithë bota ishte nën drejtimin tim. Zotërova thesare të panumërtë. Mirëpo, të mirat e kësaj bote nuk janë të përhershme. Ja pra, siç e shihni, po shkoj në varr me duar bosh! Pasuria e kësaj bote, ngelet në këtë botë. Prandaj, shihni punët të cilat do t'ju vlejnë në botën tjetër!.."

Edhe Profeti ynë i dashur (a.s.), na ka këshilluar në këtë mënyrë:

"...Po ju lë amanet pesë këshilla, me qëllim që Allahu t'u plotësojë me to virtytet e mira: Mos mblidhni gjëra, të cilat nuk do të mund t'i hani! Mos ndërtoni bina, në të cilat nuk do të banojni! Mos u grindni me të tjerët përgjëra, që nesër do t'i lini pas! Kini frikë prej Allahut, para të Cilit do të tuboheni të gjithë! Përgatituni përvendin ku do të shkoni e do të banoni përgjithmonë!". (Aliel-Muttaki, Kenzu'l-Ummal, hd. nr: 1363.)

Si përfundim, është e padobishme që në frymën e fundit të kuptioni se jeni mashtruar dhe t'i hidhni fajin botës. Nëse njeriu ka shkuar pas të mirave të kësaj

bote dhe është larguar nga besimi e morali i mirë, duhet të fajësojë përkëtë vetëm veten e tij. Sa e hidhur është të shkatërrosh të ardhmen e pafund përdëshirat e pafundme, dashuritë e shkurtra dhe shijet e përkohshme! Duhet menduar mirë, sepse as në këtë botë nuk ka kohë dhe vend ku mund t'i shpëtosh vdekjes, as në varr nuk ka ndonjë mundësi përtu kthyer pas dhe as në ditën e kiametit nuk do të ketë vendstrehim prej tmerrit të asaj dite.

**Allahu i Madhëruar na bëftë prej robërve të Tij të devotshëm, të urtë dhe të zgjuar, të cilët e ruajnë sin-qeritetin përballë sprovave të kësaj bote! Na e bëftë të mundur që të shohim fytyrën e vërtetë të kësaj bote dhe të botës tjetër, ashtu siç ua ka treguar robërve të Tij të devotshëm dhe me bujarinë e mëshirën e Tij, zemrat tona të anojnë për nga bota tjetër!..**

**Amin!**



# Qasje religjioni te shqiptarët, në procesin e globalizimit

*Qani Nesimi*

Globalizimi, si një proces shoqëror, politik, ekonomik, religjioz dhe kulturor, haset në të gjitha periudhat historike të njerëzimit.

Por kuptohet se në çdo periudhë edhe kuptimi i fjalës globalizim, është manifestuar në kallëpe të ndryshme të të kuptuarit. Kështu, këtu mund të përmendim rastin e Kabilit me të vëllanë e tij Habilin, i cili, për të dominuar mendimin dhe dëshirën e tij, dëshiron që edhe Allahu të jetë nën ndikimin e mendimit dhe dëshirës së tij. Si momente të tjera të rëndësishme historike, mund të përmendim tendencën e Aleksandrit të Madh për helenizim të tërësishëm, qëllimin e Perandorisë Romake, Bizantine, Osmane për unifikim kulturor dhe religjioz, tendencën e budistit Chaundagrupta Maurya, tendencat e ndryshme për dominim në Mesdhe, Indi, Azi dhe Persi, siç ishte rasti me Shën Palin. Këtu duhet përmendor edhe tendencia për një globalizim kolonialist portugez, spanjoll, britanik, si dhe udhëtimet e Kristofor Kolombit, Vasko de Gamës etj.<sup>1</sup>

Fjala "Globalizëm" (Globalization), është njëra prej fjalëve më të përdorura që nga vitet 1980 e këndej. Shprehja "Fshati global" (global village) u bë e njohur me botimin e veprës së M. Mc Luhan-it, e titulluar *Understanding Media* (Të kuptuarit e Medias), Routledge, London 1964, ku autorri flet për zvogëlimin e botës, që është rezultat i zhvillimit teknologjik dhe mediatik. Ndërkaq globalizmi, në bazë të kuptimit me të cilin sot përdoret, është një term i ri, edhe pse një pjesë e elementeve në zhvillimin e tij apo një pjesë e fenomeneve që ai simbolizon, janë të vjetra sa edhe vetë historia e njerëzimit. Ky term është i lidhur ngushtë edhe me termat "Universalizëm", "Modernizëm" dhe terma të ngjashëm.<sup>2</sup>

Edhe pse globalizmi është një term, përfshirë tjetë shumë vështirë të jepet një përkufizim i saktë, ("efradini xhami' ag-jarini mani", që të përfshijë të gjitha elementet përbërëse të tij e të përjashtojë të gjitha elementet që nuk i takojnë atij), prapëserapë dijetarët dhe shkencëtarët janë munduar që të jalin përcaktime të ndryshme dhe të bëjnë përshkrime të ndryshme të tij, që, kur të shihet në aspektin e përgjithshëm, globalizmi të paraqesë një proces ekonomik, një kapital, një shër-

1. Josip Simic, Religije I crkve pred izazovom globalizacije, *Filosofka Istrazivanja*, 116 God. 29 (2009), s. 745-761; Globalization and Religion, Conference on Globalization, Conflict& the Experience of Localities, Rome, Italy, 8-29 June 2007 (director programs Ms. Mahjabeen Khaled-Institute of Hazrat Mohammad (SAW)).

2. Mehmet Aydin, "Kuresellesmeye Genel Bir Bakis", *Kuresellesme*, Stamboll: Ufuk Kitaplari 2002, f. 11-12; Aderian Civici, *Globalizimi...Ante portas*,

bim, i cili i tejkalon kufijtë e mundësive teknologjike dhe shkencore dhe është një proces mjaft i përzier, i ngatërruar me batica dhe zbatica, ndonjëherë edhe kontradiktor, rezultatet e të cilët, qofshin ato pozitive apo negative, nuk mund të përkufizohen saktë.

Përveç kësaj, kemi edhe përcaktime tjera, në lidhje me globalizmin. Roland Robertson thotë se globalizëm do të thotë ngshtim i botës dhe rritje e vetëdijes se ajo është një têrësi. Kurse Malcolm Waters shprehet kështu: "Globalizmi është një proces i zhdukjes së kufijve gjeografikë, në rregullimin shoqëror dhe kulturor."<sup>3</sup>

Ndërkaq, profesori Aydin, globalizmit i bën një qasje tredimensionale: dimensioni ekonomik, dimensioni politik e juridik dhe dimensioni kulturor. Në globalizëm, procesi ekonomik është njëri prej proceve kryesore, pasi ky proces sjell me vete edhe një background të zhvilluar informacioni dhe një teknologji të lartë. Po ashtu, procesi ekonomik i globalizmit, që pretendon një ekonomi pa kufij dhe një jetë ekonomike mbinacionale, si përfundim ndikon në têrë jetën shoqërore.

Kurse pretendimet kryesore të atyre që kundërshtojnë globalizmin, sipas Aydinit, janë me sa vijon:

- Globalizmi ndjek një rrugë diktoriale të një lloji kapitali dhe të patronëve, të cilët fitimin e shohin si vlerë kryesore, harxhimin si një ibadet, kurse njerëzit i llogarisin si klientë.

- Bashkë me dobësimin e konceptit të një shteti të përparuar social, globalizmi dobëson edhe ndjenjën e përgjegjësisë sociale.

- Aktorët e globalizmit ekonomik dëshirojnë ta luajnë lojën e tyre aq të madhe, saqë nuk kanë kohë të mendojnë se çfarë do t'i sjellë kjo lojë shoqërisë së gjere njerëzore.

Pretendohet se globalizimi është një proces që nuk mund t'i dilet përpëra dhe që nuk mund të pengohet. Nëse ky pretendim është i vërtetë, atëherë do të thotë se nuk ka zgjidhje tjetër, përvçëse çdonjëri duhet t'i përulet atij sistemi, që do të thotë se njeriu nuk ka të drejtë fjale dhe vetvendosjeje, përndryshe ballafaqohet me shprehjen, "mos kundërshtoni, se ju shkelim".

Ekonomia e globalizuar, shikuar na aspekti religjioz, përgatit një shekullarizëm të dëmshëm për ndjenjën fetare dhe moralin, pasi forca shpirtërore në këtë rast është e bllokuar. Vetëm se nuk duhet harruar që aksionet/veprimet globale, mund të krijojnë edhe plagë të mëdha etike.

Çdo sistem ekonomik parashevë edhe një rregull politik

3. Suleyman Hayri Bolay, "Kuresellesme Ve Milli Kulturler", Kureselle - me, f. 57.

të përshtatshëm për vete. Për shembull, ekonomia e lirë e bën të nevojshme edhe një strukturë politike liberale apo neoliberale. Një kritikë që i bëhet këtij lloj procesi të globalizimit, është në lidhje me dobësimin gradual që i bën ai fuqisë së shtetit nacional/kombëtar. Ndërsa ai thotë se shtetet nationale nuk kanë pse të frikësohen nga globalizmi. Ndërkaq, acarimet që do të lindin në fushën sociale dhe politike, duhen pranuar si normale, sepse kjo gjende është një fazë në historinë e njerëzimit. Si në çdo fazë, ekzistojnë vështirësi, acarime, depresione, demoralizime, shpresa të papëlqyeshme. Kurse globalizmi në vete, nuk është as satanik e as hyjnор.<sup>4</sup>

Dimensioni i tretë është dimensioni kulturor, sipas të cilët shkohet drejt formimit të një "kulture botërore", gjegjësisht të një "kulture globale". Vetëm se këtu nuk globalizohen kulturat botërore, por globalizohen kultura të caktuara, proces, në fund të cilët nuk fitojmë një pluralizëm kulturor, por një hegemonizëm kulturor apo del në shesh një lloj imperializmi kulturor.<sup>5</sup>

Islami si fe origjinale, hyjnore dhe universale nuk njeh "ne" dhe "ata", gjegjësisht qendër-periferi, një vend të vetëm (single place) apo vetëm Lindje ose vetëm Perëndim, siç është rasti me kulturën dominuese në procesin e globalizimit, e cila shprehet se Perëndimi dhe Amerika Veriore janë qendra e botës, kurse të gjitha rajonet e tjera paraqesin periferinë e kësaj fuqie kryesore. Por Islami deklaron: "**Të Allahut janë edhe Lindja edhe Perëndimi; kahdo që të kthehem i atje është ana e Allahut.**" (Bakare, 115) Qendra e kozmologjisë shpirtërore është sistemi i besimit dhe vlerave kolektive, të cilat nuk njohin kurrrafarë kufiri material ose gjeografik.<sup>6</sup> Këtu mund të përmendet rasti i Tarik Ibn Zijadit, kur kaloi në tokat e Spanjës, i cili i dogji anijet, sepse ishte i bindur se nuk ka shkelur në tokë të huaj, por e gjithë toka është e Allahut, falja e Hz. Omerit në shkallët e kishës e jo në brendi të saj e, sidomos me rëndësi është se myslimanët, kudo që kanë shkuar, nuk e kanë shkatërruar kulturën vendase e as e kanë plaçkitur, por e kanë ndihmuar, e kanë rizhvilluar apo ristartuar ose kanë mbjellur atje një traditë të mirë.

Një aspekt tjetër i vëzhgimit me sy kritik të Islamit ndaj globalizmit, është mosdhënia përparësi disa individëve ndaj të tjerëve. Po ashtu, mohon misionin e njeriut të bardhë, popullin e zgjedhur, siç është rasti me popullin gjerman, siç është rasti në Hebraizëm, Krishtërim, në sistemin e

4. Aydin, f. 13-20; M. A. Muqtadir Han, "Glokal' Siyasette Kimlik Insası", Globallesme Bir Aldatmaca Mi?, Stamboll: Inkilab, Mars 2002, f. 94.

5. Aydin, f. 22.

6. Davutoglu, f. 52.

kastave në Hinduizëm etj. Me këtë bie poshtë edhe teoria e globalizimit të ekonomisë, politikës dhe kulturës lokale. Në Kuran thuhet:

*“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise, që të njiheni ndërmjet vete e s’ka dyshim se tek Allahu, më i ndershmi ndër ju është ai që është ruajtur më tepër (nga të këqijat), e Allahu është shumë i dijshëm dhe hollësish i njojur për çdo gjë”.*<sup>7</sup>

### DUALIZMI RELIGJOZ TE SHQIPTARËT, NË PROCESIN E GLOBALIZIMIT

Shqiptarët janë zotërues të dy religjioneve të mëdha universale, Islamit dhe Krishterimit. Të dhënët e shumta të kulturës materiale dhe shpirtërore të popullit shqiptar, dëshmojnë se përkatësia trifetare e shqiptarëve, e bën më të pasur dhe më të përbërë identitetin e tyre kombëtar. Por përkatësia trifetare ka edhe anën e saj negative, e cila e bën të plagosshëm identitetin kombëtar shqiptar, në qoftë se ndonjëra prej këtyre feve do të favorizohej prej institucioneve politike e shtetërore. Një moment tjetër, që ndikon negativisht dhe kontribuon në prishjen e harmonisë fetare dhe kombëtare, është tejshquarja dhe tejtheksimi i ndjenjës fetare. Për këtë arsy, intelektualët e rilindjes shqiptare bënë betejë intelektuale për uljen e vetëdijes së tejshquar në nivelin e vetëdijes së natyrshme fetare. Kundërklerikalizmi i rilindasve nuk përmban qëndrim kundërfetar ose afetar, pasi numri më i madh i tyre ishin fetarë dhe besimtarë, pa marrë parasysh nivelin e koncentrimit të tyre fetar. Në fakt, kundërshtimi i tyre ishte i koncentruar kundër një vetëdijeje të tejshquar fetare, që pengonte zhvillimin dhe konsolidimin e vetëdijes kombëtare, që ushtronte ndikim çintegruesh në procesin e integrimit kombëtar dhe të njësisë shpirtërore të popullit shqiptar. As edhe mendimi i Vaso Pashës, *“Feja e shqiptarit është shqiptaria”*, nuk duhet kuptuar si një mendim kundërfetar ose afetar, por duhet kuptuar brenda kornizave kohore dhe kuptimore të kohës kur ai ka jetuar, por gjithmonë duke pasur parasysh edhe pyetjen së cilës i është referuar kjo thënie.<sup>8</sup>

**Thënia e njojur e Pashko Vasës “Feja e shayptarit asht**

7. Kur'an, Huxhurat, 13.

8. Akademik Rexhep Qosja, *Ideologjia e shpërbërjes, trajtesë mbi idetë çintegruuese në shoqërinë e sotme shqiptare*, Toena, Tiranë, 2006, fq.23-28.

*Shqyptaria”, duke marrë parasysh rrethanat politike dhe ekspansioniste që dominonin në atë kohë në Gadhullin Ballkanik, nuk shpreh një antifetarizëm apodnonjë pabesi. Por, që këtu dëshirohet të shprehet ajo ndjenja e mospërçarjes dhe e moskacafytjes, vërehet në rreshtat paraprakë të autorit. Kështu që, autori para se të vijë deri te shprehja “fe e shqyptarit asht Shqyp-taria”, ai përmend si më poshtë: “...Shqyptarë! Me vllazën jeni tue u vra/dhe më njëqind çeta jeni shpërndarë...”, “...vjen njeri i huej, ju rri në votër/me ju turpnue, me grue, me motër; dhe për sa pare që do të fitoni/besën e t’parëve t’gjithë e harroni...”, “...T’desim si burrat që diqne motit/e t’mos marohna përparrë Zotit”<sup>9</sup>.*

**Në lidhje me këto vargje të Vasës, Krasniqi thotë: “Së këndejmi, vargjet e Vaso Pashë Shkodranit”** *“Feja e shqiptarit asht shqiptaria”, nuk janë shprehje e patriotizmit romantik të shek. XIX, por konstatim i së vërtetës, dëshmi e vetëdijes së lartë kombëtare. Këto vargje, shumëkush i keqkupton si shprehje e mendimit ateist, antifetar. Poeti ynë ka qenë besimtar katolik dhe patriot, ai nuk ishte kundër fesë, por ishte i mendimit se për shqiptarët, sikur se edhe te popujt e tjerë, mbi të gjitha duhet të jetë interes i kombëtar, duhet ta duam kombin me një dashuri të ngritur në shkallën e dashurisë ndaj religjionit dhe feja të mos jetë element ndasie, në asnjë mënyrë, në mes të shqiptarëve por kushti i vetëm për ekzistencë kombëtare shqiptare”*<sup>10</sup>

**Ideologjia komuniste, gjegjësisht ajo enveriste, e bazuar në parimin antifetar, sipas Feraj, jo që ndaloj çdo gjë që ishte fetare, por ajo edhe idetë nacionaliste dhe ato që janë shprehur për të mbajtur të gjallë ndjenjën e fortë dhe historike tolerante shqiptare, është munduar t’i shprehë si ateiste dhe antifetare, në lidhje me shprehjen e Pashko Vasës “Feja e shqiptarit është shqiptaria”, thotë se nga kjo shprehje nuk del ateizmi i Enver Hoxhës. Së pari, thotë Feraj, në vjershën e Vasës shprehet kërkesa për të vendosur identitetin kombëtar mbi atë fetar. Kjo kërkësë gjendet te nationalistët e shumicës së popujve të tjerë dhe nuk është diçka e për-**



9. Pashko Vasa, *Vepra Letrare 1*, botoi “Naim Frashëri”, Tiranë 1987, fq. 37-39.

10. Akademik Mark Krasniqi, *Toleranca fetare mes myslimanëve dhe katolikëve në Kosovë, Feja, kultura dhe tradita islamë ndër shqiptarët, simpozium ndërkombëtar në Prishtinë-15, 16, 17 Tetor, 1992*, botoi Kryesia e Bashkësisë islamë të Kosovës, Prishtinë 1995, fq. 206.

**veçme shqiptare. Megjithatë, nga kërkesa për hierarki të identiteteve, për të vendosur identitetin kombëtar mbi atë fetar, logjikisht nuk del ateizmi. Së dyti, në vargjet e Vasës shprehet kërkesa e përbashkët e të gjithë nacionalizmit shqiptar në një mjedis shumëfesh. Mirëpo, as nga kërkesa për tolerancë nuk del ateizmi.<sup>11</sup> Ndërkaq, Gazmend Shpuza, në lidhje me vjershën e lartpërmendur të Vasos, shprehet se kjo vjershë nuk ka një përmbajtje kundër fesë dhe se nuk është as kundër ceremonive fetare e as kundër besimit.<sup>12</sup>**

Kështu që, procesi i globalizimit, duke ju dhënë mundësi shumë elementeve pozitivë, në të njëjtën kohë u dha mundësi edhe shumë gjérave dhe elementeve të këqija, të zënë vendin e tyre në këtë proces. Kështu që, sot në botën shqiptare, sipas Qoses, globalizimi i ka dhënë mundësi një fenomeni, që në fund nuk mund të jetë kurrë pozitiv për edhe vetë ata që merren me të. Ky fenomen quhet tejshquarje e vetëdijes fetare. Tejshquarja e vetëdijes fetare bëhet sot te shqiptarët në mënyra të ndryshme, por vetëm tejshquarja e vetëdijes fetare katolike po favorizohet edhe prej disa vëtëve dhe disa institucioneve politike dhe shtetërore vendore në Kosovë dhe në Shqipëri, natyrisht nën ndikimin e disa institucioneve fetare e shtetërore të huaja e sidomos, të disa mediave të huaja, të cilat për Ballkanin vazhdojnë të shkruajnë si për një "paradhomë e Orientit barbar" dhe si "kategori më e ulët e qytetërimit". Kurse ajo që e bën më të rënduar këtë situatë, është pjesëmarrja në këtë tejshquarje të vetëdijes fetare, e disa intelektualëve dhe krijuesve të fushave të ndryshme artistike e shkençore e sidomos, intelektualë që merren me shkrimin e romaneve në gjuhën shqipe.<sup>13</sup>

Në disa qarqe intelektuale, pretendohet të mbulohet edhe fakti që në identitetin shqiptar faktor i rëndësishëm dhe kryesor është kultura dhe qytetërimi islamik. Gjithashtu mohimi i prezencës dhe i rëndësise së kulturës dhe qytetërimit islamik në formësimin e identitetit shqiptar, mundohet të bëhet edhe nëpërmjet argumentit se feja islame e numrit më të madh të shqiptarëve, është pëngesë e integrimit të shqiptarëve, gjegjësisht të Shqipërisë dhe të Kosovës, në Bashkimin Evropian. Ideja se, po që se shqiptarët do t'i takonin vetëm qytetërimit perëndimore, nuk do të ishin të ndarë në disa shtete dhe sot do

të ishin në familjen e madhe evropiane, është vetëm një supozim. Këtë realitet, në të cilin gjenden sot shqiptarët në Gashullin Ballkanik, e kanë krijuar shumë rrëthana politike, ekonomike, shumë interesa individuale dhe grupore brenda historisë në Ballkan dhe më gjerë. Këtu mund të rikujtojmë regjimin komunist të Enver Hoxhës. Një gjë të tillë e vërteton edhe gjendja e periudhës pas shembjes së ideologjisë lindore komuniste dhe paraqitjes së pluralizmit politik e kulturor në Ballkan. Si shembull mund të përmendim ndërhyrjen e fuqive botërore (NATO) në Bosnjë, Hercegovinë dhe në Kosovë, nënshkrimin e marrëveshjes për anëtarësim në BE të Turqisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Shqipërisë, Maqedonisë etj. Pra, të thuash sot se identiteti shpirtëror i shqiptarëve është identitet i krishterë, do të thotë të bëhen propagandist fetar a politik fetar, që nuk e thotë të vërtetët dhe nuk i kontribuon bashkëjetësës së harmonishme të tri feve në jetën e shqiptarëve.

Në shtresën intelektuale shqiptare ekzistonë dy pole të të menduarit për identitetin religjioz të tyre.

Në njërin pol qëndrojnë ata që mendojnë se shqiptarët duhet të kthehen në origjinën e tyre religjioze, gjegjësisht në rrënjet e krishtërimit, më konkretisht në rrënjet e katolicizmit. Të këtij mendimi janë Ismail Kadare, Aurel Plasari, Piro Misha etj. Ndërkaq, në polin tjetër qëndrojnë ata që mendojnë se në identitetin religjioz të shqiptarëve bëjnë pjesë edhe krishtërimi edhe islam. Në këtë mendim marrin pjesë Rexhep Qosja, Muhamedin Kullashi, Shkëlzen Malqi etj. Vëtëm se, në këtë grup të fundit nuk duhet menduar se këta janë mbrojtës të Islamit dhe janë kundërshtarë të Krishtërimit. Këta janë personalitete që bëjnë analizën e gjendjes aktuale shqiptare, sa i takon identitetit shqiptar. Kurse, të qenët simpatizant i njërit religjion, është diçka krejt tjetër.

Kështu që, miti i tolerancës fetare midis këtyre komuniteteve, nuk mjafton për të siguruar vazhdimesinë e harmonisë midis komuniteteve fetare në terma afatgjata. Së pari, sipas Fatos Lubonjës<sup>14</sup>, gjatë periudhës komuniste nuk u zhvillua kultura e tolerancës, por kultura e intolerancës. Feja nacional-komuniste e Hoxhës i shtypi fetë e tjera, nuk i toleroi dhe nuk krijoj kulturën e vërtetë laike të bashkëjetësës dhe të respektit të ndryshimeve, por shqiptarizmin e interperatoi si një identitet monolitik dhe përjashtues identitetesh të tjera. Thënia "feja e shqiptarit është shqiptria", filloj të zëvendësohej me mitin e tolerancës fetare, i cili, në fakt, ishte më shumë një konstrukt ndrydhës që nuk kishte frymë laike, por laiciste. Ky lloj laicizmi (integrim monist), i

11. Husamedin Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, Logos-A, Shkup, 1999, fq. 280.

12. Gazmend Shpuza, Millet Sistemi Çerçevesinde Arnavutların D - rumu, *Osmanlı IV*, ed. Güler Eren, Yeni Türkiye Yayınları, Ankara 1999, fq. 294-297.

13. Qosja, f.29.

14. Fatos Lubonja, Feja dhe shqiptaria në ditët e sotme, *Përpjekja*, 18 maj 2008, Tiranë.

mbuluar me mitin e tolerancës fetare, sot rezulton i dobët për t'u imponuar identiteve të tjera.

Eqrem bej Vlora tregon për një mënyrë tjetër të identifikimit të shqiptarëve. Sipas tij, shqiptarët kudo që ishin, ndaheshin në dy grupe. Në grupin e parë bënин pjesë ata që thoshnini "tyrk elhamdulil-lah" (turk, i qofshim falë Zotit) dhe "gjaurë" (shqiptarët ortodoksë dhe katolikë). Në këtë rast, shprehja "tyrk elhamdulil-lah", nuk duhet marrë në kuptimin e ngushtë të saj, pra nuk duhet konsideruar si përkatësi etnike. Pra, me këtë shprehje nuk dëshirohej që shqiptarët të bëhen apo të deklarohen turq, por kjo ishte një shprehje që dëshironë ta minimizonte përkatësinë fetare islame të shqiptarëve, e cila ishte e përhapur nga politika antishqiptare dhe antiosmane, që udhëhiqej nga priftër dhe politikanë të besimit ortodoks, gjegjësisht të atij grek. Kështu që, në atë kohë (shek. XIX dhe XX) bëhej një përpjekje për automatizëm në të qenit mysliman dhe të qenit turk, që aspak nuk është e vërtetë. Shprehjen "tyrk elhamdulil-lah", popullata shqiptare nuk e ka përdorur për të treguar se është popullatë turke, por se është popullatë myslimane. Edhe në ditët e sotme ka shqiptarë, ndoshta pak më të moshuar, që, po t'i pyesësh për besimin e tyre, do të thonë "jam tyrk elhamdulil-lah", por që flet, shkruan, komunikon shqip dhe për të flijon çdo gjë. Ndërsa shprehja "turkoalvanoi", e përdorur nga politika ortodokse greke, që është një paradoks në vete, mbetet një prej metodave, nëpërmjet të cilave politika antishqiptare mundohet t'ia arrijë qëllimit. Eqrem beu vazhdon duke thënë: "Në historinë dhe letërsinë e popujve ballkanikë, motivi i përndjekjes dhe i mizorive të shqiptarëve myslimanë kundrejt të krishterëve ishte vizatuar me qindra ngjyra, ishte pëershkuar, vajtuar dhe kënduar në qindra mënyra. Një propagandë e pandërprerë gjatë gjithë qindjeçarit, kishte kultivuar te popujt e Ballkanit një urrejtje të thellë për turqit dhe shqiptarët, urrejtje që u materializua në krimet më të përbindshme gjatë dhe pas Luftës së Parë Botërore. Nuk kam për qëllim këtu t'i shfajësoj as turqit, as shqiptarët, por për hir të së vërtetës, dua të theksoj këtë fakt: në këto 4-5 vjet grekët, serbët, malazezët, po edhe bullgarët, ua lanë shumëfish shqiptarëve atë që ata mund t'ua kishin bërë atyre gjatë 4 o 5 shekujsh".<sup>15</sup>

Nuk ka identitet shoqëror, për të cilin do të mund të thoshnim se është identitet burimor dhe krejtësisht autentik. Çdo identitet është një ndërtim historik dhe shoqëror. Sidomos, nuk ka identitet shoqëror të thjeshtë, të njëtrajtshëm dhe të pandërmjetëm. Të gjitha identitetet,

edhe ato të individëve, janë identitetë të strukturuara dhe komplekse. Përjashtim prej kësaj bëjnë vetëm grupet shqërore më primitive, të shkallës së zhvillimit fisnor, në rastet kur jeta e tyre zhvillohet në izolim të plotë, pa kontakte dhe ndërveprime me grupet dhe shoqëritë e tjera. Deri vonë, grupe të tillë kanë ekzistuar në xhunglat e Afrikës dhe të Amerikës Jugore.

Në studimin e Anthony D. Smith "Identiteti kombëtar" (National Identity, London 1991), veçohen 6 atribute kryesore të një bashkësie kombëtare ose kombi dhe këto janë: 1. Emri kolektiv i përbashkët; 2. Miti mbi prejardhjen e përbashkët; 3. Kujtesa e përbashkët historike; 4. Një ose më shumë elemente diferencuese të kulturës së përbashkët; 5. Lidhja me një atdhe (ose mëmëdhë) të caktuar; dhe 6. Ndjenja e solidaritetit dhe përbashkësisë të një pjesë e rendësishme e popullsisë. Kombi shqiptar, edhe pse me një histori të gjatë kacafytjesh-zénkash dhe i ndarë në disa pjesë gjatë shekullit XX, i "përbush" të gjitha atributet nga lista e parafrazuar e A. Smithit. Disa nga këto atribute, në rastin e kombit shqiptar do të mund të kërkonin nuanca riformimesh referuese ndaj realitetit në të cilin ata jetojnë, si kombi i ndarë, por këto nuanca nuk janë të karakterit cënuas për identitetin e përbashkët. Historikisht e as në momentin aktual, prejse është krijuar vetëdija mbi identitetin kombëtar, ndër shqiptarët nuk ka pasur asnjë lëvizje që do të tematizonte edhe intencën për ndonjë identitet të veçantë.

Shqiptarët, çuditërisht, kanë krijuar njërin prej identiteteve kombëtare më komplekse në rajon e mbase edhe në planet. Trojet shqiptare, të thyera prej maleve dhe luginave në disa dhjetëra rajone, ku komunikimi mes tyre ka qenë mjaft i vëshit, përkundër pushtimeve, ndarjeve dhe rrudhjeve të tyre, kanë mbetur deri më sot troje me popullsi kompakte shqiptare. Në trojet ku jetojnë, pa marrë parasysh shtetin dhe statusin e tyre, shqiptarët janë shumicë. Janë shumicë dërmuese në Kosovë, në pjesën e Maqedonisë ku jetojnë, në Luginën e Preshevës, në brezin kufitar të Malit të Zi me Shqipërinë. Shqiptarët nuk kanë zaptuar toka të huaja, por tokat e tyre janë zaptuar nga shtetet fqinje. Shqipëria etnike, vetëm politikisht dhe gjeostrategjikisht paraqitet si një fantazmë dhe ëndërr e parealizueshme, ndërkaq që ajo është një realitet i pamohueshëm i rajonit. Çudia tjetër edhe më e madhe e identitetit të përbërë shqiptar, është ajo e tolerancës fetare të shkallës së lartë. Shqiptarët kanë në korpusin e identitetit të vet të gjitha mesimet e mëdha evropiane. Dinamiti i tri feve, i ndezur me fitilat e zgjatur të nacionalizmave serbë dhe kroatë, që shkatërrroi e ndau Bosnjën në tri kombe dhe tri entitete shtetërore,

*Roli i islamit argumentohet gjëresisht se ka qenë pozitiv në ndërtimin e identitetit shqiptar. Kjo ide është pjesërisht e ndezur nga disa akademikë dhe historianë, të cilët e mbrojnë këtë tezë, duke thënë që arsyaja prapa konvertimit tonë në islam, ishte për të dalluar etnicitetin tonë nga ai i serbëve dhe grekëve.*

15. Eqrem bej Vlora, KUJTIME 1885-1925, Tiranë, fq. 152, 335-336.

në rastin e shqiptarëve ka dhënë një rezultat të kundërt, duke dëshmuar mundësinë e krijimit të identitetit unik kombëtar, përkundër pranisë së shumë feve dhe kishave ndër shqiptarët.

Edhe pse qenia dhe identiteti i shqiptarëve në asnjë aspekt nuk vihet më në dyshim, kjo nuk do të thotë se ata nuk kanë ose nuk do të kenë sfida të ndryshme, që dalin nga mobiliteti marramendës i shoqërisë (ose më saktë, shoqërvive) shqiptare në tranzicion. Trandjet e thella, që aktualisht kapërcejnë shqiptarët në jetën politike, ekonomike dhe kulturore, nuk mund të kalojnë pa pasoja ose të paktën, pa një ripërcaktim serioz të identitetit të tyre. Në aspektin e tyre pozitiv, proceset aktuale do të duhej të çonin drejt rindërtimit të shtetit dhe institucioneve mbi themelët më të shëndosha dhe më të qëndrueshme seç kanë qenë ato të shekullit XX. Pas kolapsit të institucioneve të ndërtuara nga miksimi i ideologjive komuniste dhe nacionaliste, tani duhet të instalohen ligjet dhe institucionet e reja, të bazuara mbi të drejtën e individit dhe mbi parimet liberale.<sup>16</sup>

Baza e identitetit shqiptar është, sigurisht dhe kryesisht gjuha shqipe. Gjuha është gjëja e vetme, krahas historisë së përbashkët, e cila i bashkon të gjithë shqiptarët. Me të vërtetë, ka shumë perspektiva konfliktuale rrëth identitetin "zyrtar" shqiptar, bazuar mbi projekte dhe axhenda sektariane. Megjithatë, shqiptarët më të zgjuar janë ata të cilët e zgjerojnë konceptin e përfshirjes, përsa i përket identitetit shqiptar. Si një komb, Shqipëria është një shembull i diversitetit në bashkim.

Shqipëria strehon njerëz të traditave fetare të ndryshme, por gjithashtu komunitete dhe minoritete etnike, të cilat konsiderohen shqiptare. Marrëdhënia midis identitetit shqiptar dhe kulturës islame është e një natyre jashtë-zakonisht të rëndësishme dhe të veçantë. Fjala e cila e pëershruan fjälën "nation" në shqip, është fjala "komb". Fjala "komb" origjinon nga fjala arabe "kaum", e cila ka ardhur në kulturën shqiptare përmes gjuhës osmane. Kështu, pëta përkufizuar vetë nacionin e kombit shqiptar, themeluesit e nacionalizmit shqiptar zgjodhën pikërisht këtë fjalë arabe. Çështja e marrëdhënieve midis kulturës islame dhe identitetit shqiptar, është shumë e prezantuar në këtë shembull simbolik.<sup>17</sup>

Roli i islamit argumentohet gjerësisht se ka qenë pozitiv në ndërtimin e identitetit shqiptar. Kjo ide është pjesërisht e ndezur nga disa akademikë dhe historianë, të cilët e mbrojnë këtë tezë, duke thënë që arsyja prapa konvertimit tonë në islam, ishte për të dalluar etnicitetin tonë nga ai i serbëve dhe grekëve. Kjo pikëpamje i ka bërë shumë shqiptarë të mendojnë se arsyja kryesore e konvertimit në islam ka qenë "për të shpëtuar" identitetin kombëtar.<sup>18</sup>

16. Shkelzen Maliqi, Autori është filozof dhe publicist, kurse artikulli është marrë nga gazeta javore "Java", që botohet në Prishtinë.

17. Ervin Hatipi, Identiteti shqiptar, *Forumi.kurandhesunet.net* (20. 11. 2011).

18. Shih, Sami Frashëri, *Kush e prish pagën në Ballkan*; Roberto M - rocco Dela Roka, *Feja dhe kombësia në Shqipëri 1922-1942*, Elena Gjika,

Elitat shqiptare, të vetëdijshme për dobësinë e ekzistencës së shtetit shqiptar përballë fuqive ideologjike dhe ushtarake të kombeve përreth, u përpqoën të legjitimoni ekzistencën e shtetit të tyre, duke ndërmarrë një seri reformash radikale, në mënyrë që të zbusnin dhe të zbehnin traditat osmane dhe islame, duke u përpjekur kështu "të perëndimizonin" karakteristikat e shoqërisë shqiptare. Çështja, pastaj, ishte se si të bëheshe më pak mysliman. Kështu, dolën në pah politikat e fshehjes së identitetit mysliman, duke fshirë ose zbehur të gjitha karakteristikat e dukshme islame dhe osmane të kulturës shqiptare. Të gjitha shenjat e dukshme të së kaluarës osmane filluan të zhdukeshin, duke filluar me arkitekturën madhështore të ndërtimeve urbane, pazareve dhe serialjot. Shkatërrimi i tyre kishte për qëllim të tregonte që Shqipëria e kishte marrë shumë seriozisht rrugën e modernizmi, siç kuptohej prej revolucionit socialist. Secila nga shenjat e dukshme të së kaluarës orientale, u bënë një shenjëstër për propagandën e përditshme dhe subjekt i ligjeve shtypëse të diktaturës komuniste. Kjo luftë e deklaruar, së pari kundër traditës dhe më vonë kundër fesë, myslimanë dhe të krishterë, u bë një markë shqiptare.

Krishtërimi, qoftë ai Ortodoks ose Katolik, shihen si një etiketim europian i modes, e cila e tejkalon laicizmin, megjithëse perceptohet si diçka shumë natyrale. Kemi shembujt e politikanëve shqiptarë, të cilët marrin pjesë hapur në meshën e së dielës, ndjekin ritualet e krishtera, martohen në kisha dhe marrin pjesë në ceremoni fetare. Kjo, sipas tyre, është krejt natyrale dhe sipas rregullave shqiptare. Në kontrast, është e padëgjuar dhe e paparë që një politikan shqiptar mysliman të marrë pjesë për falje ose madje edhe të tregojë publikisht përkatësinë më të vogël në besimin islam. Për më tepër, në parlament ne shohim parti politike të krishtera, ndërsa vetëm ideja e krijimit të një partie nominale myslimanë do të krijonte diçka të njëjtë me një tërmet të një madhësie të madhe. Gjithashtu, librat shkollorë përbajnjë interpretime fondamentaliste të krishtera dhe u shërbejnë atyre si fakte ndaj fëmijëve. Si përgjigje, elitat e frikësuara shqiptare, duke përfshirë edhe ato fetare, filluan të kufizonin numrin e xhamive, vetëm duke i mbyllur. Burokratët i ndalën faljet e tyre publike dhe pjesëmarrjen në ceremonitë fetare islame. Mendonin që po tregonin shenja serioze të çislamizimit dhe çosmanizimit të shqiptarëve.<sup>19</sup>

Sipas mendimit tim, ne shqiptarët, në Bashkimin Evropian mund të futemi, vetëm duke e treguar realitetin aktual religjioz shqiptar. As fjälët e as mendimet për largim nga feja islame ose për kthim në krishtërim e as fshehja e realitetit religjioz shqiptar, nuk do ta përspejtojë procedurën për integrim. Ata që mendojnë se lënia apo braktisja e islamit është kusht për integrimin tonë në Bashkimin Evropian, nuk bëjnë gjë tjetër, vetëm se tregojnë ndjenjën e tyre subjektive dhe fshehin realitetin shqiptar.

Tiranë, 1996.

19. Ervin Hatipi, Identiteti shqiptar, *Forumi.kurandhesunet.net* (20. 11. 2011).

# *Hyrja në Baqe*

*M. Sami Ramazanoglu*

Allahu Teala thotë:

**"Ka ndonjë njeri (hipokrit), fjalët e të cilit në jetën e kë-saj bote të kënaqin dhe të betohet në Allahun për atë që mban në zemër, por që, në të vërtetë, është kundërshtari (yt) më i betuar."**

**"E, kur largohet, përpinqet të bëjë të këqija në tokë, duke shkatërruar të mbjellat dhe bagëtinë, por Allahu nuk e do shkatërrimin."**

**"Kur atij i thuhet "Ki frikë Allahun!", ai mburret dhe bën më shumë të këqija. Atij i mjaftron xhehenemi. Sa vendbanim i keq është ai!"**

**"Ka njerëz që e fllojnë veten, për të fituar kënaqësinë e Allahut. Allahu është shumë i mëshirshëm me robërit e tij."**

**"O ju që keni besuar! Pranojeni Islamin me të gjitha rregullat e tij dhe mos shkonit gjurmëve të djallit, sepse ai është armiku juaj i përbetuar."**

**"Nëse i shmangeni së drejtës, pasi ju kanë ardhur prova të qarta, atëherë dijeni se Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë."**

**"Ç'presin tjetër ata? Që t'u vijë Allahu përmes hijeve të reve bashkë me engjëjt?! Atëherë merr fund puna! Tek Allahu kthehen të gjitha punët."** (el-Bakara, 204-210.)

Ibn Mes'udi, radijallahu anh, ka thënë, se mëkati më i madh te Allahu është që, kur robit t'i thuhet "Ki frikë Allahun!", ai të thotë "Ti, shiko punën tënde!"

Kur Hazreti Umerit, radijallahu anh, i thanë: "Ki frikë Allahun", ai e vuri faqen në tokë duke iu nënshtruar dhe duke iu bindur Allahut.

Ajeti fisnik i cili kaloi më sipër:

**"Ka njerëz që e fllojnë veten, për të fituar kënaqësinë e Allahut. Allahu është shumë i mëshirshëm me robërit e tij."**, transmetohet se ka zbritur për Suhejb er-Rumin, radijallahu anh.

Besimtarët ia dorëzojnë me dëshirë veten e tyre Allahut. Vlera e vetes së besimtarëve është xheneti. Edhe miqtë e Allahut (evljaullah) ia dorëzojnë veten Allahut me dëshirë, por vlera e vetes së atyre është kënaqësia e Allahut Teala.

Në mënyrë që robi t'ia nënshtrojë plotësisht veten Allahut, xhelle xhelaluh, duhet që këtë obligim ta vendosë në plan të parë. Domethënë, duhet t'i japë përparësi më shumë se pasurisë, fëmijëve dhe vetes së tij. Për këtë arsye, njeriu i mençur duhet ta përmendë shumë Allahun e Lartmadhëruar.

Sepse dhikri, siç pastron botën e brendshme të njeriut, po ashtu ndriçon edhe zemrën. Allahu i Madhëruar thotë:

**"Përmendeni shumë Allahun, që të shpëtoni dhe të fitoni."** (el-Enfal, 45.)

"A ka shpëtim më të madh se fakti që robi të arrijë kë-naqësinë e Allahut?

Allahu Teala thotë:

**"O ju që keni besuar! Pranojeni Islamin me të gjitha rregullat e tij dhe mos shkonit gjurmëve të djallit, sepse ai është armiku juaj i përbetuar."** (el-Bakara, 208.). Domethënë, nënshtrojuni Allahut dhe bindjuni Atij fshehtazi e haptazi.

Transmetohet se Abdullah bin Selami dhe shokët e tij, vazhdonin t'u besonin disa gjëra prej ligjeve të Teuratit si, respekti ndaj ditës së shtunë, pranimi se mishi dhe qumështi i devesë është haram etj. dhe pandehnin se, sipas Islamit, është mubah të heqësh dorë prej këtyre. Ata vazhduan me këtë besim dhe thanë:


"O i Dërguari i Allahut! Edhe Teurati është libër i Allahut. Na lejo që natën të lexojmë prej tij në namaz." I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, u tha:

**"Lëreni çdo gjë prej atyre që janë anulluar! Lërinë edhe gjërat për të cilat keni rënë në dakord me njëri-tjetrin! Lënien e këtyre mos e konsideroni si diçka të habitshme, sepse në të qëndruarit bashkë me Allahun nuk ka ndonjë gjë të habitshme. Kjo është vetëm diçka që ju ka zbukuruar djalli. Mos i ndiqni gjurmët e shejtanit, sepse ai është armiku juaj i përbetuar."**

Në fjalën e Allahut: **"O ju që keni besuar! Pranojeni Islamin me të gjitha rregullat e tij"**, ka një kuptim të përgjithshëm duhet që fakti se ky urdhër përfshin të gjithë ata që kanë besuar. Domethënë, o besimtarë! Pranojini të gjitha kushtet e jashtme dhe të brendshme të Islamit! Kushtet e Islamit janë ato që ka thënë i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem:

**"Mysliman është ai njeri, prej dorës dhe gjuhës së të cilit nuk kanë dëm myslimanët e tjerë. Ndërsa besimtar është ai që fiton besimin e njerëzve."**

Ndërsa kuptimi i veçantë është fakti se ky urdhër i drejtuhet personalitetit të njeriut dhe të gjitha organeve të jashtme dhe brendshme të trupit. Njeriu duhet të hyjë në Islam me të gjithë organet e tij. Ai duhet t'i nënshtrohet urdhrit të Allahut dhe duhet të largohet nga ndalesat, kur syri të shikojë, kur veshi të dëgjojë, kur goja të hajë, kur dora të prekë dhe kur këmba të ecë. Madje duhet të lërë çdo gjë që nuk ka dobi për të.



A. Jasim Demirxhi

## Atë do Allahu Teala?

- ﴿ Nëse të ka udhëzuar, dije se Allahu Teala të do.
- ﴿ Nëse të ka dhënë risk të pakët, dije se Allahu Teala të do. Kjo do të thotë se në botën tjetër do të t'japë me bollëk.
- ﴿ Nëse je i kënaqur (me atë që ke), dije se Allahu të do. Kjo do të thotë se Ai të ka furnizuar me mirësinë më të bukur.
- ﴿ Nëse të ka dhënë durim, dije se Allahu Teala të do. Kjo do të thotë se je prej atyre që kanë fituar.
- ﴿ Nëse të ka dhënë singjeritet, dije se Allahu Teala të do. Pra ji i singertë ndaj Tij.
- ﴿ Nëse të ka dhënë halle dhe hidhërimë, dije se Allahu Teala të do. Kjo do të thotë se Ai po sprovon besimin tënd.
- ﴿ Nëse të ka dhënë pasuri, dije se Allahu Teala të do. Kjo do të thotë se prej teje pret falënderim dhe mirënjohje.
- ﴿ Nëse të ka dhënë varfëri, dije se Allahu Teala të do. Kjo do të thotë se të ka dhënë diçka më të vlefshme se pasuria.
- ﴿ Nëse të ka dhënë vetëdije adhurimi si, leximin e Kur'anit, faljen e namazit, kryerjen e agjërimit etj., dije se Allahu Teala të do. Kurrë mos e humb këtë vetëdije dhe mos e neglizho.
- ﴿ Shkurtimisht, Allahu Teala i do shumë robërit e Tij dhe kurrë nuk i harron.

# Dy fjalëtë fshehta, që sjellin të gjitha mirësitë

Dy fjalë që sjellin shiun dhe largojnë varfërinë:

Estagfirullah...

Një njeri shkoi tek Hasan Basriu dhe iu ankua për thatësirën. Hasan Basriu i thotë:

- Kérko falje prej Allahut duke thënë Estagfirullah!

Pa kaluar shumë, vjen dikush që iu ankua për varfërinë. Hasan Basriu i thotë edhe atij të njëjtën gjë:

- Kérko falje prej Allahut, duke thënë Estagfirullah!

Më vonë vjen një tjetër i cili donte të kishte fëmijë. Edhe atij i thotë të njëjtën gjë:

- Kérko falje prej Allahut, duke thënë Estagfirullah!

Edhe një personi tjetër, i cili iu ankua për prodhimin e pakët që merrte, i thotë njëjtën gjë:

- Kérko falje prej Allahut, duke thënë Estagfirullah!

Ata që ndodheshin aty, e pyetën Hasan Basriun për urtësinë e këtyre fjalëve. Hasan Basriu iu përgjigj me Kur'an:

**"U thashë: "Kérkon falje nga Zoti juaj, i Cili është Falës i madh, që Ai t'ju dërgojë shi të bollshëm, t'ju shtojej pasurinë dhe fëmijët tuaj dhe të bëjë për ju kopshët e lumenj!" (Nuh, 10-12.)**

- Dëshiron një jetë të bukur siç të dojë zemra? Kérko falje prej Allahut:

**"(Ju porosis) Të kérkon falje nga Zoti juaj e të ktheheni tek Ai me pendesë. Ai do t'ju japë të shijoni kënaqësi të bukura deri në afatin e caktuar..." (Hud, 3.)**

- Dëshiron të ruhesh prej fatkeqësive dhe dënimit të Allahut? Kérko falje prej Tij:

**"Por Allahu nuk do t'i ndëshkonte ata, përderisa ti ishe në mesin e tyre dhe, Allahu nuk do t'i ndëshkojë ata, përderisa ata i kérkojnë falje Atij." (el-Enfal, 33.)**

- Dëshiron të të falen gabimet, të të shtohen sevapet dhe të të ngrihen gradat? Kérko falje prej Allahut:

**"...përuluni në sexhde dhe thoni: "Falna!", që Ne t'ju falim gabimet. Atyre që bëjnë vepra të mira, Ne ua shtojmë shpërbilimin" (el-Bekare, 58.)**

O Zoti

Zhduki shqetësimet  
dhe hidhërimet e mia!

Largoji shqetësimet e zemrës sime!

M'i lehtëso punët!

Bëmë të jetoj në fenë  
Tënde!

Ma lehtëso çdo gjë që  
më duket e vështirë!

M'i realizo  
dëshirat e mia!

Më bëj të  
qëndrueshëm në  
devotshmëri gjatë  
gjithë jetës sime, në  
fshehtësi apo vend të  
hapur qofsha!

أَرْزَلْ عَنِ الْهُمَّةِ وَكُلَّ غَمٍ  
وَفَرَّجْ كَرْبَةَ الْقَلْبِ الشَّجَرِيِّ  
وَيُسْرُ مَا تَعَسَّرَ مِنْ أَمْوَارِي  
وَثَبَّتْنِي عَلَى الدِّينِ السُّوَّيِّ  
وَسَهَّلْ كُلَّ صَعْبَ لِيْ، وَحَقَّ  
مُرَادِي فِي الصَّبَاحِ وَفِي الْعَشِيِّ  
وَثَبَّتْنِي عَلَى التَّقْوَى جَهَارًا  
وَسِرَّا .. طُولَ عُمْرِي .. يَا وَلِيِّي

إِلَهُ



# Rëndësia e përkujtimit të ditëlindjes së Muhamedit (a.s.)

Bashkim Bajraktari

-Më 12 Rabijul Evel të çdo viti, myslimanët në çdo anë të botës përkujtojnë, siç përkujtojmë edhe ne, ditëlindjen e Muhamedit (a.s.)

-Në këtë përkujtim, nëpërmjet leximit të Kuranit, salavateve mbi Profetin (a.s.), ligjëratave, ilahive, vargjeve të Mevludit, ne ripërtërijmë shpirrat, zemrat dhe mendjet tona, pasi ajetet e Kuranit, salavatet, ligjératat apo vargjet e Mevludit, përcjellin tek ne mesazhet islame të njësimit të Zotit, fuqisë, mëshirës dhe cilësive të Tij, si dhe na jepin vlerat morale, njerëzore e shpirtërore dhe modelin e Profetit (a.s.), i cili ka qenë dhe do të jetë shembulli më i përkryer njerëzor profetik.

Sa bukur shprehet autor i Mevludit në hyrje të tij, duke thënë: "Bismil-lahi emnin e Zotit ta thomë./Borxh e kemi n'gjitha punët kur t'i fillojmë", vargje të cilat janë shprehte e urdhrit profetik, që çdo punë duhet të fillohet me Bismil-lah, pra me emrin e Allahut, siç transmetohet në hadith, ku thuhet se profeti (a.s.), në lidhje me këtë, i tha

një herë një djaloshi: "O djalosh, kur të fillosh ushqimin, thuaj "Bismil-lah".

Le të mendojmë dhe të meditojmë se sa bereqet, mirësi, ndihmë dhe mbështetje arrin personi, i cili e fillon çdo punë me "Bismil-lah", siç transmetohet në thëni profetike e ajetet kuranore. Në një ajet kuranor thuhet: "**Vërtet letra dërgohet nga Sulejmani e ai padyshim e fillon letrën me emrin e Allahut Mëshirues, Mëshirëbërs**" (Neml, 30)

-Duke dëgjuar, lexuar dhe përsëritur këto vargje, ilahi etj, gjatë përkujtimit të ditëlindjes së Muhamedit (a.s.), ne fuqizohemi, ripërtërihem i rifreskohemi shpirtërisht, moralisht. Sa e sa ajete, thënie profetike e vargje gjatë këtij përkujtimi, na jepin emocione, të cilat shprehen me lot, gufimë shpirtërore, drithërima të shpirtit, të cilat na rikujtojnë nevojën për drejtësi, barazi, mëshirë, dituri e vlera të tjera të larta islame.

-Prandaj dhe përkujtimi i ditëlindjes së profetit (a.s.), eshtë i rëndësishëm, pasi duke i dëgjuar vlerat e mësipërme isla-

me e shumë të tjera si ato, individi reformohet shpirtërisht e moralisht dhe, si rrjedhojë edhe familja dhe shoqëria.

-Së dyti, rëndësia më parësore, përkujtimi i ditëlindjes së tij, na ndihmon ne dhe fëmijët tanë që të njohim edhe më mirë të Dërguarin e Zotit (xh.sh.), moralin, sjelljet dhe kontributet e tij. Kështu krijohet mundësia që atë ta marrim si model për veprat, sjelljet dhe fjalët tona. Në një ajet kuronor thuhet: "**Vërtet tek i Dërguari i Allahut keni (merreni) shembullin më të lartë.**" (Ahzab 21.)

Sa model i përsosur është ai zotëri për mbarë njerëzimin, i cili mundi nga koha e Ademit (a.s.), në vazhdim të tre-gonte drejtësi dhe moshezitim në zbatimin e ligjit, siç bëri profeti Muhammed (a.s.): Ai zotni ia mësoi këtë (drejtësinë) njerëzimit, jo vetëm me fjalë, por edhe me shembullin e tij.

Transmeton Buhariu nga Urve (ibnu Zubejri) se në be-tejën e Fet'hut, në kohën e profetit (a.s.), një grua aristokrate vodhi pasuri e të afërmit e saj dërguan Uzame ibnu Zejdin ndërmjetës, që profeti (a.s.), e donte dhe e konsideronte si djalin e tij, tek Muhamedi (a.s.), që të mos i këpuntej dora gruas haj-

dute, pra, të mos zbatohej ligji ndaj

saj, sepse ajo ishte prej familjeve të fuqishme aristokrate kurejshitë.

Të dërguarit të Zotit i ndryshoi

çehrja e fytyrës nga zemërimi,

për arsyen se Usame i kërkoi të

shkelej ligji e iu drejtua, duke

i thënë : "O Usame! Si guxon

të ndërmjetësosh që të thyhet

ligji i Zotit." Pastaj pejgamberi

(a.s.), mbajti fjalim, duke thënë:

"Popujt para jush, o njerëz, janë

shkatërruar për shkak se, kur vidh-

te aristokrati, prej tyre nuk zbatohej

ligji ndaj tij e, kur vidhëte i dobëti, i varfri,

zbatonin ligjin, duke e paralizuar atë. Pasha

Zotin, në dorën e të cilët ështëjeta e Muhamedit,

sikur Fatimja, vajza e Muhamedit të vidhëte, do t'ia këpusja

dorën."

Cili nga njerëzit, por edhe nga ata të institucioneve të drejtësisë, gjykatat, prokuroria, hetuesia sot në Shqipëri dhe më gjérë, do të zemërohej si profeti (a.s.), kur dikush t'i kërkonte të shkelte ligjin? Cili është i vendosur aq sa pejgamberi (a.s.), në zbatimin e drejtësisë e të ligjit, qoftë edhe ndaj fëmijës së vet? Padyshim asnëjëri.

Cili nga njerëzit, gjatë gjithë historisë, arriti sukses në ndërgjegjësimin e njerëzve me këta shembuj të mirë personalë, ashtu siç arriti i dërguari i Zotit? Asnjë njeri.

Prandaj shkrimitari i njohur Majkëll Hart, në librin e tij mbi 100 personalitetet më me ndikim të të gjitha kohëve, në krye vendosi Muhamedin (a.s.), si personalitetin me rolin dhe influencën më të madhe. Në të njëjtat standarde të larta, si ai që përmendëm më lart në drejtësi, ai ishte edhe

në moral, sjellje, besim të thellë, mëshirë e në çdo aspekt të jetës. Si të mos ndikohet shpirtërisht dhe moralisht personi, i cili dëgjon gjatë rastit të përkujtimit të ditëlindjes së tij, shembuj që të emocionojnë nga një njeri i përsosur si ai.

Prandaj, është i rëndësishëm përkujtimi i ditëlindjes së tij dërguarit të Zotit, sepse gjatë tij në pjesët kuranore, ilahitë, salavatet, ligjëratat etj., besimtarët dhe besimtaret bëjnë bilancin e gjendjes së tyre shpirtërore, morale e të sjelljes në familje dhe jashtë saj dhe shembullin e tij e marrin si model për t'u përmirësuar, në lidhjet e tyre me Zotin, vetveten dhe të tjerët.

Po të vërejmë realitetin e shoqërisë së sotme shqiptare, në të gjëjmë plagë të rënda sociale dhe shoqërore: korruptionin, vrasjet, alkoolin, vjelljet, imoralitetin, etj., të cilat po kërcënojnë rëndë individin, familjen, shoqërinë dhe shtetin. Fatkeqësisht, këto plagë po vijnë duke u përhapur gjithnjë e më tepër, për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit dhe mosbatimit sa duhet të ligjit.

As institucionet e shtetit, të pushtetit nuk po arrijnë t'i pakësojnë këto plagë, pasi rrënja e tyre fillon tek ngopja e epshit, egos me kënaqësi të ndaluara ose të tepruara.

Për t'u shkulur nga rrënje të rënda sociale, të gjithë kemi nevojë të ndërgjegjësohemë dhe të fillojmë të ndryshojmë veten tonë, të zbatojmë ligjin dhe të ftojmë për zbatimin e tij. Këtë ftesë për ndryshim, ndërgjegjësim në vetvete dhe edukim shpirtëror e moral, së pari e gjëjmë të shprehur në vargjet e Mevludit, ilahive dhe ligjëratave, të cilat trajtohen gjatë përkujtimit të ditë-lindjes së pejgamberit (a.s.).

Përkujtimi i kësaj ditëlindjeje ka rëndësi, sepse është një rast i mrekullueshëm, që duhet ta shfrytëzojmë për të parqitur vlerat dhe alternativën tonë islamë, si sistem jete për individin familjen dhe shoqërinë.

Në periudhën e sotme të globalizmit përballemi me sfida të rënda dhe kriza shpirtërore, morale, ekonomike dhe politike. Kriza tek individi, në familje e deri tek përpjekjet dashakeqëse të disave për shkrirjen e identitetit të myslimanit.

Paraqitja e vlerave islamë, që nga drejtësia, dituria, puna, arsimimi, bashkëpunimi etj., në rastin e përkujtimit të Mevludit, është e një rëndësie të veçantë, në mënyrë që sfidat e mësipërme të kemi mundësinë t'i pakësojmë. Gjithashtu, e rëndësishme është që njerëzit të frekuentojnë xhaminë dhe aktivitetet fetare, jo vetëm në rastin e Mevludit, por në vazhdimësi. Lusim Zotin (xh.sh.), që ngjarje të tilla të na i përsërisë për shumë vite me radhë.

## *Rreth studimeve Historike*

Nga pikat qi duhen shpjegue n'Islamizmë: "Tesav-vyfi" prensipi dhe rrugët e tij.

Po të fjaloset njeriu me dijetarët e huejë qi janë marrë me historitë e feve, nuk është punë mos të hasin në kritika të randa edhe për Myslimanizmë që përmbleth në gjininë e vet dega të ndryshme e dymbdhjet rrugë në të krymit e detyrave shpirtnore.

Dijetarët e huej tue përfitue edhe nga polemikat që kanë ngjarë midis dijetarvet Mysliman në kohrat e kalueme, mundohen pretendimeve kësodore t'u apin nji ngjyrë të qendrueshme dhe, i barazojnë këto, me ndryshimet që kanë nder vedi edhe me besimet e tjerë.

Këto mendime janë të gabuëshme; por burojnë edhe nga një e vërtetë: se vetë dijetarët Mysliman nuk janë kujdesur si duhet mbi këto problema, për me dhanë nji gjykim të premë që t'i pleksin degat e veprimevet shpirtnore në rrajen e shenjtë, kù lidhen, e kështu t'i veshin *lladigat* me cipen e gjelbërt t'idealit që ushqen të gjitha pa kurr farë ndryshimi.

Nga dijetarët e huaj Z. Z. Lui Petiu, Esturnel de Constanti, kanë gjetun nji rrugë të gabueshme për të vërtetuë se Tarikati dhe, tesav-vyfi Islamik, nuk kanë lindun nga shpirti i fesë Myslimane; këto kan mohnë rrugen e vargimit dhe, të lidhiës ndisiëve që janë nji bazë e forte; të kish qenë Tesav-vyfi dhe, tarikatet sende që nuk kishin lemun nga shpirti i fesë Myslimane dhe sikur t'ishin artificiale, këto, ma shumë nga të huajit do t'a thoshin dijetarët e Sheriatit të cilët tue bamë theror gjakun nuk janë drojtun aspak nga të themnit, e, të shpallunit të së vërtetës.

Dijetarët Europjan thonë se Tesav-vyfi është i lindur nga prierimet mysterioze të (ndiënë e të Persiën, të cilat prierime shpirtnore si u përvetuen nga faluesit (Zahid) Mysliman u perhapën në të IIItin shekull t'Hixhretit, mbi shtytjet e perpjekjet Ebu Said Iblin-Hajrit; këto parashtime nuk mund të thohet se nuk permbyjnëasnji të vërtetë; por quhen të mbeta.

Ebu Said Iblin-Hajri që ishte nga kryeparia e rrugës së hoxhve, ka qenë i mësuemi i Llokmani Seryh Siut; nga shkaku që u vishte nxansëvet të vet xhybe e hirka prej sofi, duanë të thonë se u therritën me fjalën sofije, dhe u quajt rruga e mendimit të tyre (Tesav-vyf) kurse Ebu Saidi me gjith që ish nga të parët e sofijes, por nuk e ka kaluëm dot klasën e litë midis kryparisë së shqar të sofivet.

Lui Petiu pohon edhe vetë, se para Ebu Seidit ka pasur sofinjë edhe Tesav-vyf; është e vërtetë se mbi fjalën e kupëtimin Tesav-vyf janë bamë shum polemika; këto studjime janë ndamë më dyshë: Nji palë ksnë pas thanë fjalë Tesav-vyf është marrun nga fjala Greke (sofos) që i thonë kulturës e ditunisë dhe, të tjerët thonë nga fjala sof që quhet kazmiri i leshit nga i cili prisnin petkat e i vishnin softët. Ky kuptim i

fundit ka ma të ngjajë mbas rrjedhjes së punës.

Dijetarvet të huaj, më shum nga kuptimi i kësajë fjalë i'u ka tërhequn, vrejtjen mendimi themeluëri Tesav-vyfit që është pshtetun në njisimin gjindurë (Vahdeti Vuxhud) të cilën nuk e kuptojnë që ndodhet në fetë Myslimane, por mundohen t'a gjejnë si të arthme, ata nuk e kuptojnë si është futun ky brenda në besimin Mysliman.

Me gjith ketë mendimi i njisimit gjenduër nga rrugët e tjera të pelqyshme sikur edhe themelisht mos të jetë me që në figurim e kuptim bije në kundërshtim, dhe rrug-heqsit e Sheriatit mbasi në këtë pikë kanë shfaqun shum mendime të ndryshëm, relacionet e Tesav-vyfit me Kur-anin me të vertetë permbyjnë nji çashtje që ka nevojë studimi e thellimi.

Prandej nuk asht e kotë të dhanunit pak shpjegime pa tronditir bazat esencjale të besimit, e të fetarizmës së vërtetë:

Trutë e njeriut të larguëm nga mohimi ose atheizma, veçse me tre mnëdra që tregohen ma poshtë, nuk kanë rrugë të katertë, per me kuptue adhniën Perendjore; dhe ato mendime janë këto që shenojnë ma poshtë:

1. – Idea Vetë-urdhënesisë.
2. – Idea përsimbëllyese.
3. – Idea e pernjisueshme.

Mbas idesë vet-urdhënesisë ZOTI është veçan nga gjithsija është tjetër llojë në trup e sollup; mbas principeve e rrugve të kësaj ideja gjithsija është nji gjâ e përkohshme që e ka krijuem aji, nga mos qenmjë edhe, mund t'a shdukin prap. Por bas konsideratës trupore nji pjesë që i lidhet idesë vet-urdhënesisës. P.sh. si Plotoni e Aristoteli thonë: ZOTI me gjith që është plotsisht veçan gjithsiës, por nuk është krijues i sajë, vetëm është rregullues gjithësia është në vehten e vet e gjindshme dhe, e perjetshme sikurse ZOTI. Mytezile (Sevde Muslimano schismatique) dhe medh-bet të pleksun me kto, në shum çeshtje dhe, mundet po të përjashtohet çashtja e krijimit – të gjith shifen se janë të prienun në pikëpamjen e II-të tue thanë: ZOTI me madhni të tij që është i përplotuëm në ç'do send, të krijojë nji botë të mangut si kjo, sjellë nji të mbetë në shenjtimin, e, përplotsimin Perëndiorë; dhe me prandimin vetëm gjithsiës; por Mytezileja, nuk ka shkuë deri në ketë gradë, vetëm ato janë marrë me punimet (Ef-alë) dhe urdhatat (iradatë) me krijimin e Kur-anit (Mahlukjeti-Kur-anë) e me të tjera kuvendime si këto; këta muhojnë në ç'do mnëry propabilitetin e të pamit Perëndiës, tue ndejtun gjith herë besnikët e llogjikës.

Shumiva e dijetarvet fetarë të Sheriatit me gjith që janë ruajtun, e hequn nga kjo ekstremizmë e Mytezilevet kanë preferuë idenë vet-urdhënuëse që shpjeguem ma parë nga ç'do pikpamje; por në këto modifikime në punrat që nuk perputhen me llogjikën kanë ngelun të shternguëm me

preferuë dijeniën sypër mendjes dhe besimin sypër vertetave mendore.”<sup>11</sup>

Vetëm midis këtyrë Imami Gazaliu tue permblehdhun re-alitetin e prensipin (Hakikatin e Sheriatit) dhe tua gjetun kuptimin mesatarë të vet-urdhënuësiës, e të pershemllysisë, vue në sheshin e studjimit idenë e përnjisuëme në nji tarjtë të pa perpjektë me interpretimet e dijetarve të sheriatit.

Ide përshembllyse i thonë: mendimimit që përtu u shpjetguë tregon nevojë trupzimi, dhe sa do që me ketë kuptim pranohen gjith fuqitë si ç'quanjësië e vesë i trupavet, por këjo ndër themelimet fetare vjen nga shkaku se i nepen ajetevet kuptimi si mbas shembillës e perfityrimit, pa pranuë përndrime.

Idea pernjisueshme nuk âsht plotsisht mendim vet-urdhënuës as vetëm mendimpershembyllës: mundet kjo kerkonë realitetin e të qenunit në permblehdhen e vet-urdhënuësiës e pershembllyesiës që perfundimi i llogjikshëm i këtij mendimi âsht njisimi gjinduer (Vahdeti Vuxhud).

Tesav-vyfi, pra âsht nji rrugë e njisimit gjinduer (Monotheismë) ky, nuk ka ardhun pas ca shekuj nga Jasht n'islamizmë sikur e pandehin dijetarët e huaj por ka qenë i këshilluë me gojën e profetit të Nshtë Muhamed do për-anësve të tij që i kish që motit t'afërmë.

Mirë po do të na thonë: kurse Myslimanizma qenka e themelueme mbi idenë e pernjisueshme, e mbi mendimin të njisës gjindore, dhe nuk qenka mbi mendimin vetë-urdhusiës, perse pra i Nalti profet i parashetrojë shpjegimet e vet ma shumë t'afrueshme mbi idenë e vet urdhuesiës?

Këjo pyetje natyrisht ka nji randsi të posaçme, po edhe perqejgen nuk e ka aq të randë; të menjtohem i nji herë populli i Arabiës s'asajë kohe ishte në nji jetë primitive, ishte aq i prierun mbas fuqivet materiale sa përt'a shpëtumun e përt'a naltsuemun ishte nevojë t'i epesh fuqi mendimit vet-urdhusiës dhe idea e pernjisueshme duhesh të lehes përt intelijendën e shqueme; dhe këjo përt themelin e fesë, të sjellunit në ketë mëndyrë, ishte krejt e arsyeshme.

Njerzit që kanë pas besuë shum Perëndira e kanë qenë në urgjji të zezë, ma parë po nuk u bindën në njësimin e veht urdhnusiës\*\*\*\*\* nuk asht e mundun të arrijnë në iden e pernjisëshmë \*\*\*\*\* të tillë personave tue qenë me pa besim, po t'u shpjegohet ideja përnjisëshme, nga shkaku që nuk janë t'arritun në shnallë të veturdhnuëshmës, sa kohë që janë të mësuem me idenë përshembllyëse, nuk shijoheu dotë me shijen e pernjisëshme e ngelin në përshembelluësi e urgji të zezë, ase ma mirë me thanë në pa besim.

Këta që janë në ketë gradë, përnjiherë dhe me tanë lakuqësin e kuptimit po të lihen para idesë vet-urdhnuësiës, ksodore Zotin me madhënit të Tij e bashkojnë tue konsiderue si të pa qenun.

Perdëllimi e komunikimi i Muhamedit (A.S.) i ka ngritur të dy këto pengime e prapësime; i dergumi i Zotit, ç'do mendimi, në forcën që permban për mos të ranë në dyshim tue i dhanë fuqitë veturdhnushmisë ka perhedhun në besimtarët e vetë iden e përnjishushme.

Ca nga shkrimitarët e huej si Lui Petiu pa kuptuë mirë

1. Ilmi akle, imani thybuti aklike terxhihi iztirarenda kallmishlerder.

shpirtin e rrugëvet-islamike, kanë ra në gabim tue pandehun këto nji lloj me rrugët e tjera të krishterizmes, ky shkrimitar thotë: <<sofizma (Tesav-vyfi) nuk asht as nji huall hollësi, as nji rrugë filosofie, vetëm âsht nji metod per të mësuë të jetuëmit në pastërti të plotë>>.

Ky âsht nji gabim i madhë, se tesavyfi âsht nji rrugë e drejtë që ka pernjellë aq faqe e shfaqje të mendimit fetar, në peritudhat me mijëra vjetshë, sa mohimi i këtyre të vertetave, e shtrengonë njerin të jepin dy gjykime mbi mohuësit.

1. – O e dinë të verteten por e mohojnë vetë tue dash-të....

2. – Ose nuk kanë pasun kohë t'a hollojnë çashtjen si duhet dhe, janë nxitur në gjykimet.

N'islamizmë përt me kuptuë kompetencën e tesavyfit, nuk mjaftonë studimi e veprave të së fjalvet e të ceremonivët, të tarikateve; duhen analizuë e studjuë imtisht veprat e nalta, librat e randë të sofistëvet të shquëm të cilët tue u-pështetun Kur-anit kanë shpjeguë kuptimet e myllura veçanë haptavet.

Por edhe këto përt me i kuptuë sikurse duhet, âsht nevojë t'jetë njeriu afër të ditunve t'asaj rruge të shkëlqyeshme; sa per ketë do t'i lutemi të gjith ndjeksve së kësajë ditunje shpirtnore, me u kujdesun per me i dhanë dritë me shkrim këtynë pikave të errëta, që mos këndeje edhe shkrimitarët e huej, mos të apin nji gjykim të gabushëm mbi hollsinat e fesë muslimane.

Ata që janë dijetar të tarikateve e që kanë kuptuë si duhet, Enfasi-Abdyl-kader ve shazeli, veprat e Muheddini Arabi-ut, poezi e Ibni Farazit, të Mevlana Xhelalyd-dinit e të tjerëve, duhet me e pasun detyrë kryesore, me dhanë shpjegime shkrimore mbi hollsinat e tesavyfit, që kësodore të kuptojnë edhe kundreshtuësit gabimet e tyne.

Në botën e shkelqyshme myslimane, kanë ardhun shum dijetar fetar dhe të shqar të cilët tesavyfin, dhe sa ma shum ca metodet e këti, me gjith që nuk i kanë përvetuë, por nuk e kanë përbuzun e mohuë krejtë vargun e drejtë të tarikateve ashtu edhe burimimin e tesavyfit.

Tesavyfi islamik bazën e tij e ka nga Kur-an, ku thot i shënjtë Fletuër Qillor.

<<Ay âsht i parë, Ay âsht mbram,  
Ay âsht i dukun, Aj âsht i mbsheft>>

Këto katër shquanjësi tue qenë që përmblehdhin çdo përmendim, âsht e domosdoshme figurat, e ngjyrat shfaqësore të quhen si të qenmet e nji trupit pa-shoqët.

<<Kur-do, e nga-do' fytyr e Perendisë –  
Shifet, se Ay âsht drit e Gjithësis...>>

Këto hadithe e si këto Ajete të tjerë shfaqin njisinë gjindore (vahdeti vuxhudit), sa do që të jetë kuptimi i thjeshtë, tyne në konfliktë por prap janë baza të shëndoshta përt tesavyfin islamikë që të vertetohet se burimin etj e ka nga i shenjtë Kur-an, dhe jo drejtë per drejtë nga pasëlanjet në shpirtnore të fevet vjetra Indiane ose Persiane si dueu me thanë ca dijetarë të huejë.

“Zani i Naltë”

# Kalvari i shkatërrimit të objekteve osmane në Shqipëri

Shkatërrimi i objekteve osmane përbën një ndër faqet më të turpshme të barbarizmave në Ballkan. Sipas Michael Kiel, historianit dhe studiuesit më eminent të historisë dhe arkitekturës osmane në Ballkan, mund të thuhet se 95 deri në 98 për qind të arkitekturës osmane në Ballkan, krijuar brenda një harku kohor pesëshekullor, u shkatërrua në mënyrën më të përbindshme nga tèrbimi nationalist ballkanik, që kërkonte të shkatërronte gjithçka që simbolizonte historinë disashekullore osmane në Ballkan.

Ky barbarizëm nuk do të kursente madje, as objektet arkitekturore osmane më të bukurat dhe më të vjetrat, duke i asgjësuar ato në kulmin e histerisë që nuk njihte asnjë kufi. Kështu dikur, në qytetet e Sofjes dhe të Beogradit, kishte më shumë se njëqind xhami, po të mbështetemi tek pohimet e udhëpërshkruesve perëndimorë që kaluan nëpër këto qytete, ndërsa sot në Beograd ka një xhami të shkrumbuar (Bajraklli), ndërsa në Sofje kanë mbetur vetëm dy të tillë. Njëherë e një kohë, në qytetin e Seresit kishte gjashëdhjetë xhami, sipas vjetarëve osmanë, ndërsa sot ekzistojnë vetëm rrënojat e tri prej tyre. Mes tyre qe edhe xhamia e Hajredin pashës, e datës 1386, e cila u asgjësua në vitin 1938.

Mund të thuhet se deri në vitin 1965, kur u krye edhe asgjësimi masiv i objekteve të kultit në Shqipëri, ekziston ende, qoftë edhe në gjendje të mjeruar, një numër i madh i xhamive.

Arkitektura osmane në Shqipëri prezantohet me objektet e kultit (xhami, teqe), objektet arsimore (medrese, mektepe, ruzhdije), tregtare (bezistene, hane, karvansaraje), urbanistike (ura, hamame), ushtarake (kala).

Me përjashtim të objekteve të kultit, pjesa më e madhe e objekteve të tjera, produkte të arkitekturës osmane në Shqipëri, u shkatërruan shumë herët, si gjatë shekujve (për shkak të fatkeqësive natyrore), por në pjesën më të madhe në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, që gjatë kohës së fundit të sundimit osman në Shqipëri.

Rastin më tipik të asgjësimit të objekteve osmane si rezultat të fatkeqësive natyrore e përbën varoshi i kalasë së Shkodrës. Varoshi i Shkodrës përbënte një zonë shumë të populluar, ku jetonte edhe një pjesë e mirë e esnafëve të ndryshëm në këtë qytet.

Varoshi i kalasë së Shkodrës u shkatërrua shumë, kur lumi Drin ndërroi shtratin e tij duke përmbytur një pjesë të madhe të varoshit të kalasë. Jo vetëm që lagje të tëra u

shkatërruan dhe banorët e tyre u detyruan të vendoseshin në zona të tjera, por njëkohësisht, u shkatërruan edhe shumë objekte të kultit islam, mes të cilave mund të përmenden xhamitë e lagjeve të varoshit të kalasë.

Gjithashtu, mund të paramendohet se fat të keq patën shumë objekte të kultit që gjendeshin nëpër fshatra, të cilat në periudha të caktuara mund të kishin qenë qendra të rëndësishme për krahina të Shqipërisë, por që me kalimin e kohës e humbën rëndësinë që kishin, aq sa u ktheyen në fshatra të vegjël me pak banorë ose pa asnjë banor. Përhapjet e sëmundjeve të ndryshme epidemike mund të bëhen shkak që banorët e fshatrave të caktuara t'i braktisnin ato, duke lënë aty në mëshirë të fatit edhe objektet e kultit.

Objektet e tjera të arkitekturës osmane në Shqipëri u shkatërruan, pasi nuk plotësonin më nevojat e komunitetit vendas, për të cilin edhe ishin ndërtuar dhe, nga ana tjetër, nuk ia vinte të shpenzoheshin shuma për t'i meremetuar më ato ose pushteti qendor nuk merrte më përsipër që të meremetonte, pasi nuk kishte burime financiare dhe këtë gjë ia linte komunitetit vendas, i cili nga ana e tij, nuk arrinte të mblidhte paratë që nevojiteshin për këto meremetime.

Kalatë janë trajtuar për shumë kohë nga ana e studiuesve dhe arkeologëve shqiptarë si ndërtime tipike mesjetare paraosmane, ndoshta për të rritur rëndësinë historike të tyre mbi bazën e lashtësisë së ndërtimit. Pa dyshim që ky është një ekzagjerim, pasi është e pamundur të mendohet se kështjellat e Shqipërisë arritën të vinin deri në ditët tona me fortifikimet dhe muret mesjetare, aq më shumë, po të kemi parasysh faktin se shumë prej tyre u morën prej osmanëve vetëm pas betejave të ashpra me mbrojtësit e kështjellave shqiptare, me ç'rast nuk është e vështirë të mendohet se gjatë rrethimeve të tyre muret dhe shumë objekte brenda kalave u dëmtuan, madje u shkatërruan fare nën breshërinë e gjyleve që lëshonte ushtria osmane.

Prandaj, osmanët duhet të kenë bërë shumë meretime dhe ndërtime të reja në kështjellat shqiptare, të cilat u siguronin atyre një vijë të rëndësishme mbrojtjeje në pjesën e brendshme të territorit shqiptar, veçanërisht në rast sulmi nga shteti fqinj në anën tjetër të detit Adriatik, Venediku.


Përveç kalave që gjetën, osmanët ndërtuan edhe një

sërë kalash të reja, në varësi të nevojave të tyre strategjike ushtarake dhe për të forcuar rrjetin e mbrojtjes dhe kontrollit ushtarak në Shqipëri. Kalaja më e vjetër është ajo e Elbasanit, e ndërtuar me urdhër të sulltan Mehmetit II gjatë fushatës së tij ushtarake në Shqipëri. E ndërtuar në Elbasan mbi themelat e dikurshme të një qyteti të vjetër antik, kalaja e Elbasanit përbënë një pikë të rëndësishme ushtarake, pasi kontrollonte rrugët që lidhnin Veriun me Jugun e Shqipërisë. Si kështjellë, ajo përmbushte nevojat ushtarake për të cilat qe ndërtuar. Përpjekjet e Skënderbeut për ta pushtuar nuk qenë të suksesshme dhe ai u detyrua të largohet pa e marrë atë, pa harruar se ndërko'hë, sulltan Mehmeti II ishte duke marshuar sërisht kundër Shqipërisë.

Kalaja e dytë më e rëndësishme, e ndërtuar nga osmanët, qe ajo e Vlorës. Kalaja u ndërtua me urdhër të sulltan Sulejmanit, Ligjvénësit, gjatë fushatës së tij kundër ishullit të Korfuzit. Shtabi perandorak i sulltanit qe vendosur në qytetin e Vlorës. Me këtë rast, sulltani urdhëroi që të ndërtohej në qytetin e Vlorës një kala. Ndonëse hipotetike, mu-

Sejahatname e kishte cilësuar si njëren nga tre objektet më të arritura të arkitekturës osmane, humbi fare, vetëm që të shpëtonin disa para nga arka e bashkisë, që duheshin për nxjerrjen dhe transportin e gurëve.

Objektet e arsimit (medresetë) nuk qenë në numër të madh në Shqipëri, kjo përfaktin që marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe qendrës së perandorisë, Stambollit, qenë shumë të forta. Mejtepet dhe medresetë shërbën si vatrat e para të arsimimit, sipas stilit osman, për të vazhduar më tej nëpër medresetë dhe shkollat e njohura të Stambollit, të cilat u jepnën të diplomuarve të tyre hapësirën dhe mundësinë e nevojshme për të ngjitur shkallët në karrierën administrative dhe atë fetare. Megjithatë, deri në vigjilje të luftës së dytë botërore, patën ekzistuar disa medrese të rëndësishme në Shqipëri, si në Shkodër, Tiranë, Berat, Gjirokastër, Konispol, madje dhe në ndarje të vogla administrative, si në nahijen e Libohovës, e njohur për numrin e madh të klerikëve të punësuar në strukturat e meshihatit osman, madje edhe në qendrën e meshihatit në Stamboll.



ndësia që kalaja të jetë ndërtuar nga kryarkitekti osman me origjinë shqiptare Sinani, është shumë e madhe, për më tepër, kur dihet shumë mirë që arkitekti merrte pjesë në fushatat e drejtuara nga vetë sulltani. Kalaja e Vlorës luajti një rol të rëndësishëm në konsolidimin e pushtetit osman në Vlorë, e cila kishte rënë nën sundimin osman, që në vitin 1417, duke u bërë kështu edhe porti i parë osman në Mesdhe. Ajo ruajti rëndësinë e saj deri në vitin 1840, për të përjetuar një denigrim të paparë në vitet në vazhdim. Rrënojat e fundit të kalasë u përdorën në vitin 1906 nga ana e bashkisë së Vlorës për të shtruar rrugën e Skelës. Kështu, kalaja, të cilën Evlija Çelebiu në veprën e tij

Medresetë, bezistanet (tregjet e mbuluara), hamamet, karavansarajet filluan të shkatërrohen në vigjilje të luftës së dytë botërore, pasi humbën funksionin e tyre dhe, në kushtet e reja të urbanizimit të qyteteve, sipas modeleve moderne, ku qytetet kryesore zgjerohen edhe më shumë, ato përbën pengesë për këtë zhvillim urbanistik, prandaj edhe u sakrifikuan në emër të këtij të fundit.

Rastin më tipik e përbën qyteti i Tiranës dhe projekt modern italian i tij, i cili u zbatua në pjesën më të madhe të tijin. Me këtë rast, mes të tjerash në Tiranë, Komuniteti Mysliman pranoi të sakrifikonte xhaminë e Karapicëve,

një objekt i rëndësishëm, si për nga vjetërsia (duke marrë parasysh se qyteti i Tiranës është një qytet relativisht i ri i themeluar në shek. XVII nga Sulejman pashë Mulleti), ashtu edhe nga arkitektura dhe zbukurimet murale që kishte. Shkatërrimi i objekteve në emër të urbanistikës së re u përjetua edhe gjatë pushtetit komunist në Shqipëri. Rastet më tipike i përbëjnë pazari i vjetër i Tiranës dhe xhamitë e Elbasanit, të cilat sapo ishin meremetuar nga ana e Institutit të Monumenteve. Mjafton të përmendim faktin që dy qytete u zhvilluan duke ruajtur pjesën e vjetër të tyre, Berati dhe Gjirokastra, të cilat sot konsiderohen aq të vlefshme, sa janë marrë në mbrojtje nga UNESCO-ja.



Periudha e viteve 1915 deri në vitin 1920 pati anën e saj negative, pasi Shqipëria u kthye në një terren marshimi për ushtritë e shteteve të ndryshme ballkanike dhe evropiane. Në këtë periudhë, mbi trojet shqiptare shkelën ushtritë greke, serbe, bullgare, italiane, franceze dhe austro-hungareze. Dihen shkatërrimet e objekteve që bënë grekët në jug të Shqipërisë nëpër xhamitë dhe teqetë, ndërkohë që një numër i madh i italianëve u sistemuan nëpër medrese dhe xhami pa xhemat, me ç'rast edhe i dëmtuan më shumë këto objekte.

Ndërkohë, në vitet 1920 deri më 1945, zyra e vakëfeve përjetoi ulje të të ardhurave dhe, për të përbushur nevojat e tyre ekonomike, nuk ngurruan që të shisnin si material ndërtimi gurët e xhamive që nuk kishin xhemat. Me këtë rast u shkatërruan totalisht edhe xhami që kishin vlera historike dhe arkitektonike për qytetet në të cilat ndodheshin.

Shkatërrimin total xhamitë e përjetuan gjatë sistemit komunist në Shqipëri, i cili kulmoi me të ashtuquajturin revolucion kulturor, një imitim i së njëjtës lëvizje që ishte realizuar në Kinë me objektet e kultit budist. Në fillim fare, u shkatërruan minaret e xhamive, si shprehja më e spikatur e arkitekturës osmane nëpër qytete dhe fshatra. Më pas, u mendua se objektet e kultit ende krijonin hije ideologjike mbi mendjet e qytetarëve dhe fshatarëve, prandaj u vendos që të asgjësohen ose t'u ndërrohej destinacioni, të cilat ose u shkatërruan totalisht nga themelet ose u shndërruan në stalla dhe hambarë.

Brenda një harku kohor të shkurtër disamujor, u shkatërruan ose u ndërrua destinacioni i 2035 objekteve të kultit në total, prej të cilave 740 xhami, 608 kisha dhe manastire ortodokse, 157 kisha dhe manastire katolike dhe 530 teqe dhe tyrbe bektashiane.

Sot, njëzet vjet pas demokratizimit të Shqipërisë dhe njëqind vjet pas shpalljes së pavarësisë në Shqipëri, ende ruhen objekte të kultit fetar islam nga periudha osmane (xhamia e Ethem beut në Tiranë, xhamia e Plumbit në Shkodër, xhamia e Pazarit në Gjirokastër, xhamia e Beqarve në Berat, xhamia në fshatin Rusanj të Delvinës, Muradija në Vlorë, Naziresha në Elbasan e ndonjë tjetër, që mund të kemi lënë pa përmendur), të cilat janë përballë momentesh jetike për ekzistencë. Dëshira për t'i restauruar me çdo kusht, përfitim fondesh, mund të çojë në shkatërrimin e fundit historik të këtyre objekteve, në rast se restaurimi i tyre do të kryhet nga agjenci amatore, që në vendet e tyre nuk kanë arritur i shpëtojnë objektet e kultit në formën origjinale apo nga ekipe të specializuara, të cilat mund të bëjnë ç'të duan, vetëm që të lëvizin fondet, sepse në Shqipëri mund të bësh edhe punë pa përgjegjësi, ngaqë nuk ka kush të ta kërkojë këtë llogari. Nëse kjo do të ndodhë do të bëhem i dëshmitarët e aktit të fundit të një tragedjie në historinë e artit islam-osman në Shqipëri.

# Ndikimi i letërsisë islame në letërsinë perëndimore

Rëndësia e trashëgimisë islamë nuk kufizohet me shkençën, artin dhe filozofinë e saj. Kontributi i myslimanëve në letërsinë botërore ka një peshë të paimagjinueshme. Jo më kot edhe autori i shumë librave që shpjegojnë trashëgiminë kulturore islamë, orientalisti skochez **Hamilton Alexander Rosskeen Gibb** (vd. 1971), për ndikimin e letërsisë islamë në Evropë, thotë:

*"Duhet mësuar që Lindja, pra Islami, çeli një shteg të ri për evropianët. Në sajë të Islamit, evropianët arritin në këtë nivel në fushën e letërsisë. Poëtët francezë mbeten nën ndikimin dhe epërsinë e stilist poetik arab."*

Realisht, kjo epërsi që përmend edhe Prof. Gibb ka qenë e papritur dhe gati është e papranueshme për shumë evropianë, që lartësojnë kulturën oksidentale, të pranojnë ndikimin nga kultura orientale, veçanërisht islamë. Atyre nuk ua mori mendja se ky qytetërim kishte dominuar kaq shumë në kulturën e tyre, sa të gjenin gjurmët e letërsisë lindore në disa prej tregimeve të *Mbretit Artur* apo efektin e kulturës islamë në një nga tregimet më të hershme evropiane, siç është *Aucass et Nicalette*. Tregim, i cili si personazh kryesor ka **al-Kasim** (Aucass) dhe të dashurën e tij, që ishte një princeshë myslimanë nga Tunizia.


Myslimanët mbrojtën trashëgiminë letrare botërore, duke ringjallur në gjuhën arabe mjaft vepra të rëndësishme botërore, siç janë fabulat e etikës politike të **Bejbeda-së Kelile dhe Dimne**, vepër e cila u ridimensionua dhe u ringjall në kohën e kalifatit të abasit. Më pas, kjo vepër u përkthye nga gjuha arabe në gjuhët perëndimore. Kjo vepër e mrekullueshme, më vonë do të bëhet pikë frysëzimi për **La Fontaine** (vd. 1695).

**Kitabut-Tajri** i **Feriduddin Attarit** pasqyrohet edhe tek **Ferma e Kafshëve** e **George Orwell**-it, madje edhe tek filozofia që përcjell **Alkimisti i Paulo Coelhos**.

Mjafton të lexohet libri "Gëtja mes Perëndimit dhe misticizmit oriental", i studiuesit **Edvin Cami**, për të kuptuar influencën që ka pasur kultura letrare islamë tek shkrimtarët e mëdhenj evropianë, siç është rasti me **Gëten**.

Edhe shkrimtarët rusë ishin mjaft të ndikuar nga letërsia islamë. **Tolstoi** dhe **Pushkini** ishin mrekulluar nga Kurani. Madje, Pushkini ka një vjershë epike me titull "Një imitim i Kurabit", pas një periudhe të gjatë të leximit që i kishte bërë Kurabit nga gjuha frëngje.

Le të kalojmë në detajet e disa prej këtyre veprave dhe ndikimin që kanë ushtruar në mbarë kulturën evropiane dhe perëndimore.



## 1. NJËMIJË E NJË NET DHE LETËRSIA EVROPIANE

Myslimanët kontribuan edhe në mbledhjen në një libër të tregimeve, përrallave dhe legjendave më të veçanta, të qarkulluara ndonjëherë gojë më gojë, siç është për she-mbull vepra e mrekullueshme *Njëmijë e një net*. Me përkthimin që iu bë kësaj vepre nga gjuha arabe në gjuhët botërore, efekti i saj nuk u vërejt vetëm në letërsi, por edhe në kinema dhe në muzikë.

Libri "Ndikimi i njëmijë e një netëve në kulturën evropiane" (Eseru *Elf Lejletin ve Lejle fi's-Sekafeti'l-Urubije*), i orientalistit italian **Francesco Gabrieli** (vd. 1996), është një dëshmi mjaft e bukur për këtë. **Maksim Gorki** (vd. 1936) kur lexoi përkthimin në rusisht të veprës së **Gabrielit** nga **Grimsky**, nuk mundi ta fshihte magjinë që i krijoi, andaj dhe shkroi një artikull rreth *Njëmijë e një netëve*.

Poeti i madh anglez **William Wordsworth** (vd. 1850) ka rrëfyer gjurmët që kanë lënë tek ai tregimet *Njëmijë e një net*. Novelisti i famshëm anglez **Charles Dickens** (vd. 1870) gjithashtu, mendohet se ka mësuar të shkruajë në mënyrë seriale, duke lexuar novelat arabe. Novelisti francez **Marcel Proust** (vd. 1922) është një tjetër admirues i *Njëmijë e një*

netëve, ndikimi i së cilës mund të vërehet lehtë në veprat e tij. Thuhet se edhe tek **Tolstoy**, **Goethe**, **Marquez** dhe tek shumë shkimtarë të mëdhenj të tjerë *Njëmijë e një netët* kanë luajtur një rol vendimtar për krijimtarinë e tyre.

Numri "1001" krijon një figurë të magjishme simetrike. Sipas matematicienëve arabë të asaj kohe, numri 1000 simbolizonte pafundësinë. Ndoshta për këtë arsy, kishin dalë fjalë se, kush lexonte të gjithë tregimet, do të çmendej dhe do të vdiste. "Edhe sikur t'i lexojmë, edhe sikur të mos i lexojmë njëmijë e një tregimet, ne do të vdesim" - do të shprehej nobelisti turk **Orhan Pamuk** në *Hyrjen që i bën njërit prej përkthimeve në turqisht të librit Njëmijë e një net.*

Me siguri, simbolika e të qenit i pakufishëm, i pafund dhe i përfunduar, që ka libri *Njëmijë e një net*, ka ndikuar tek shumë shkrimtarë të ndryshëm. Një rrëfim i tillë i novelave që vijnë e lidhen në formë rrethi, i ka mrekulluar edhe mjeshtërit e novelave, si **Italo Calvinon** dhe të madhin **Jorge Luis Borges**.

Filmat *Der Mûde Tod* (1921), i **Fritz Lang**-ut dhe *The Thief of Baghdad* (1924, 1940), i **Hollywood**-it janë të frysmezuar tërësisht nga tregimet *Njëmijë e një net*. Më pas, në vitin 1942, Hollywood-i do të realizonte filmin më të plotë *Arabian Nights*, me pjesë nga *1001 netët*. *Ali Baba and the Forty Thieves* (1944), i **Maria Montez** dhe **Jon Hall**, është një tjetër film i frysmezuar nga po e njëjtë vepër.

Në vitin 1992, **Walt Disney** do të bënte filmin vizatimor *Aladdin* dhe në vitin 2003 bëhet filmi tjetër vizatimor mjافت i suksesshëm *Sinbad: Legend of the Seven Seas*, i frysmezuar nga tregimi me titull *Simbad Detari*, në veprën *Njëmijë e një net*.

Kurse **Hollywood**, në vitin 1974, me regjisori italian **Pier Paolo Pasolini**, realizon filmin *Il fiore delle mille e una note* dhe në 1990 realizohet filmi francez *Les 1001 nuits*. Por filmi, i cili i qëndroi më besnik tregimeve origjinale, do të mbetet filmi serial *Arabian Nights* (2000), i transmetuar në kanalin televiziv amerikan **ABC** dhe në atë anglez **BBC**, i cili mori edhe çmimin **Emmy**.

Ndërsa, kompozitori rus **Nikolai Rimsky-Karsakov**, duke u frysmezuar nga vepra *Njëmijë e një net*, konkretisht nga tregimet: *Simbad Detari*, *Princi Kalander*, *Princi i ri dhe princesha*, *Festë në Bagdat*, të kësaj vepre dhe, si për ta bërë të pavdekshëm personazhin kryesor të *Njëmijë e një Netëve*, personin që rrëfen tregimet, *Sheherezaden*, në vitin 1888 kompozon veprën e famshme *Scheherazade*.

## 2. EFEKTI I ROMANIT HAJJ IBN JAKDHAN NË LETËRSINË BOTËRORE

Romani filozofiko-pedagogjik *Hajj Ibn Jakdhan*, i filozofit mysliman andaluzian **Ibn Tufejl** (shek. XII) nuk ka mbeetur i panjohur. Fillimisht, ai është përkthyer në hebraisht, në vitin 1349 nga **Musa Nerbuni**, më pas në vitin 1671 është përkthyer në latinisht nga **Edward Pucac**. Filozofi i famshëm **Spinoza** është ndër përkthyesit e parë të kësaj



vepre madhështore. Pas përkthimit të tij në hollandisht, në shekujt në vijim është përkthyer disa herë në anglisht, në gjermanisht, spanjisht, frëngjisht, rusisht dhe në gjuhë të tjera të botës.

Kjo vepër e **Ibn Tufejlit**, bëri një efekt të gjerë në letërsinë evropiane dhe perëndimore. La gjurmë të mëdha në stilin e të shkruarit të romaneve dhe novelave, në fantazinë, në etikën dhe në botën shpirtërore të veprave dhe mendjeve kryesore perëndimore dhe evropiane. Fjala vjen, frysëzimi nga *Hajj Ibn Jakdhan* mund të vëret lehtësisht në këto vepra me famë botërore:

*Utopia* – **Thomas More** (vd. 1535)

*New Atlantis* (Atlantiku i ri) – **Francis Bacon** (vd. 1625)

*El Criticon* (Kritika) – **Baltasar Gracian** (vd. 1658)

*Robinson Crusoe* – **Daniel Defoe** (vd. 1731)

*The Jungle Book* (Libri i Xhunglës) dhe *The Second Jungle Book* (Libri i Dytë i Xhunglës) – **Rudyard Kipling** (vd. 1936)

Ndikimin e *Hajj Ibn Jakdhan*-it mund ta gjejmë edhe tek **Spinoza**, **More**, **Voltaire**, **Rousseau**, **John Locke**, **Leibniz**, tek "Feja natyrale" e **Hume**-s, madje edhe tek **Sartri** dhe **Camus**-i.

*Hajj Ibn Jakdhan* mund ta gjejmë edhe në kinematë evropiane dhe perëndimore. Nuk është diçka e re të themi se shumë skenaristë perëndimore të filmave i janë referuar filozofisë, kulturës, mistikës dhe veprave të ndryshme letrare të Lindjes dhe kështu kanë realizuar veprat më të bukura të kinemasë botërore.

Një njeri që ka lexuar *Hajj Ibn Jakdhan*, nuk e ka të vështirë të vërejë thuajse të gjithë rrjedhën e ngjarjes së Hajj-it të **Ibn Tufejlit**, në formatin e filmit *Robinson Kruzo* dhe *Xhungla*, madje edhe në filmin *Tarzani*.

Kjo vepër e **Ibn Tufejlit**, për çudi, është bërë burim frysëzimi edhe për **George Fox**. Aq sa, të bëhet shkak që të krijojë fillimisht një sekt të Krishtërimit, pastaj një fe që do ta quante *Religious Society of Friends* apo *Quakers*, siç njiheshin rëndom. **Fox** merr shtysë nga libri *Hajj Ibn Jakdhan*,

për parimin e tij se njeriu mund të krijojë marrëdhënie të drejtëpërdrejta me Zotin, pa ndërmjetës, nëpërmjet "ndriçimit të brendshëm", që i dhuron shpirti i shenjtë dhe mund të dallojë të shtrembërën nga e drejta.

### 3. ESKATOLOGJIA ISLAME TEK KOMEDIA E DANTES

**Dante Alighieri** (vd. 1321) është një ndër njerëzit më të kulturuar të Evropës mesjetare. Ai mësoi gjithë sa mund të mësohej në Mesjetë: art, filozofi, teologji, histori, drejtësi, fizikë, matematikë, astronomi, dije enciklopedike, pa të cilat as që mund të mendohet hartimi i një vepre siç është *Komedia Hyjnore*. Por krahas tyre, **Dante**, me sa duket ka mbetur nën ndikimin e letërsisë myslimanë të kohës. Këtë e dëshmojnë edhe punimet e shumta dhe serioze që janë bërë lidhur me **Danten** dhe kulturën islame. Disa prej tyre mund të veçojmë:

*Les sources orientales de la Divine Comédie – Edgar Bloch*

*Dante e l'Oriente* dhe *Intorno alle fonti orientali della Divina commedia* – Giuseppe Gabrielli


*La Escatología Musulmana en la Divina Comedia* – Miguel Asin Palacios

Ndërkohë që lexojmë udhëtimin imagjinar që bën **Dante** si autor dhe aktor në tri botët e përtejme, në Ferr, Purgator dhe Parajsë, vërejmë dukshëm elementet e eskatologjisë islame në të. Fillimisht, ideja e një udhëtimit të tillë, siç edhe vetë studiuesit e shprehin, është e inspiruar nga udhëtimi i Miraxhit të **Profetit Muhamed** (s.a.s.), me të cilin **Dante** është njojur përmes veprave të ndryshme, por kryesisht përmes *Liber Scale Mahometi* (Libri i udhëtimit të Muhammedit), i botuar në vitin 1264, në latinisht.

Një tjetër burim fryshtimi për **Danten** ishte edhe menjintari i madh mysliman **Ibn Arabiu** (vd. 1240). Këtë e vërejmë tek analogjia e skenave të botës tjetër, që përshkruan **Ibn Arabiu** në veprën "Futuhati'l-Mekkije" me skenat që **Dante** tregon në *Komedinë e tij*.

Ndikimin e **Dantes** nga Miraxhi i **Profetit Muhamed** (s.a.s.) dhe nga **Ibn Arabiu** mund ta lexojmë në punimin e shkëlqyer të **Miguel Asin Palacios** *La Escatología Musulmana en la Divina Comedia*, i cili është përkthyer edhe në shqip nga historiani **Ardjan Muhaj**, me titullin *Eskatologjia Muslimane* në *Komedinë Hyjnore* (Sh. Botuese "Averroes").

**Asini** në këtë libër shpjegon se si figurat e eskatologjisë islame, veçanërisht mënyra se si ato i shpjegon **Ibn Arabiu**, i gjemjë në trajta të njëjtë edhe tek *Komedia* e **Dantes**, fjala vjen, shtresat e Xhehenemit, Xhenetit, ura e Siratit, llojet e bimëve, Tuba, Arafë i **Ibn Arabiut** me Limbo-n e **Dantes**, këto dhe plot elementë të tjera të eskatologjisë islame gjenden lehtësisht në veprën e cila padashim është një nga kryeveprat e Evropës, vepër e cila njëkohësisht nisi letërsinë e re evropiane dhe luajti rolin e dallëndyshes së parë të lëvizjes së Rilindjes.



### 4. DON KISHOTI I CERVANTESIT DHE ANDALUZIA E MYSLIMANËVE

Qytetërimi islam kishte ndërtuar një strukturë aq madhështore, saqë duhet kuptuar se do të ishte e çuditshme, sikur të mos ishin ndikuar perëndimoret. Andaj është më se e natyrshme që letërsia evropiane të jetë shtruar me gurët letrarë të botës islame. Jo më kot edhe poeti dhe novelisti spanjoll **Juan Goytisolo** thotë se dyshemeja imagjinare e *Don Kishotit* të **Miguel Cervantesit** është e ndërtuar me gurët e Andaluzisë. Ka prej studiuesve që tregojnë se **Cervantesi** ka marrë si model eruditin mysliman andaluzian **Ibn Hazmin**, për të krijuar personazhin kryesor të romanit.

Ndërsa shkrimitari i *New York Times-it*, **Edward Rothstein**, në artikullin e tij "Regarding Cervantes, Multicultural Dreamer" (13.06.2005), shkon edhe më tutje, duke thënë:

"Pse "Don Kishoti" ishte shkruar në arabisht në original? Apo më mirë, pse Servantesi, i cili shkroi librin në spanjisht, tha se e kishte përkthyer nga arabishtja?... Le të marrim para-sysht vetëm dëshminë lojcake të Servantesit përmbi origjinën e librit: Një ditë, në pazarin e Toledos, shkruan ai, një djalosh po përpinqej të shiste deftere të vjetra dhe copëra të dëmtuarë letash të mbushura me shkrime në arabisht. Servantesi tregon se si ai bleu një dorëshkrim aty dhe pastaj kërkoi vërdallë për ndonjë maur që t'i përkthente. "Nuk ishte fort e vështirë" të gjeje një maur të tillë, shkruan ai. Bile, vazhdon autorii, ai mund të gjente edhe një përkthyes nga hebraishtja. Dorëshkrimi arabisht, i thotë mauri atij, është "Historia e Don Kishotit të Mançës, shkruar nga Cide Hamete Benengeli, një historian arab." Servantesi e shpie maurin në manastirin e një kisha dhe i porosit kështu përkthimin e librit. Edim se e gjitha kjo është një shaka, ashtu si edhe vetë emri i historianit: "Cide" (sejjid) është një titull nderimi, "Hamete" është një variant i emrit arab Hamid, dhe "Benengeli" do të thotë patëllxhan." (Edward Rothstein, *Don Kishoti, si parathënie e modernitetit, përshtati në shqip Ervin Hatibi, Gazeta ABC, Nr. 4.*)



## THERJA E KURBANIT PËR LINDJEN E FËMIJËS (el-akikah)

### HYRJE

El-akikah, në kuptimin etimologjik do të thotë ndërprerje. Përsa i përket kuptimit terminologjik në sheriatin islam, është prerja e deles apo dashit kurban, ditën e shtatë të lindjes së fëmijës. Çdo urdhër apo ndalesë, që vjen prej Krijuesit apo prej të Dërguarit të Tij, është në dobinë e njerëzve në përgjithësi, prandaj mysliman, pavarësisht nëse e kpton urtësinë dhe dobinë, është i bindur në begatinë e tyre.

El-Akika ka urtësi të shumta e ne po përmendim vetëm disa prej tyre:

- Akika është një lloj falënderimi ndaj Krijuesit, që i ka dhuruar robit të Tij fëmijë.
- Akika është kurban, me të cilin fëmija i lindur i afrohet Allahut (xh.sh.), në momentet e para të jetës së tij.
- Akika është sakrificë për mbrojtjen e fëmijës nga fat-keqësitë dhe epidemitet e ndryshme, siç urdhëroi Allahu që, në vend të Ismailit (a.s.), të pritej një kurban i rëndësishëm.
- Për ta liruar fëmijën që të bëjë ndërmjetësim te Allahu për prindërit e vet.
- Të shprehurit e gjëzimit dhe lumturisë sipas ligjeve is-

lame dhe shtimi i numrit të besimtarëve, me të cilët do të mburret Pejgamberi (s.a.v.s.), ditën e kiametit, para popujve të tjerë.

- Forcimi i lidhjeve miqësore dhe dashurisë mes bijve të shoqërisë dhe tubimi i tyre nëpër tryezat e mbushura me ushqim, për të treguar gjëzimin për lindjen e fëmijës.

### MENDIMET E JURISTËVE MYSILMANË PËR DISPOZITËN E AKIKES:

Për dispozitën e akikes, dijetarët dhe juristët islamë ndahen në tri mendime:

**Mendimi i parë:** Zbatimi i akikes është obligim i prerë. Të këtij mendimi janë: imam el-Hasen el-Basriju, El-Lejth bin Seadi dhe të tjerë. Mendimin e tyre, këta e argumentojnë me transmetimin e Burejdes dhe të Is'hak bin Rahvujes: (Vërtet njerëzit do të pyeten për akiken, siç do të pyeten për pesë kohët e namazit). Po ashtu, argumentojnë me hadithin e el-Haseni nga Sumrete se Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë: "Çdo djalë është peng i akikes së tij." Nga hadithi argumentohet se fëmijës nuk i lejohet të ndërmjetësojë për prindërit e vet, derisa ta zbatojë akikan. Kjo argumenton për obligueshmërinë e akikas.

**Mendimi i dytë:** Zbatimi i akikes është sunet-mustehab

# Këndvështrime juridike islame

(vepër e rekomanduar). Të këtij mendimi janë: imam Maliku, banorët e Medinës, imam Shafiu dhe ihtarët e tij, imam Ahmed, Is'haku, Ebu Theuri dhe një numër i madh i dijetarëve islamë. Mendimin e tyre e mbështesin në hadithet, të cilat janë përmendur më lart. Po ashtu, këta e kundërshtojnë mendimin e atyre që thonë se zbatimi i akikes është obligim, duke thënë:

- Po të ishte obligim, do të ishte e qartë obligueshmëria në fe, ngase është një vepër që i përfshin të gjithë dhe se patjetër do ta shpjegonte vetë Pejgamberi (s.a.v.s.), se një gjë e tillë është e kategorisë së obligimit.

- Pejgamberi (s.a.v.s.), çështjen e akikes e ka lënë në vullnetin e prindit, duke thënë: "Atij që i ka lindur një fëmijë dhe për lindjen e tij dëshiron të bëjë kurban, le ta bëjë".

- Zbatimi i akikes nga Pejgamberi (s.a.v.s.), nuk argumenton për obligueshmëri, por për diçka që është e rekomanduar (mustehab).

**Mendimi i tretë:** Zbatimi i akikes nuk është i ligjshëm. Të këtij mendimi janë dijetarët hanefitë.

Mendimin e tyre e mbështesin në transmetimin e el-Behjekut nga Amer bin Shuajbi, nga babai i tij dhe nga gjyshi i tij se Pejgamberi (s.a.v.s.), ishte pyetur për akikan e ishte përgjigjur: "Unë nuk e dua mosmirënjojen". Po ashtu, kanë argumentuar edhe me hadithin që ka transmetuar imam Ahmed nga Ebi Rafi'i (r.a.), se Fatimja (r.a.), ka dashur të presë dy kurbane për Hasanin, por Pejgamberi (s.a.v.s.), i ka thënë: "Mos pri kurban, por rruaja flokët dhe jep sadaka, aq sa peshojnë flokët, vlerën e argjendit e pastaj, kur i lindi Husejni, veproi njësoj".

Kuptimi i qartë i haditheve të përmendura, vërteton se zbatimi i akikes është vepër e rekomanduar dhe se të këtij mendimi janë shumica e dijetarëve.

Është e vërtetuar se Pejgamberi (s.a.v.s.), ka bërë kurbane për Hasanin dhe Husejinin. Për këtë çështje, janë transmetuar shumë hadithe. Ne po përmendim disa prej tyre:

- Trasmeton Ebu Davudi nga Ejjubi, nga Ikreme dhe nga Ibn Abbasi (r.a.), se vërtet Pejgamberi (s.a.v.s.), ka bërë kurban dy desh për Hasanin dhe Husejinin.

- Xherir bin Hazimi nga Katadeja, transmeton nga Enesi (r.a.), se vërtet Pejgamberi (s.a.v.s.), ka bërë kurban dy desh për Hasanin dhe Husejinin.

- Jahja bin Seid nga Umrete, transmeton nga Aisheja se ka thënë: "Pejgamberi (s.a.v.s.), ka bërë kurbane për Hasanin dhe Husejinin ditën e shtatë të lindjes".

Si përbledhje e gjithë kësaj që u përmend, është se, për të lindurin, akika është vepër e rekomanduar (sunet, mustehab), tek shumica e dijetarëve dhe juristëve islamë. Babait i mbetet që, nëse i lind fëmija dhe ka mundësi materiale, ta gjallërojë këtë traditë-sunet të Pejgamberit (s.a.v.s.), që më këtë të arrihet shpërblimi i Allahut (xh.sh.). Me zbatimin e akikas shtohet dashuria, miqësia dhe lidhja shoqërore në mes familjeve, të afërmve, fqinjëve, shokëve

dhe miqve në përgjithësi. Kjo mirësi është në funksion të prezantimit të miqve, të të afërmve në gostinë e akikas, duke shprehur gjëzimin për lindjen e fëmijës, për ardhjen e tij. Po ashtu, dobia dhe kontributi i akikas ka lidhje me solidaritetin shoqëror, ngaqë në këtë gasti ushqehen edhe ata që janë të varfér.

Sa madhështor është Islami, sa rregulla dhe ligje të mira ka sheriati islam, i cili mbjell miqësi dhe dashuri në shoqëri. Po ashtu, vendos drejtësi sociale, duke ndihmuar të varférit dhe ata që kanë nevojë, por nuk lypin.

## ARGUMENTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKIKES:

Hadithet, të cilat vërtetojnë dhe argumentojnë ligjshmërinë e akikes, janë të shumtë. Ne po përmendim disa prej tyre:

- Buhari transmeton nga Selman bin Ammar ed-Dabijj se Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë: "Kurtë lind djalë, duhet bërë akika, priteni për të kurbanin, dhe largoni nga ai të këqijat".

- Ebu Davudi transmeton nga Sumrete se Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë: "Çdo fëmijë është peng, derisa për të të bëhet akika, të pritet kurbani ditë e shtatë të lindjes, të emërohet dhe t'i rruhet koka".

- Imam Ahmed dhe Tirmidhiju transmetojnë nga Aisheja (r.a.), e cila ka thënë se Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë: "Përdjalin duhen prerë kurban dy dele të një viti dhe të ngashme mes veti, ndërsa për vajzën një dele".

- Imam Ahmed dhe Tirmidhiju transmetojnë nga Ummu Kurzil Ke'abijjeti, e cila e kishte pyetur Pejgamberin (s.a.v.s.), për akikan e ai ishte përgjigjur: "Përdjalin priten dy dele e përvajzën një dele. Nuk ka rëndësi nëse kurbanet janë desh apo dele".

- Transmeton Tirmidhiu, Nesaiju dhe Ibn Maxhe nga el-Haseni, nga Sumrete se Pejgamberi (a.s.), për akikan ka thënë: "Çdo djalë është peng në akiken e tij, kurban duhet të prehet ditën e shtatë të lindjes, t'i rruhet koka dhe të emërohet".

## KOHA E PREFERUAR PËR TË BËRË AKIKA:

Më lart përmendëm hadithin e Sumretes: "Djali është peng i akikes së tij, që duhet të pritet ditën e shtatë të lindjes dhe të emërohet". Ky hadith shpjegon qartë se koha e preferuar për t'u bërë akika, është dita e shtatë e lindjes. Këtë argumenton edhe hadithi i Abdullah bin Vehbit, nga Aisheja (r.a.), e cila ka thënë: "Pejgamberi (s.a.v.s.), ka bërë kurbane për Hasanin dhe Husejinin, i ka emërtuar ata të dy dhe ka urdhëruar që të largohen nga kokat e tyre të këqijat"

Nga e gjithë kjo, kuptohet se të bërit e akikes preferohet ditën e shtatë të lindjes, por nuk është obliguar doemos: mund të bëhet në ditën e tetë, të dhjetë apo më vonë. Kurdo që të bëhet, akika është e vlefshme.

Reth përcaktimit të ditës se kur duhet bërë akika, po ju sjellim mendimet e dijetarëve:

- El-Mejmunju ka thënë: "E kam pyetur Ebi Abdilahin

se kur duhet tē bëhej akika pér djalin dhe më eshtë pér gjigjur se Aisheja (r.a.), i kishte thënë: "ditën e shtatë, ditën e katërbëdhjetë dhe ditën e njëzetenjëtë."

- Salih bin Ahmed i ka thënë se babai i tij ishte shprehur pér akikan: "Duhet tē bëhet nē ditën e shtatë e, nëse nuk eshtë bërë nē këtë ditë, mund tē bëhet nē ditën e katërbëdhjetë dhe, nëse nuk eshtë bërë nē këtë ditë, mund tē bëhet nē ditën e njëzetenjëtë."

- Imam Maliku ka thënë: "Përmendja se akika duhet tē bëhet nē ditën e shtatë tē lindjes, kuptohet se eshtë mustehab-e preferuar që tē bëhet këtë ditë, por mund tē bëhet edhe nē ditën e katërt, ditën e tetë, ditën e dhjetë ose më vonë. Akika eshtë e vlefshme, kurdo që tē bëhet."

Thënë shkurt, nëse babai i ka mundësitë tē bëjë kurban pér fëmijën e lindur, eshtë mirë ta bëjë nē ditën e shtatë tē lindjes, pér shkak se kështu ka vepruar Pejgamberi (s.a.v.s.). Nëse nuk i ka mundësitë materiale momentalisht, atëherë ai ka mundësi ta bëjë akikan kur t'i jepet mundësia, pra, në cilëndo ditë, siç ka thënë imam Maliku. Në këtë çështje ka hapësirë pér t'u zbatuar akika si lehtësim. Allahu (xh.sh.), thotë: "**Allahu dëshiron pér ju lehtësim, nuk dëshiron vështirësi.**" (El-Bekaretu.), "...dhe nuk ju obllgoi në fe me ndonjë vështirësi." (el-Haxhxh: 78.)

#### A ESHTË AKIKA E NJËJTË, SI PËR MASHKULLIN, ASHTU EDHE PËR FEMRËN?

U përmend më lart se akika eshtë sunet-mustehab (rekomanduar), sipas mendimit të tē gjithë dijetarëve dhe përfshin njëloj fëmijën mashkull dhe fëmijën femër.

- Hadithi që transmetojnë Ahmed i dhe Tirmidhiju, nga Ummu Kurzil Keabijeti, tregon se ajo e kishte pyetur Pejgamberin (s.a.v.s.), pér akikan e ai ishte përgjigjur: "Pér djalin duhen prerë dy dele e pér vajzën një."

- Hadithi që transmeton Ibn Ebi Shejbete nga Aisheja (r.a.): "Ne na ka urdhëruar Pejgamberi (s.a.v.s.), që pér djalin tē priten dy dele, kurse pér vajzën një." Këto hadithe dhe shumë tjera, tē cilat i kemi përmendur, janë argumente pér ligjshmërinë e akikas.

#### KËTO HADITHE, NË PËRGJITHËSI, NA PARAQESIN DY GJERA ME RËNDËSI:

E para, akika eshtë e ligjshme, si pér mashkullin, ashtu edhe pér femrën.

E dyta, dallimin mes dy gjinive.

Ibn Abbasi (r.a.), Aisheja (r.a.) dhe një grup i dijetarëve të hadithit, janë tē mendimit se pér djalin duhet tē priten dy dele, ndërsa pér vajzën një dele.

Imam Maliku eshtë i mendimit se edhe pér djalin edhe pér vajzën duhet prerë një dele. Me një rast, ishte pyetur se sa kurbane duhen prerë pér lindjen e djalit e sa pér lindjen e vajzës? Imam Maliku eshtë përgjigjur: "Pér djalin dhe pér vajzën duhet prerë një dele." Ky dijetar e argumenton mendimin e tij me këto hadithe:

- Ebu Davudi transmeton nga Ibn Abbasi (r.a.): "Pejgamberi (s.a.v.s.), ka bërë kurban pér Hasanin dhe Husejinin nga një dash".

- Xhafer bin Muhamedi transmeton nga babai i tij se Fatimja (r.a.), ka prerë pér Hasanin dhe Husejinin nga një dash.

- Imam Maliku ka thënë: "Abdullah bin Umeri (r.a.), ka prerë pér lindjen e djemve dhe vajzave nga një dele".

Mendimi më i zgjedhur eshtë që, si falënderim pér atë që ka dhuruar Allahu (xh.sh.), tē priten dy dele pér lindjen e djalit, kurse një dele pér vajzën. Eshtë vërtetuar se Pejgamberi (a.s.), ka përmendur se pér djalin duhen prerë dy dele e pér vajzën një. Varësisht prej gjendjes materiale, nëse ajo eshtë mesatare ose nën mesatare, vlen që pér djalin tē pritet një dele, por edhe pér vajzën një dele. Ai, cili vepron kështu, do tē shpërblehet nga Allahu (xh.sh.) dhe me këtë do tē zbatojë traditën-sunetin e Pejgamberit (a.s.).

#### REAGIMI KUNDËR ATIJ QË KUNDËRSHTON TË PRITEN DY DELE PËR DJALIN E NJË DELE PËR VAJZËN

Ka mundësi që dikush ta kundërshtojë këtë, duke thënë: "Pse feja islame ka bërë dallim në mes mashkullit dhe femrës, në çështjen e akikes. Përse tē jetë ky dallim dhe veçim?"

Reagimi ndaj këtij kundërshtimi eshtë në disa aspekte:

a. Myslimani dorëzohet para çdo urdhri apo ndalese që i përcakton feja islame. Pér këtë, Allahu i Lartësuar ka thënë: "Pér Zotin tēnd jo, ata nuk janë besimtarë (tē asaj që tē zbriti ty e as tē asaj para teje), derisa tē mos zgjedhin ty pér tē gjykuar në konfliktin mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tēnd), tē mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) tē mos binden sinqerisht". Dhe po ashtu, ky dallim eshtë vërtetuar nga Pejgamberi (s.a.v.s.) dhe se myslimanit si mbetet tjetër, vetëm ta pranojë dhe zbatojë.

b. Ndoshta aspekti logjik pér këtë dallim, eshtë pér tē treguar se mashkulli eshtë krijuar si më i fuqishëm fizikisht se femra; se ai eshtë ngarkuar me marrjen e përgjegjësisë në familje dhe se eshtë i dalluar në vetëpërbajtjen dhe kontrollimin e ndjenjave. Të vërtetën e thotë Allahu (xh.sh.): "**Burrat janë përgjegjës pér gratë, ngase Allahu**



**ka graduar disa mbi disa të tjerët dhe, ngase ata kanë shpenzuar nga pasuria e tyre... ”.** (Nisa, 34)

c. Për të forcuar mbjelljen e miqësisë dhe dashurisë në tubimin e njerëzve për akiken e fëmijës së lindur e pastaj, për t'i fuqizuar kontribuesit në solidaritetin social për të varférir, robërit dhe ata të cilët kanë nevojë, por përmbanen nga lypja.

### **UREHET THYERJA E ESHTRAVE TË AKIKES**

Duhe pasur kujdes ndaj kurbanit që pritet për lindjen e fëmijës që të mos i thyhet asnjë eshtë, gjatë therjes dhe gjatë ngrënies. Ato duhet të këputen nga nyejt-vendbashkimi i tyre, pa u thyer. Kjo argumentohet me transmetimin e Ebu Davudit, nga Xhafer bin Muhamedi, babai i tij, se Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë për akiken që ka bëre Fatimeja (r.a.), për Hasanin dhe Husejnин: “Dërgoni këmbën e kurbanit te mamia, hani dhe ushqehuni, por mos e thyeni asnjë kockë”. Transmeton Xhurejxhi nga Atai, i cili ka thënë: “Këputet nga nyejt, por nuk duhet t'i thyhet asnjë kockë”. Të njëtin transmetim e bën Ibn el-Mundhiri nga Atai dhe nga Aisheja (r.a.)

Urtësia e mosthyerjes së eshtrave ka të bëje me dy gjëra:

**E para:** Tregimi i vlerës dhe respektit ndaj këtij ushqimi apo dhuratës që u jepet të varférve dhe fqinjëve. Kjo bëhet, për shkak se iu ofrohet një pjesë e kurbanit e plotë pa iu thyer asnjë kockë dhe duke mos i munguar asgjë pjesës, e cila do të jepet si dhuratë. Ky veprim eshtë shumë i ndershëm dhe eshtë mënyra më e mirë e bujarisë dhe e nderimit ndaj atij që i jepet.

**E dyta:** me shpresë se gjymtyrët e fëmijës së lindur të janë të shëndosha dhe të forta, siç eshtë kurbani i sakrifikuar për të.

### **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME QË KANË TË BËJNË ME AKIKEN**

Ekzistojnë disa rregulla të përgjithshme, që kanë të bëjnë me akiken dhe që duhen respektuar:

(a). Të gjithë dijetarët janë unanimë se kurbani për akika duhet të jetë i njëjtë si kurbani. Për t'u lejuar prerja e kurbanit<sup>1</sup>, duhet të plotësohen këto kushte:

1. Nëse kurbani eshtë dele apo dhi, duhet të ketë mbushur një vit, por, nëse delja eshtë me trup të madh, lejohet edhe nëse ka mbushur gjashtë muaj, por me kusht që, kur të përzihet me delet që janë një vjeçe, të mos dallohet. E sa i përket dhisë, ajo doemos duhet të ketë një vit.

2. Kurbani të jetë i shëndoshë dhe pa të meta. Bazuar në këtë, nuk vlen për kurban ajo shtazë që eshtë e verbër me të dy sytë, e verbër me njërin sy, e dobët, sa nuk i ka mbetur copë mishë në eshtra, që çalon aq sa nuk mund të shkojë deri te vendi i therjes. Po ashtu, nuk vlen për kurban shtaza, e cila e ka të këputur më shumë se 1/3 e veshit dhe bishtit. Nuk lejohet të pritet edhe ajo shtazë që nuk i ka shumicën e dhëmbëve, ajo e cila nuk ka fare vesh dhe ajo e cila eshtë e çmendur, sa nuk mund ta ruajë çobani.

Nëse ka të meta të tjera, përveç këtyre që u përmenden, lejohet të bëhet kurban si: nëse i ka veshët e shpuar, brirët e thyer ose çalon, por që mundet të ecë deri te vendi i therjes apo, nëse eshtë e çmendur, por që mundet ta ruajë çobani ose nuk i ka një pjesë të dhëmbëve, por që i ka gjysmën ose ka të këputur 1/3 ose më pak të veshit dhe bishtit. Të gjitha këto nuk pengojnë që të pritet kurbani.

3. Kurbani që eshtë lopë ose buallicë, duhet t'i ketë mbushur dy vite, ndërsa deveja duhet t'i ketë të mbushura pesë vite.

(b). Në kurbanin për lindje të fëmijës nuk mund të marrin pjesë dy e më shumë vetë, pra disa veta të presin një kurban të madh (deve, lopë) për akika të fëmijëve të tyre.

(c). Lejohet të pritet për akika dele, lopë dhe deve, por me kusht që lopa apo deveja të priten për një fëmijë të lindur. Ibn Kajjimi (r.a.), përmend se Enes bin Maliki (r.a.), ka therur për akika të fëmijës një deve... Transmetohet se Ebi Bekrete ka therur për akikanë e djalit të tij një deve dhe u ka dhënë për të ngrënë banorëve të Basras...

Disa prej dijetarëve janë të mendimit se për akika nuk lejohet të pritet përveç bagëtive, duke u bazuar në hadithet e shumta që kanë përmendur këtë.

Ata të cilët mendojnë se për akika vlen lopa, devja, mendimin e tyre e mbështesin në transmetimin e Ibn el-Mundhirit (r.a.), se Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Për djalin bëni akika, pra pritni për të kurban...”. Në këtë hadith nuk eshtë përcaktuar lloji i kurbanit, por vetëm eshtë përmendur prerja e tij, andaj akika eshtë e vlefshme, pavarësisht se ç'bagëti eshtë.

(ç). Në aspektin e ngrënies, shpërndarjes, sadakasë, vlejnë të njëjtat rregullat që vlejnë edhe për kurbanin, përveç se nga mishi i akikes duhet t'i dërgohet edhe mamisë, për ta gëzuar edhe atë, duke u mbështetur në hadithin të cilin e transmeton Bejheku nga Aliu (r.a.), i cili tregon se Pejgamberi (s.a.v.s.), e ka urdhëruar Fatimen (r.a.), duke i thënë: “Peshoji flokët e Husejinit dhe në atë peshë jep sadaka nga argjendi, po ashtu, një shpatull të akikasë jepja mamisë”.

Kush dëshiron të gostisë me akika, lejohet dhe nuk ka kurfarë pengese për këtë. Gostia me akika eshtë përhapur në shoqërinë myslimanë dhe ky veprim eshtë i lejuar sipas shumicës së juristëve islamë, ngase me këtë gasti shtohet miqësia, dashuria dhe vëllazëria në mes familjes, miqve, shokëve, fqinjëve... Kjo pra, eshtë dëshira e Pejgamberit (a.s.), që umeti të jetë i bashkuar, i forcuar si fortifikatat që mbrojnë njëra-tjetrën.

(d). Preferohet që akika të pritet në emër të fëmijës së lindur. Ibn el-Mundhiri transmeton nga Aisheja (r.a.), se Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Priteni akiken në emër të fëmijës së lindur dhe thoni: “Në emër të Allahut, o Zot, ky kurban eshtë për ty, kjo eshtë akika e filanit”. Nëse therësi e bën nijjet se për cilin po theret akika, por nuk i përmend emrin fëmijës, akika eshtë e vlefshme dhe më këtë eshtë arritur qëllimi i duhur.

1. Kushtet e përmendura janë sipas medh'hebit hanefit.

# VDEKJA

Vdekja është një ndër fenomenet misterioze, që ka shqetësuar mendjen dhe zemrën e njeriut që prej periudhave të antikitetit dhe deri më sot. Ajo që e bën misterioze fenomenin e vdekjes është së pari, dukuria e plakjes së organizmit të njeriut, pasi ka kaluar një periudhë kohe e caktuar, si dhe mundësia apo jo e vazhdimit të jetës pas vdekjes dhe formës së kësaj jete.

Studimet bashkëkohore në mjekësi e kanë shndërruar në sfidë hulumtimin e procesit që përfundon me vdekjen, aq sa nuk janë të pakta rastet, kur ekipe të ndryshme kërkimore, të përbërë nga mjekë dhe shkencëtarë të ndryshëm, shpallin në mënyrë sensacionale zbulime të gjeneve përgjegjëse për plakjen e organeve njerëzore, që shpien deri në vdekjen e njeriut.

Me përjashtim të mendimit filozofik ateist, që zë fill në antikitet me Epikurin, i cili e konsideron vdekjen si fundin e ekzistencës së gjallesës dhe të njeriut, të gjitha sistemet e tjera të filozofisë dhe të besimeve e konsiderojnë vdekjen vetëm si kalim ngajeta e kësaj bote në një jetë tjetër. Ky besim haset që në besimet më të lashta të datuara deri më sot.

Kështu, në besimin e vjetër egjiptian, babilonas dhe atë grek, ekzistonte ideja se jeta e njeriut vazhdon edhe pas vdekjes, madje varret e njerëzve pajiseshin me ushqime dhe pajisje të jetës së përditshmë, me idenë se ato do t'i duhesin të vdekurit për në botën tjetër. Në besimin indian, vdekja është konceptuar si momenti kur fuqia shpirtërore braktis trupin në të cilin gjendet, për t'u rishfaqur prapë në botë, por tashmë në një formë të re më të ulët ose më të larta nga ajo e mëparshmja. Ky koncept përbën bazën e botëkuptimit të inkarnimit.

Në shkrimet hebreje të hershme, një jetë e gjatë, e shëndetshme dhe me një fund të lavdishëm, konsiderohej si një lloj dhurate dhe shpërblimi nga Perëndia (Zanafilla, 15/15.), ndërsa një jetë e shkurtër e prerë në mes, konsiderohej si dënim përmëkatet e bëra. (Psalmet, 34/21.)

Në periudhat e mëvonshme, veçanërisht pas emigrimit të madh që përjetuan hebrejtë gjatë sundimit romak, filloj të dilte edhe më shumë në pah ideja e jetës së përtejme, ku të mirët dhe të zgjedhurit e Perëndisë do të jetonin një jetë më të mirë sesa jeta që kishin pasur në këtë botë (Makabe II, 7/79.)

Në filozofinë e krishterë, vdekja është rezultat i mëkatit të parë që kryen Adami dhe Eva, i cili kaloi nëpërmjet tyre në të gjithë racën njerëzore. Nga ky këndvështrim vdekja është konsideruar si largim nga Perëndia. Ardhja e Jezu Krishtit dhe vdekja e tij në kryq, sipas besimit të krishterë, e ka shlyer këtë mëkat dhe bota ndahet në ata që besojnë

në Jezusin dhe ata që nuk e besojnë atë dhe aktin e tij të kryqëzimit. Në bazë të këtij besimi, bëhet edhe ndarja e tyre në jetën pas vdekjes.

Në Kuran, përdoren fjalët imate (dhënia fund e jetës së gjallesës) dhe teveffi (marrja e shpirtit), si konceptet e kundërtë të fjalës të jetuar. Fjala imate kalon në njëzet e një ajete. Në dy ajete përdoret koncepti kadaul-mevt (vendosja dhe zbatimi i vdekjes), ndërsa në dymbëdhjetë ajete, koncepti teveffi është përdorur si akti që kryen Allahu, kur ua merr shpirtin gjallesave. Përveç këtyre rasteve, në gjashtë ajete, akti i marrjes së shpirtit u atribuohet engjëjve, në dy ajete u atribuohet të dërguarve të Allahut (resul), në kuptimin e melekut, ndërsa në një ajet flitet për Azrailin si engjëlli i vdekjes (melekul-mevti). Në të gjitha rastet e dyta, engjëjt janë të ngarkuar me detyrë nga ana e Zotit që t'ua marrin shpirtin njerëzve që u ka ardhur fundi i kësaj jete. Këto dy terma, që përdoren në ajetet kuranore, janë përdorur edhe në literaturën e hadithit, bazuar në burimet e mirënjohnura të hadithit, veçanërisht në kutubu's-sitte, por në këtë literaturë, në kuptimin e vdekjes vihet re se është përdorur më tepër edhe një koncept tjetër me të njëjtin kuptim, kabd (marrja shpirtit).

Vdekja është fundi i paracaktuar i çdo njeriu dhe gjallëse që vjen në këtë botë, por qëllimi kryesor i ardhjes së njeriut në këtë botë nuk është vdekja, por jeta. Zoti u fali jetë të përjetshme njerëzve, që nga momenti që Ai fryu nga shpirti i Tij tek Ademi dhe e krijoi atë, duke e pajisur me vetëdije, por jeta është e ndarë në dy periudha, prej të cilave, gjatë periudhës së parë njeriu përjeton një fazë edukimi dhe sprovimi, ndërsa në të dytën, është periudha



kur ai vjel fryshtet e fituara në periudhën e parë dhe u jep formë atyre në përjetësi.

Vdekja është periudha që lidh mes tyre këto dy periudha të ndryshme të jetës së njeriut, duke e përjetësuar në këtë mënyrë njeriun në kohë. Për këtë arsyesh edhe koncepti i vdekjes jepet me fjalën ilka (pikëtakimi me Zotin), në rreth njëzet ajete të Kur'anit.

Sipas Kur'anit, ai njeri që vret pa të drejtë një njeri tjetër, është si të ketë vrarë mbarë njerëzimin, ndërsa, ai që e shpëton një njeri nga vdekja dhe e kthen atë në jetë, është si të ketë shpëtuar gjithë njerëzimin (Maide, 32.) Ruajtja e vazhdimësisë së jetës është kusht për racën njerëzore, deri në momentin që Allahu dëshiron që ai të jetë i gjallë. Në të gjithë librat e hadithit të Kutubus's-sitë është regjistruar hadithi i profetit Muhamed, sipas të cilës besimtarët nuk duhet ta dëshirojë vdekjen, sado të rënda të jenë vështirësitet e jetës që ai është duke kaluar.

Allahu bëri që njeriu ta dojë jetën, në mënyrë që kështu, ai të ruajë vlerat e jetës dhe të njerëzimit, që të zhvillojë botën e tij ku jeton dhe të mund të përgatitet për udhëtimin e tij drejt përjetësisë. Për këtë arsyesh, vdekja është moment i mbushur plot hidhërim për zemrat e njerëzve, madje në këtë kontekst, vdekja është cilësuar si fatkeqësi në disa ajete kuranore. (Bekare, 156; Maide, 106)

Besimtarë i vërtetë nuk e heq kurrë nga mendja faktin që vdekja ka për të ardhur një ditë, ndjehet i përgatitur për atë moment, që është i panjohur për të dhe pajtohet me vdekjen kur ajo i afrohet. Kurani i kritikon njerëzit i ndiferentë ndaj mësimave të fesoë, të cilët nuk e ndjehen harenë e takimit me Zotin pas vdekjes dhe që ndjehen të lumtur vetëm në këtë jetë, me të cilën i kanë lidhur të gjithë shpresat e tyre. (Junus, 7-8)

Besimtarë duhet të jetë i dobishëm për njerëzit e tjerë edhe si një shprehje falënderimi për begatinë e jetës që ia ka dhuruar Allahu dhe nuk asnjë arsyesh që do të bënte

të kishte frikë nga vdekja, me përjashtim të faktit se me vdekjen merr fund edhe parapërgatitja e tij për jetën e përjetshme.

Filosofia klasike islame, si dhe filozofia e etikës brenda mendimit islam, janë konsideruar përherë si arti që e bën njeriun të lumtur dhe i fal kuptim jetës së tij. Nga ky aspekt, filozofi i parë mysliman Kindi, vdekjen e ka trajtuar si një hall, pikëllim dhe brengë, të cilat krijojnë një gjendje shqetësimi në zemrën dhe në mendjen e njeriut, prandaj ato duhen trajtuar si probleme që kërkojnë të kurohen me metoda edukative dhe meditimi. Kindi pati ndarë një kapitull në vete, në lidhje me vdekjen, në veprën e tij el-Hile li defil-ahzan. Sipas Kindit, vdekja është ana plotësuese e njeriut, sepse njeriu është "gjallesë e vdekshme dhe me intelekt".

Mendimi filozofik, i ofruar nga Kindi, u vazhdua më pas edhe nga filozofë të tjerë myslimanë, si Ebu Bekir er-Razi, Ebu Zejd el-Belhi, Ibn Sina, Ibn Miskevejh etj.

Në të drejtëtë islame janë parashikuar dhe rregulluar çështjet civile dhe financiare, që burojnë nga vdekja e individit. Një ndër diskutimet, që ende ruan aktualitetin e tij, është rasti i vdekjes klinike dhe çfarë duhet bërë në këtë rast, sipas besimit islam.

Në të vërtetë, ndonëse sot e kanë humbur vlerën argumentuese juridike, që në literaturën klasike së të drejtës islame, vdekja është konsideruar një situatë që përbëhet nga dy pjesë, nga shenjat e para të vdekjes, që janë humba e vetëdijes dhe e ndjenjave, ndalimi i rrëhjeve të pulsit dhe i frymëmarrjes, varja tezoshtë e krahëve dhe perëndimi i syve. Ndërkohë, ftohja e trupit, shenjat e mavjosjes së mishit të trupit dhe dekompozimi, janë shenja të prera dhe të fundit që tregojnë se personi ka vdekur.

Normalisht që sot, me avancimin e teknologjisë dhe të mjkësisë, këto parametra janë tejkular, por debati tashmë është fokusuar në lidhje me atë që quhet vdekje klinike, situatën kur tek pacienti vërtetohet në mënyrë të prerë se ka humbur të gjithë funksionet komanduese truri i njeriut dhe nuk mund të rikuperohet. Kjo situatë do të thotë vdekje klinike për pacientin, sepse truri është organi që komandon dhe siguron mbarëvajtjen e të gjithë sistemeve që kryen trupi i njeriut, mes të tjerave edhe të procesit të frymëmarrjes dhe të qarkullimit të gjakut.

Në lidhje me kriteret që duhet të përmbushë vdekja klinike, pas së cilës nuk ka më shpresë për jetën e individit, ekzistojnë pikëpamje të ndryshme, por në mbledhjen e datës 3 korrik 1896, mbajtur në Akademinë e Fikhut, që varet nga Konferenca Islamike, u vendos që një njeri të konsiderohet juridikisht nga aspekti i të drejtës islame se ka vdekur, në rast se realizohet njëra nga këto dy situata, që janë: a) kur zemra ndal dhe pritet frymëmarrja dhe doktorët vendosin se këto dy funksione tashmë kanë marrë fund dhe nuk mund të rikthehen dhe b) kur truri i ka humbur të gjithë funksionet e tij dhe doktorët vendosin se ai nuk mund të rikuperohet më.



## Mubamedi (a.s.), shembull për njerëzimin

Allahu (xh.sh.), thotë: “Ju keni shembullin më të mirë tek i dërguari i Allahut...” (Ahzab, 21.) Pejgamberi (a.s.), është personaliteti i pashoq në histori, i cili ka ndryshuar rrjedhën e njerëzimit dhe të shoqërisë njerëzore, duke u përcjellë atyre parime dhe praktika me anë të të cilave mund të arrihet lumburia në këtë jetë dhe në tjetrën. Ai është gërshtimi i virtuteve të ndritshme dhe pasqyra e një shëmbelltyre të lartë. Ai është për ne një mësues në të gjitha aspektet.

Të gjithë njerëzit që e njihnin Pejgamberin (a.s.) para se atij t'i vinte shpallja e cilësonin si njeriu besnik (el-emin). Në një hadith të transmetuar nga **Buhariu, Muslimi dhe Termidhiu** Ibn Abbasi (r.a.) ka thënë: “**Kur zbriti ajeti 214 i sures Shuara** “Këshilloje farefisin tënd...” Pejgamberi (a.s.), u ngjit në kodrën Safa dhe u thirri njerëzve, të cilët pasi u mblohdën rreth Tij u tha: “Ç’do të mendonit nëse ju them se pas këtij mali një ushtri është nisur t’u sulmojë? A do të më besonit?” Ata thanë: “Nuk të kemi dëgjuar kurrë duke gënjiyer”, atëherë Pejgamberi (a.s.) u tha: “Ju tërheq vëmendjen që të besoni në Allahun (xh.sh.), sepse një dënim i ashpër ju pret!”. Ebu Lehebi (xhaxhi i Pejgamberit (a.s.)) tha: “Qofsh mallkuar! Për këtë arsyen mblohdhe?” dhe u largua. Dhe për këtë ngjarje Zbriti surja El Mesed: “Ju thafshin duart Ebu Lehebit dhe i shuar qoftë ai...” (**Mesed,1**)

Pejgamberi (a.s.) është shembull si prijës fetar, kryetar shteti, shembull me durimin dhe nënshtimin e tij në kohë dhe rrethana të vështira, shembull butësie dhe dhembshurie ndaj anëtarëve të familjes, shembull me mëshirën e tij ndaj të dobtëve, të vetmuarve, robërvë e skllevërve, dhe me faljen dhe mirëkuptimin ndaj gjynahqarve dhe gabimtarëve.

Nëse ti je një njeri i pasur, mendo për thjeshtësinë dhe bujarinë e Pejgamberit (a.s.).

Nëse ti je njeri prej të dobtëve, merr shembull prej jetës së Pejgamberit (a.s.) që ka jetuar në Mekë nën re gjimin e padrejtë dhe mizor të politesistëve!

Nëse je mësues, mendo për Pejgamberin (a.s.) që u mësonte shokëve të sufës urdhrat hyjnore duke u për-

cjellë atyre frymëzimin e zemrës së tij të ndjeshme!

Nëse ti je nxënës, përfytyro Pejgamberin (a.s.) se si qëndronte para Xhebrailit (a.s.) që i sillte shpalljen!

Nëse ti je predikues që jep këshilla ose një prijës, kujto Pejgamberin (a.s.) se si i këshillonte dhe u shpérndante urtësi shokëve të tij.

Nëse je gjykatës, mendo zgjidhjen e tij të zgjuar e të drejtë për të vendosur Gurin e zi në Qabe ndërsa fiset mekase ishin gati t’ia këpusin kokën njëri-tjetrit për këtë gjë!

Në atë kohë Qabja kishte pësuar një përblytje dhe ishte shembur pjesërisht. Banorët e Mekës vendosën që ta ndërtonin nga e para. Dhe kështu bënë. Kur arritën te vendi i Gurit të Zi, patën kundërshtime të rrepta me njëri-tjetrin përfaktin se secili prej tyre do të kishte nderin ta vendoste Gurin e Zi në vendin e vet. Secili fis donte ta kishte nderin përvete. Gjendja u acarua, aq sa ata ishin gati të vritnin njëri-tjetrin. Më pas ranë dakord që të gjykonte ndërmjet tyre njeriu i parë që do të hynte nga porta e Benu Shejbes. Personi i parë që hyri ishte Muhamedi (a.s.). Kur e panë, të pranishmit thanë:

“Ky është njeri besnik dhe ne do ta pranojmë gjykimin e tij.” Kur e njoftuan se si ishte çështja, Muhamedi (a.s.) e zgjidhi problemin me pëlgimin e të gjitha palëve. Ai shtroi rrobën e tij, e vendosi gurin në të dhe më pas urdhëroi të gjithë fiset që të kapnin nga një copë të rrobës. Ata e ngritën gurin së bashku deri tek vendi i tij, ku profeti e mori dhe e vendosi me duart e tij. Të gjithë e miratuan veprimin e tij.

Pejgamberi (a.s.) ngjason me një pishtar që i ndriçon udhën kujdo që dëshiron ta ndjekë rrugën e drejtë dhe të arrijë suksesin në të gjitha fushat e jetës. Ai ishte i butë dhe i ëmbël, kurrë nuk ofendonte apo përbuzte njeri, duke hyrë kështu në zemrën e njerëzve, madje duke fituar edhe respektin e armiqve të tij. Ai ishte njeri i së vërtetës dhe e urrente shumë gjenjeshtren.

# Turpi është çelësi i besimit

Duke ecur në rrugë, Profeti (a.s.), takoi një njeri, i cili po qortonte dikë se ishte i turpshëm, duke i thënë: "Ti je i turpshëm dhe ke një sjellje shumë të mirë, por kjo është e dëmshme për ty." Kur e dëgjoi këtë, Profeti i tha: "*Lere atë në gjendjen e tij, sepse turpi është prej besimit.*" (Buhari, 77.)

Profeti ynë, prej ndjenjës së turpit që kishte, asnjëherë nuk ka qeshur me zë të lartë. Ai nuk përqendrohej tek fytyra e askujt dhe nuk shikonte askënd me imtësi. Shikimet poshtë në tokë ishin më të shumta se shikimet lart. Prej ndjenjës së turpit, profeti ynë, asnjëherë nuk ua vinte njerëzve në dukje në sy gabimet, por i këshillonte në mënyrë të përgjithshme. Ai ka thënë:

*"Prej ndjenjës së turpit, vetëm përfitime mund të kesh."*

Ai që zotëron ndjenjën e turpit, do të jetë prej xhenetlinjve. Ai që nuk ka turp, e ka zemrën e ngurtësuar. E kush e ka zemrën e ngurtë, është prej xhehenemlinjve.

Fjala e rëndë nuk sjell gjë tjetër, përveçse turpërimit. Ndërsa turpi dhe edukata e zbukuron vendin në të cilin ndodhet.

Turpi dhe besimi janë bashkë; kur ikën njëri, padyshim ikën edhe tjetri.

Profeti ynë na ka këshilluar në këtë mënyrë:

*"Allahu (xh.sh.), është shumë i fshehtë dhe i turpshëm. Për këtë, Ai e pëlqen turpin dhe mbulimin. Prandaj, çdokush prej jush, që bën gusul, të mbulohet."* (Ebu Davud)

*"Ruhuni prej lakuriqësisë. Pranë jush ndodhen ëngjëj që nuk ndahan asnjëherë prej jush, përveçse në raste të nevojave personale ose, kur bashkëshortët janë bashkë. Kini turp prej tyre dhe silluni mirë me ta."* (Tirmizi, 42.)

Një sahabi shkoi pranë profetit dhe e pyeti për mbulimin e vendeve të turpshme. Profeti i tha: "*Mbuloji vendet e auretit (të turpshme), përballë çdokujt tjetër, përveç gruas dhe robëreshave që i ke të lejuara.*"

Shkalla më e lartë e turpit është të turpëruarit prej së dukshmes dhe

së padukshmes. Pra, njeriu duhet të jetë i përgatitur në çdo kohë se do të dalë përpara Allahut dhe do të shkojë pranë Tij. Mbi të gjitha, profeti ka thënë:

*"Turpërohuni prej Allahut, me të drejtë."* Sahabi Kiram, i tha:

*"O i dërguari i Allahut! Elhamdulillahi, në turpërohemë përpara Allahut."* Mbi këtë, profeti i tha:

*"Ajo që doja t'ju thosha, nuk ka të bëjë me turpin që keni kuptuar ju. Ajo që dua t'ju them, është se duhet t'i mban dhe t'i ruani, kokën, trupin dhe organet që ndodhen në të, gjithashtu dhe të kujtoni gjithmonë se një ditë do të vdisni dhe do të kalbeni në tokë. Dëshirojeni ahiretin dhe braktisni gjërat materiale të kësaj bote. Ai që vepron në këtë mënyrë, do të thotë se është turpëruar me të drejtë tek Allahu."*

Profeti ka thënë se edhe Hz. Musai ka qenë shumë i turpshëm dhe, në kohën kur bijtë e Israelit laheshin të gjithë bashkë dhe lakuriq, Hz. Musai lahej vetëm dhe duke mbuluar vendet e turpshme.

Nuk duhet të jemi të turpshëm vetëm përsa i përket veshjes dhe paraqitjes së jashtme, por e rëndësishme është që të kemi ndjenjën e turpit edhe në mendime, në të folur,

në shikim, në të ecur dhe në çdo gjë tjetër. Allahu ia ka dhënë njeriut ndjenjën e turpit si një mirësi të tillë, që të kapet fort mbas besimit, islamit dhe ahlakut (moralit). Në qoftë se një njeriu i griset perdja e turpit, atëhere të gjitha këto që thamë më lart, shkojnë kot.

Në qoftë se Allahu dëshiron të shkatërojë një person, ia heq atij ndjenjën e turpit. Dhe kur i hiqet ndjenja e turpit, ai bëhet prej të rrënuarve. Dhe kur rrënohet, i hiqet besueshmëria, kur i hiqet besueshmëria, ai nuk bëhet tjetër, veçse tradhëtar. Kur tradhton, nuk përfiton prej mirësissë së Allahut. Kur nuk mëshirohet, mallkohet. Në kohën që bëhet prej të mallkuarve, shkëputet përfundimisht lidhja e tij me Islamin. (ibn Maxhe)



## Ato që duhet të dimë për tymin e cigares

Tymi i cigares nuk dëmton vetëm ata që pinë cigare!

Në laboratorin për analistikë dhe toksikologji, një vullnetar ka konsumuar 10 cigare, të cilat janë djegur deri në fund. Pajisjet e sofistikuara kanë studiuar vetëm disa nga substancat, sepse analizat e të gjithave substancave që përmban tysi llogaritet të jenë mbi 4.000 dhe do të ishte shumë e shtrenjtë dhe e vështirë që ndonjë shtet t'i përbollonte këto shpenzime për hulumtim.

Vetëm pas dhjetë minutave, një nga ato substanca ka arritur shkallën e alarmit. Kjo substancë quhet "akrolein" që tani ka qenë përafërsisht njëzet herë më shumë se sa është e lejuar në ambiente pune. Avulli i "akroleinës" ngacmon organet e fryshtës, fytin dhe sytë. Shkalla që është regjistruar në ato ambiente është e rrezikshme për shëndetin.

Ndërkaq, shkencëtarët në mbarë botën janë në dijeni se në tymin e cigares ka edhe shumë substanca kancerogjene. Kanceri i mushkërive, ataket në tru dhe në zemër, janë vetëm pjesë e pasojave të pirjes pasive të duhanit-cigares, prej së cilës, në botë vdesin 600.000 persona në vit! Një e treta e këtyre viktimave janë fëmijë.

Këto janë të dhënët e Organizatës botërore të shëndetësisë, që duhet të na shtyjnë të mendojmë. Tymi i cigares, përvëç sëmundjeve të rënda, shkakton edhe një sërë sëmundjesh më të lehta, sidomos tek fëmijët, prindërit e të cilëve konsumojnë cigare në shtëpi.

Prindërit, në mënyrë të drejtpërdrejtë rezikojnë shëndetin e fëmijëve të tyre, sepse është dëshmuar se ata fëmijë janë më të rezikuar nga sëmundjet tumorale dhe kanceroze. Madje edhe leucemi. Nuk është e thënë që kanceri të shfaqet vetëm në mushkëri, por mund të jetë edhe ndezje bronhijale-bronhitis, ndezje e veshit, ndezje e mushkërive etj., që janë të gjitha sëmundje që shfaqen pikërisht për shkak të pirjes pasive të cigares.



Vaji i hudhrës është i domosdoshëm të kombinohet me vajin e peshkut, sepse bën përshtatjen e natyrshme të vajit të peshkut në shëndetin e çdo personi. Vaji i hudhrës ndihmon në mbajtjen larg të arteriosklerozës dhe sëmundjeve të tjera kardiovaskulare. Ai mbrojti enët e gjakut dhe zemrën, kontribuon në tensionin normal të gjakut, duke e mbajtur atë në kufirin e normales, normalizon kufirin e kolosterolit në gjak, mbrojti muret e enëve të gjakut, pengon

## Dobitë e vajit të hudhrës

formimin e tophave të gjakut dhe gëlqerimin e enëve të gjakut, nxit dhe rrit qarkullimin e gjakut në organizëm.

Vaji i hudhrës është antibakteriologjik. Ai përdoret kundër herpesve në zorrë dhe kundër parazitëve. Ai zhduk parazitët në zorrë si tenia, oksiuret dhe askaridet. Ai forcon tretjen dhe përtérin florën e zorrëve.

Vaji i hudhrës ndihmon ngërçet e stomakut, nxit oksigjen në organizëm, ndihmon punën e mëlçisë dhe organeve endokrine, rrit imunitetin e organizmit dhe është shumë i preferueshëm që të merret gjatë stinës së dimrit.

Vaji i hudhrës këshillohet të merret në masë mbi moshën 50 vjeç, sepse kontribuon në mbajtjen e vitalitetit dhe shëndetit në përgjithësi të organizmit. Personat diabetikë duhet ta përdorin patjetër këtë vaj, sepse ndihmon shumë deri te diabeti i tipit 2.

Hudhra në formën e vajit ose pluhurit ka një lloj mbështjellëse të veçantë që i reziston lëngut të stomakut. Kjo mbështjellëse shkrijhet vetëm në zorrën e hollë, e cila më vonë e absorbon dhe ndikon në pengimin e erës jo të këndshme gjatë fryshtës së dëshritjes.

## Gjethet që prodhojnë karburant

Janë zhvilluar gjethet të cilat, pas procesit të fotosintezës artificiale, në vend të karbohidrateve, prodhojnë lëndë djegëse, e cila mund të përdoret në automjete dhe aeroplani.

Së shpejti, gjethet artificiale mund të përdoren si burim alternativ energjie. Sipas lajmeve që kanë botuar gazetat angleze "Daily Telegraph" dhe "Daily Mail", shkencëtarët e Universitetit Glasgow të Anglisë, kanë arritur të prodhojnë një gjethë artificiale interesante.

Këto gjethë nuk kanë ndryshim nga gjethet e zakonshme që njohim ne. Nën ndikimin e dritës së diellit dhe me ndihmën e bakterieve, ato prodhojnë një lloj hidrokarburi që mund të përdoret si lëndë djegëse. Mësohet se ky zbulim interesant, brenda dy vjetëve mund të arrijë në fazën e prezantimit dhe brenda 5 vjetëve mund të kalohet në prodhimin masiv të këtyre gjetheve artificiale.



## X PRO 1: Fujifilm mendon edhe për nostal gjikët



Pas një kohe të gjatë pritjeje, Fujifilm ka dalë sërish në treg me X Pro 1, një aparat fotografik tepër i çmuar dhe kjo, jo vetëm për të dhënë teknike që e përshtasin atë, si për amatorë, ashtu dhe për profesionistë, por dhe falë paraqitjes së saj të jashtme që të kthen në kohë.

X Pro 1 ka 16,3 milionë piksel, një monitor 3,0 polësh dhe mundësinë për të ruajtur imazhet, si në formatin Raw,

ashtu dhe në Jpeg. Për sa i përket anës teknike, një ndër të rejt më interesante është prania e sensorit CMOS, i emërtuar si X-Trans TM CMOSTM, në gjendje që të japë një përgjigje të ngjashme me "fullframe". Objektivet e lancuar, së bashku me aparatin fotografik janë tre dhe bëjnë pjesë në serinë e re të Fujinon XF: "XF 18mm F2 R", "XF 35mm F1,4 R" dhe "R XF 60mm F2,4".

Për sa i përket vlerës së aparatit, mund të themi se nuk është ndër më të pëlqyerat, kjo pasi shifra me të cilën mund ta gjejmë në treg është prej 1.300 euro, e megjithatë, janë të shumtë ata persona që ndihen tepër entuziastë që e kanë blerë një të tillë.

## Anonymous paralajmëron: 31 Mars "Blackout interneti"

Nëse kërcënim i Anonymous është i vërtetë dhe, nëse ia arrijnë qëllimit, në 31 Mars, interneti do të pësojë një blackout total në të gjithë botën. Në një dokument të publikuar në portale të informacioneve teknologjike, thuhet se grupi i famshëm i piratëve kompjuterikë "Anonymous", do të ndërmarrë një sulm në 13 servera qëndrorë, që do të sjellë edhe bllokimin e internetit për të gjithë globin.

Thuhet se një sulm i tillë ndërmerrret si akt kundër ligjeve për piraterinë në internet, bursës së Wall Street dhe elitave monetare dhe shtetërore. Nuk dihet saktësisht nëse ky është vërtet një kërcënim i Anonymous dhe a janë vërtet në gjendje ata që të arrijnë një qëllim të tillë.



## Xhamia e madhe e Tiranës: Nis punën komisioni

Bashkia e Tiranës, me miratimin e Këshillit Bashkiak, ka mbledhur Komisionin për ndërtimin e Xhamisë së Madhe në Tiranë. Komisioni përbëhet nga Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Nënkyetari, Sekretari i Përgjithshëm, Përfaqësuesi i Komitetit të Kulteve, Përfaqësuesi i Prefektit, i Këshillit të Qarkut, Myftiu i Tiranës, tre përfaqësues të komunitetit të besimtarëve të Tiranës, përfaqësues i Institutit të Monumenteve të Kulturës, Këshillit të Ministrave, Shoqatës "Tirana", Administratori i Përgjithshëm i Bashkisë dhe 5 drejtore, tre drejtore të përgjithshëm të Planifikimit të Zhvillimit të Territorit, Planifikimit të Menaxhimit të Shërbimeve, Projekteve Strategjike e Investimeve të Huaja dhe dy drejtore të Planifikimit të Territorit dhe i Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Në këtë mbledhje u vendos ngritia e një grupi pune, i cili do të përgatisë propozimet për vendimmarrjen në Komision, të cilat përfshijnë propozimin për vendin ku do të ngrihet Xhamia e Re, mënyrën e veprimit me projektin e Xhamisë. Puna do të vazhdojë me projektin e hartuar tashmë, do të përcaktohet një arkitekt për të bërë një projekt të ri apo do të bëhet konkurs për projektin e këtij institucionit dhe pas kësaj, menjëherë aprovimi i termave të referencës.

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Lulzim Basha, kërkoi që brenda muajit mars të përmbyllt faza e konsultimeve, diskutimeve dhe e vendimmarrjes, për çështjet e shtruara për diskutim, ndërsa shprehu vullnetin e Bashkisë së Tiranës dhe të tjin personalisht, për ta përfunduar sa më parë këtë vepër që i mungon Tiranës dhe për t'u dhënë besimtarëve një vend të denjë, për të kryer ritet e tyre fatare.

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Haxhi Selim Muça shprehu kënaqësinë, që më së fundi nisi funksionimin një komision, në të cilin do të diskutohet dhe vendoset për ndërtimin e Xhamisë së Madhe të Tiranës.

Ndërsa, kryetari i Këshillit Bashkiak, Njazi Kosovrasti, u shpreh: "Kryeqytetit i duhet një xhami e kohës dhe moderne. Gjithçka të jetë ashtu siç e kërkojnë nevojat. Ky komunitet kaq i rëndësishëm i kryeqytetit dhe i gjithë Shqipërisë, e meriton të ketë një xhami të përmasave të tilla, ndaj t'i mendojmë mirë të gjithë hapat dhe situatat. T'i shohim me kujdes të gjithë projektet, në mënyrë që puna të pëlqehet nga të gjithë".



## ANGLI - SHBA: Sulmimi i Iranit, një veprim jo i mençur

Anglia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kanë kërkuar Izraelit të mos e sulmojë Iranin. Ministri i Punëve të Jashtme të Anglisë, William Hague, dhe Shefi i Shtabit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Martin Dempsey, me anë të deklaratave të ndara që lëshuan, kërkuan nga Izraeli të mos e sulmojë Iranin.

Në një prononcim për rrjetin britanik BBC, Ministri i Jashtëm William Hague, tha se një sulm i mundshëm i Izraelit "nuk do të ishte një veprim i mençur". Hague nënizoi se vendi i tij është fokusuar në rritjen e presionit ndaj Iranit nëpërmjet metodave diplomatike, "Për mendimin tim, - shtoi ai- edhe Izraeli, ashtu si të gjithë të tjerët në botë, duhet të zbatojë sanksione të fuqishme ekonomike dhe të bëjë presion mbi Iranin dhe t'i njohë një shans të vërtetë qasjes sonë, e cila përmban një gatishmëri për të zhvilluar negociata me Iranin".

Kurse Shefi i Shtabit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Martin Dempsey, në një intervistë për televizionin CNN, tha

se Izraeli zoteron sot aftësinë për të sulmuar Iranin dhe pëta vonuar këtë të fundit "mundësish me disa vjet" në prodhimin e armës bërthamore, por megjithatë, disa objektiva në mundësinë më të madhe, qëndrojnë më larg se ajo çfarë mund të arrijë të bëjë Izraeli".

Dempsey shprehu shqetësimin e tij se një sulm i mundshëm i Izraelit kundër Iranit do të shkaktonte një reprezalje të këtij vendi (Iranit) ndaj forcave amerikane, që janë dislokuar në Gjirin Persik dhe objektivave të SHBA-së në Afganistan. "Ky është problemi me të cilin po luftojmë ne sot dhe duhet të mendojmë që organizimi i një sulmi ushtarak kundër Iranit, në këtë pikë nuk do të ishte një veprim i arsyeshëm", - shtoi ai.

Shefi i Shtabit të ushtrisë amerikane, Dempsey, Iranin e cilësoi si një "aktor racional", ndërsa shprehu bindjen se sanksionet ndërkombëtare ndaj Iranit kanë nisur të jatin efektet e tyre.

## Irani kërcënon vendet e BE-së

Kompania Kombëtare e Naftës ka kërcënuar se Irani do të shkurtojë eksportet e naftës për më shumë vende të Bashkimit Evropian, nëse vazhdojnë "veprimet e tyre armiqësore".

Komentet e kreut të kompanisë, Ahmad Kalebani, vijnë një ditë pasi Teherani ka ndaluar shitjet për Britaninë dhe Francën, në përgjigje të sanksioneve të reja të BE-së ndaj programit të tij bërthamor.

Irani eksporton afro 20 për qind të naftës në Bashkimin

Evropian, por Franca dhe Britania shfrytëzojnë pak ose fare nga kjo sasi.

Kalebani ka përmendur Spanjën, Greqinë, Italinë, Portugali-në, Gjermaninë dhe Holandën, si vende që mund të përballen me shkurtimë nga Irani.

Çmimet botërore të naftës janë rritur të hënën në nivelin më të lartë në nëntë muaj, përkatësisht, në rreth 105 dollarë për fuçi.